10.12.2015	Табановце	НПМ посета на Привремен транзитен центар „Табановце“	НПМ	НПМ

## **Анекс 2: Листа на надворешни соработници**

1. проф. д-р Верка Стаменкова Трајкова, Комора на психолози;
2. доц. д-р Иван Трајков, Комора на психолози;
3. м-р Александра Цонева, Здружение на социјални работници на Град Скопје;
4. д-р Владимир Илиевски, Здружение на социјални работници на Град Скопје;
5. Горан Петрушев, Здружение на дефектолози;
6. Велка Лукиќ, Здружение на медицински сестри, техничари и акушери на Република Македонија;
7. д-р Стојан Бајрактаров, Здружение на психијатри на Република Македонија;
8. д-р Верица Поповска, Здружение по судска медицина при македонско лекарско друштво;
9. асс. д-р Горан Павловски, Здружение по судска медицина при македонско лекарско друштво;
10. д-р Александра Груевска Дракулевска, Здружение за кривично право и криминологија на Република Македонија
11. Мартина Смилевска, Македонско здружение на млади правници;
12. Ирена Здравкова, Македонско здружение на млади правници;
13. Светлана Ќосева, Македонско здружение на млади правници;
14. Назиф Авди, Македонско здружение на млади правници.







Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

**AVOKATI I POPULLIT  
MEKANIZËM PARANDALUES NACIONAL**

# **RAPORTI VJETOR**

**Shkup, juni 2016**

**Titulli:** *Raporti vjetor 2015, Mekanizmi Parandalues Nacional*

**Editor:** Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë

**Këshilli redaktues:** Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë -  
*Mekanizmi Parandalues Nacional*

**Përkthyes dhe redaktore gjuhësore:** Moment Mal

**Disenji grafik:** Keti Stefkova

**Tirazhi:** 350

# PËRMBAJTJA

Parathënie

Shkurtesa

<b>1. AUTORIZIME DHE AKTIVITETE TË MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL</b>	<b>106</b>
<b>1.1. Autorizimet dhe mandati i Mekanizmit Parandalues Nacional</b>	<b>106</b>
<b>1.2. Struktura organizative, Buxheti i MPN-së dhe qasja multidisiplinare e vizitave preventive të MPN-së</b>	<b>107</b>
<b>1.3. Bashkëpunimi me organet dhe institucionet</b>	<b>109</b>
<b>1.4. Iniciativa dhe mendime</b>	<b>109</b>
<b>1.5. Promovimi i Mekanizmit Parandalues Nacional dhe përforcimi i kapaciteteve në pjesën e realizimit të të drejtave të personave të privuar nga liria</b>	<b>110</b>
<b>1.6. Dukshmëria dhe transparenca e punës së MPN-së</b>	<b>111</b>
<b>1.7. Prezantimi dhe shpërndarja e raportit vjetor të MPN-së për vitin 2015</b>	<b>111</b>
<b>1.8. Aktivitetet ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me trupa ndërkombëtarë për parandalim të torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës</b>	<b>112</b>
<b>2. VIZITAT E RREGULLTA PARANDALUESE DHE GJENDJET E KONSTATUARA NË VITIN 2015</b>	<b>114</b>
<b>2.1. Stacioni i policisë me kompetenca të përgjithshme Negotinë</b>	<b>114</b>
<b>2.1.1. Kushtet materiale</b>	<b>115</b>
- <i>Nyja sanitare</i>	<i>116</i>
- <i>Lokalet dhe kushtet për biseda dhe marrje në pyetje</i>	<i>116</i>

<b>2.1.2. Realizimi i të drejtave të personave të mbajtur</b>	<b>116</b>
- Informata dhe këshilla për drejtësi	116
- E drejta për ujë dhe ushqim	117
- E drejta për avokat dhe njoftimi i familjes	117
- E drejta për mjek	117
<b>2.1.3. Inspektimi i evidencës dhe regjistrave për personat e mbajtur</b>	<b>118</b>
<b>2.1.4. Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna</b>	<b>118</b>
<b>2.2. Institucionet ndëshkuese - përmirësuese</b>	<b>119</b>
<b>2.2.1. Vizita e Burgut Shkup - Reparti i paraburgimi</b>	<b>119</b>
<i>Kushtet materiale</i>	119
- <i>Hapësira për shëtitje në ambient të hapur</i>	121
<i>Të drejtat e personave të paraburgosur</i>	121
- <i>E drejta për mbrojtje shëndetësore</i>	121
- <i>E drejta për pushim dhe qëndrim në ambient të hapur</i>	122
- <i>E drejta për ushqim</i>	122
<i>Trajtimi dhe realizimi i të drejtave</i>	122
<i>Kontrolli në evidencat e personave të paraburgosur</i>	123
<i>Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna</i>	123
<b>2.2.2. Vizita në Burgun Shkup - reparti i burgut</b>	<b>124</b>
<i>Kushtet materiale</i>	125
<i>Të drejtat e personave të dënuar</i>	126
- <i>Mbrojtja shëndetësore</i>	126
- <i>E drejta për ushqim</i>	128
<i>Trajtimi dhe realizimi i të drejtave</i>	128
<i>Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna</i>	128
<b>2.3. Vende të tjera të vizituara</b>	<b>129</b>
<b>2.3.1. Vizita në IP Enti Gjerontologjik „13 Nëntori“ – Seksioni „Nënë Tereza“</b>	<b>129</b>
<i>Struktura e të punësuarve</i>	130
<i>Kushtet materiale</i>	130
<i>Trajtimi dhe veprimi me shfrytëzuesit</i>	131
<i>Mbrojtja sociale e shfrytëzuesve</i>	131
<i>Mbrojtja shëndetësore</i>	132
<i>Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna</i>	132
<b>2.3.2. Vizita në IP për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Edukative-Sociale «25 Maji» - Shkup</b>	<b>133</b>
<i>Struktura e të punësuarve</i>	133

<i>Mbrojtja sociale</i>	133
<i>Kushtet materiale</i>	134
- <i>Lokalet shkollore</i>	134
- <i>Kapacitetet e vendosjes</i>	134
- <i>Kuzhina dhe mensa</i>	135
<i>Mbrojtja shëndetësore</i>	135
<i>Trajtimi i fëmijëve të akomoduar në institucion</i>	135
<i>Procesi arsimor</i>	136
<i>Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna</i>	136
<b>2.3.3. Vizita në IP për Përkujdesjen, Edukimin dhe Arsimimin e Fëmijëve dhe të Rinjve «Ranka Millanoviq» - Shkup</b>	<b>137</b>
<i>Struktura e institucionit publik</i>	137
<i>Kushtet materiale</i>	138
- <i>Lokalet shkollore dhe kapacitetet e vendosjes</i>	138
- <i>Kuzhina dhe mensa</i>	138
<i>Trajtimi dhe veprimi me shfrytëzuesit</i>	138
<i>Mbrojtja sociale</i>	139
<i>Mbrojtja shëndetësore</i>	140
<i>Procesi arsimor</i>	140
<i>Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna</i>	141
<b>2.3.4. Vizita e IP Enti për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve (Fushë Topanë) - Shkup</b>	<b>141</b>
<i>Veprimi dhe struktura</i>	141
<i>Kushtet materiale</i>	142
<i>Trajtimi dhe veprimi me shfrytëzuesit</i>	142
<i>Edukimi</i>	143
<i>Aftësimi për punë</i>	143
<i>Qëndrimi ditor për persona të rritur</i>	144
<i>Spektori për shëndetësi dhe internat me kuzhinë</i>	144
<i>Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna</i>	145
<b>3. VIZITA TË NJËPASNJËSHME NË VITIN 2015</b>	<b>146</b>
<b>3.1. Stacionet policore</b>	<b>146</b>
<b>3.1.1. Stacioni policor Gazi Babë</b>	<b>146</b>
<b>3.1.2. Stacioni policor Koçanë</b>	<b>148</b>
<b>3.1.3. Stacioni policor Prilep</b>	<b>149</b>
<b>3.2. Institucionet ndëshkuese - përmirësuese</b>	<b>150</b>
<b>3.2.1. Spektori i arrestimit në INP Idrizovë</b>	<b>151</b>

3.2.2. Burgu Tetovë	152
<b>3.3. Masa të ndërmarra dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna</b>	<b>156</b>
<b>3.4. Qendra e pranimit për azilkërkues</b>	<b>157</b>
3.4.1. Struktura e të punësuarve	158
3.4.2. Kushtet materiale, trajtimi dhe veprimi	158
- <i>Kuzhina dhe ushqimi</i>	159
3.4.3. Mbrojtja shëndetësore	160
3.4.4. Inspektimi në evidencë	160
3.4.5. Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna	160
<b>4. BVIZITA TË RREGULLTA NË VITIN 2015</b>	<b>162</b>
<b>4.1. Qendra e Strehimit për të Huaj</b>	<b>162</b>
4.1.1. Të vepruarit sipas rekomandimeve të dhëna	164
<b>4.2. Stacionet policore</b>	<b>164</b>
4.2.1. Stacioni policor Kisella Vodë	164
4.2.2. Stacioni policor Gazi Babë	165
<b>5. VIZITA E QENDRAVE TË PËRKOHSHME TRANSITORE</b>	<b>166</b>
<b>5.1. Qendra e Përkohshme Transitore „Vinojug” - Gjevgjeli</b>	<b>167</b>
5.1.1. Menaxhimi dhe organizimi i Qendrës së Përkohshme Transitore „Vinojug”	167
5.1.2. Kushtet materiale për qëndrim në Qendrën e Përkohshme Transitore „Vinojug”	168
5.1.3. Ndihma juridike	169
5.1.4. Mbrojtja shëndetësore	169
5.1.5. Transporti i emigrantëve/refugjatëve	170
5.1.6. Biseda me emigrantët/refugjatët	171
<b>5.2. Qendra e Përkohshme Transitore “Tabanocë”</b>	<b>171</b>
5.2.1. Udhëheqja dhe organizimi në Qendrën e Përkohshme Transitore „Tabanocë”	171
5.2.2. Kushtet materiale për qëndrim në Qendrën e Përkohshme Transitore „Tabanocë”	172
5.2.3. Mbrojtja shëndetësore	173
5.2.4. Biseda me emigrantët/refugjatët	174
<b>5.3. Konstatime</b>	<b>174</b>
<b>5.4. Rekomandime</b>	<b>176</b>

<b>5.5. Veprimi sipas rekomandimeve</b>	<b>177</b>
<b>6. REKOMANDIMET NGA VIZITAT E REALIZUARA</b>	<b>178</b>
<b>6.1 Rekomandimet e përgjithshme për sektorët e MPN-së</b>	<b>178</b>
<b>6.2 Rekomandimet për stacione të policisë</b>	<b>178</b>
<b>6.3 Rekomandimet për institucione ndëshkuese përmirësuese</b>	<b>180</b>
<b>6.4 Rekomandimet për institucione dhe vende të tjera për vendosje</b>	<b>181</b>
<b>6.5 Rekomandime për institucione për mbajtjen dhe qëndrimin e të huajve, emigrantëve/refugjatëve dhe kërkuesve të drejtës për azil</b>	<b>183</b>
<b>Aneksi 1: Pasqyrimi i vizitave të Mekanizimit Preventiv Nacional në vitin 2015</b>	<b>185</b>
<b>Aneksi 2: Lista e bashkëpunëtorëve të jashtëm</b>	<b>187</b>
<b>Aneksi 3: Zgjedhja e fotografive nga vizitat e realizuara në vitin 2015 - shembuj pozitivë dhe negativë</b>	<b>280</b>

## Shkurtesa

<b>APT</b>	<b>Asociacioni për Parandalim të Torturës</b>
<b>LPP</b>	<b>Ligji për procedurë penale</b>
<b>LKS</b>	<b>Ligji për kryerje të sanksioneve</b>
<b>IP</b>	<b>Institucioni Publik</b>
<b>ISHP</b>	<b>Institucioni Shëndetësor Publik</b>
<b>SHJR</b>	<b>Shërbimi jezuit për refugjatë</b>
<b>INP</b>	<b>Shtëpia Ndëshkuese Përmirësuese</b>
<b>SHNP</b>	<b>Institucioni Ndëshkues Përmirësues</b>
<b>KPT</b>	<b>Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës</b>
<b>MPB</b>	<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>
<b>MPPS</b>	<b>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</b>
<b>AP</b>	<b>Avokati i Popullit</b>
<b>MNP</b>	<b>Mekanizmi Parandalues Nacional</b>
<b>OPKAT</b>	<b>Protokolli fakultativ ndaj Konventës së KB-së kundër torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues</b>
<b>KB</b>	<b>Kombet e Bashkuara</b>
<b>SP</b>	<b>Spitali Psikiatrik</b>
<b>SP</b>	<b>Stacioni policor</b>
<b>SPKP</b>	<b>Stacioni policor me kompetenca të përgjithshme</b>
<b>RM</b>	<b>Republika e Maqedonisë</b>
<b>SPB</b>	<b>Spektori për punë të brendshme</b>
<b>DKS</b>	<b>Drejtoria për Kryerjen e Sanksioneve</b>
<b>UNHCR</b>	<b>Komisariati i Lartë i KB-së për refugjatë</b>
<b>QPS</b>	<b>Qendra për Punë Sociale</b>
<b>CRPD</b>	<b>Конвенција за правата на лица со попреченост</b>



*Të nderuar,*

*Duke vepruar në kuadër të mandatit që është i përcaktuar në Protokollin fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës të Kombeve të Bashkuara, Avokati i Popullit - Mekanizmi Nacional Parandalues nëpërmjet vizitave preventive të realizuara në vendet e privimit dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes, edhe këtë vit, është përqendruar që t'i identifikojë rreziqet e mundshme të cilat mund të shkaktojnë shkeljen e të drejtave të njeriut, torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.*



*Mekanizmi Nacional Parandalues si seksion i veçantë në përbërje të Avokatit të Popullit, në vitin e pestë me radhë përpilon raport vjetor në të cilin është prezantuar analiza dhe gjendjet e konstatuara, rekomandime konkrete dhe udhëzime për mënjanimin e mangësive në veprim, dhe kushteve në vendet e privimit dhe kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe iniciativat për ndryshimin e zgjidhjeve ligjore ekzistuese.*

*Gjatë vitit 2015 kemi zbatuar 24 vizita parandaluese në vendet e privimit ose kufizimit të lirisë së lëvizjes, në të cilat krahas MPN-së, ishin të përfshirë edhe bashkëpunëtorë të jashtëm profesionalë nga profile të ndryshme dhe institucione, me të cilën Avokati i Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional ka siguruar qasje multidisiplinare në punën e vet.*

*Nuk mund të mos përmenden vështirësitë me të cilat u ballafaquam gjatë vitit 2015 lidhur me mosekipimin e kuadrit të Mekanizmit Parandalues Nacional, i cili në gjysmën e parë të vitit ka funksionuar me dy këshilltarë, në gjysmën e dytë njëri nga këshilltarët e lëshoi ekipin për shkak të ndryshimit të punësimit, ndërsa në muajin tetor këshilltari tjetër shkoi në pushim mjekësor afatgjatë. Edhe pse mbetëm pa ekipin e plotë, megjithatë me angazhime plotësuese të personave të punësuar nga sektori për mbrojtje, kemi arritur në një pjesë të madhe ta realizojmë programin vjetor të Mekanizmit Parandalues Nacional.*

*Viti raportues 2015 është karakteristik edhe pas paraqitjes së krizës së emigrantëve, që shkaktoi nevojë për aktivitete plotësuese të Mekanizmit Parandalues Nacional. Në këtë drejtim, u ndërmorën një numër i madh i aktiviteteve dhe veprimeve për përcaktimin e gjendjeve, kushteve, trajtimin dhe transportin e emigrantëve dhe refugjatëve në qendrat e përkohshme transitore dhe tek organet kompetente u dërguan rekomandime të shumta për përmirësimin e gjendjeve të konstatuara negative.*

**Avokati i Popullit**

**Ixhet Memeti**

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Ixhet Memeti', written in a cursive style.



# AUTORIZIMET DHE AKTIVITETET E MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL

## 1.1. AUTORIZIMET DHE MANDATI I MEKANIZMIT PARANDALUES NACIONAL

Ndalimi i torturës dhe formave tjera të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor janë përcaktuar në më shumë dokumente ndërkombëtare dhe konventa, ndër të cilat më e rëndësishmja është Konventa e KB-së kundër torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës. Me qëllim të përforcimit të mbrojtjes së personave të privuar nga liria nëpërmjet zbatimit të mjeteve jashtëgjyqësore të karakterit preventiv, nga Asambleja Parlamentare të KB-së në mënyrë plotësuese është miratuar Protokollin fakultativ ndaj Konventës së KB-së kundër torturës, që ka hyrë në fuqi në vitin 2006.

Mekanizmi Parandalues Nacional mandatin dhe kompetencat e veta i merr pikërisht nga Protokollin fakultativ i Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës, i cili kah fundi i vitit 2008 u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Me miratimin e Ligjit për ratifikim të Protokollit fakultativ ndaj Konventës së KB-së kundër torturës, Avokati i Popullit është emëruar të veprojë si Mekanizëm Parandalues Nacional, me të cilën e mori obligimin që t'i respektojë përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për luftën gjithëpërfshirëse kundër torturës dhe tolerancë zero në rast të ekzistimit të saj.

Me ndryshimet e Ligjit për Avokatin e Popullit të vitit 2009 në kuadër të Avokatit të Popullit është formuar seksioni i veçantë Mekanizmi Parandalues Nacional, detyra e të cilit është parandalimi i torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës. Avokati i Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional ka përpiluar Rregulloren të veçantë për parandalim të torturës dhe Metodologjinë për mënyrën e kryerjes së vizitave të rregullta dhe të njëpasnjëshme parandaluese në vendet ku janë ose ku mund të vendosen personat e privuar nga liria.

Në pajtim me Protokollin fakultativ, Mekanizmi Parandalues Nacional ka kompetencë rregullisht ta hulumtojë veprimin ndaj personave të privuar nga liria, të japë rekomandime organeve relevante me qëllim të pengimit të torturës dhe formave të tjera të veprimit jo human, si dhe të ngritë propozime dhe mospajtime lidhur me projekt legjislaicionin ose atë ekzistues.

Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional ka autorizime për qasje të papenguar në të gjitha vendet dhe objektet të privimit nga liria, qasje në të gjitha informatat që kanë të bëjnë me numrin e personave të privuar nga liria, numrin e vendeve, përkatësisht lokacioneve në të cilat kryhet privimi, si dhe qasje në të gjitha informatat të cilat kanë të bëjnë me veprimin me personat dhe me kushtet e privimit të tyre nga liria.

Mekanizmi Parandalues Nacional ka autorizime dhe mundësi të realizojë biseda pa dëshmitarë me çdo person të privuar nga liria dhe atë personalisht ose me përkthyes, nëse kjo konsiderohet e domosdoshme, si dhe bisedë me cilindo person tjetër për të cilin konsideron se mund të japë informata relevante. Gjithashtu MPN e ka lirinë që t'i zgjedhë vendet që dëshiron t'i vizitojë dhe me personat me të cilët dëshiron të bisedojë, ndërsa ka liri të kontaktojë me Nënkomitetin për Parandalim e Torturës, t'i dërgojë informata dhe me atë të mbajë takime.

Mekanizmi Parandalues Nacional, gjithashtu ka vepruar në pajtim me standardet ndërkombëtare, të drejtën e zakonshme dhe praktikën gjyqësore të gjykatave dhe trupave ndërkombëtarë, në pjesën e mbrojtjes nga tortura dhe veprimi i personave të privuar nga liria.

## **1.2. STRUKTURA ORGANIZATIVE, BUXHETI I MPN-së DHE QASJA MULTIDISIPLNARE E VIZITAVE PREVENTIVE**

Në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Parandalues Nacional është paraparë që të funksionojë si njësi e veçantë organizuese në përbërje të institucionit Avokati i Popullit.

Në pajtim me nenin 18 paragrafin 3 të Protokollit fakultativ të Konventës kundër torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues, shtetet pjesëmarrëse duke përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë marrin obligim të vendosin në dispozicion resurset e nevojshme për funksionimin e Mekanizmit Parandalues Nacional.

Realisht nga viti 2013 në Buxhetin e Avokatit të Popullit janë siguruar mjete të veçanta edhe për këtë seksion, por u tregua se nuk janë të mjaftueshme për plotësimin e kompetencave të parapara. Pikërisht, krahas vizitave preventive në vendet e privimit nga liria, Mekanizmi Parandalues Nacional ka mandat të zbatojë aktivitete promovuese edukative dhe ndërkombëtare, për të cilat në Buxhet nuk janë paraparë mjete për Mekanizimin Nacional Parandalues si pjesë e Avokatit të Popullit i cili ka status të institucionit nacional për të drejtat e njeriut ka nevojë për mjete plotësuese për realizimin e aktiviteteve promovuese dhe edukative.

Mjetet e parapara buxhetore nuk janë të nevojshme edhe në pjesën e mbulimit të harx-

himeve për zbatimin e vizitave edhe për pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare në kuadër të rrjetit dhe trupave në të cilat merr pjesë Mekanizimi Parandalues Nacional.

Në gjysmën e parë të vitit 2015, Mekanizimin Parandalues Nacional e përbënin dy këshilltarë (juristë të diplomuar) për parandalim të torturës dhe llojit tjetër të veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerezor ose poshtëruës. Edhe pse numri i të punësuarve nuk ishte i mjaftueshëm për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të anëtarit të tretë të MPN-së, vendi nuk u plotësua, prapë se prapë të punësuarit arritën plotësisht t'i realizojnë aktivitetet dhe kompetencat e parapara me Protokollin fakultativ dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.

Por në gjysmën e dytë të vitit 2015 anëtari i dytë i ekipit e ka ndërprerë marrëdhënien e punës dhe shkoi në vend të ri të punës, ndërsa në muajin tetor anëtari tjetër shkoi në pushim mjekësor afatgjatë, ashtu që Mekanizimi Parandalues Nacional mbeti pa asnjë realizues.

Avokati i Popullit shumë herë në Ministrinë e Financave është drejtuar me kërkesë për plotësimin e vendeve të zbrazëta të punës të Mekanizimit Parandalues Nacional, por prej atyre në vazhdimësi u morën përgjigje negative.

Gjendja e tillë shkakton reagime të Avokati i Popullit para trupave dhe institucioneve ndërkombëtare, ndërsa për këtë situatë u informua edhe Nënkomiteti për Parandalim të Torturës i KB-së. Vetëm disa ditë para përfundimit të vitit 2015, nga Ministria e Financave u dha pëlqimi për plotësimin e dy vendeve të zbrazëta të punës, por punësimet nuk mund të realizohen për shkak të mungesës së kohës për zbatimin e procedurës.

Edhe krahas gjendjes së tillë, me angazhime plotësuese të personit të punësuar nga sektori për mbrojtjen e Avokatit të Popullit, Programi vjetor i Mekanizmit Parandalues Nacional, në pjesë të madhe ishte realizuar.

Me përfshirjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm nga profile të ndryshme në punën e Mekanizmit Parandalues Nacional u realizua rekomandimi i Asociacionit për Parandalim të Torturës (APT) i cili rekomandon gjatë vizitave preventive përpos juristëve të përfshihen edhe persona të profesioneve të ndryshme të cilët me ekspertizën e vet do të ndihmojnë në përpilimin e analizës gjithëpërfshirëse për rreziqet e mundshme nga tortura dhe lloji tjetër i veprimit johuman.

Duke vepruar sipas rekomandimit të APT-së, Mekanizimi Parandalues Nacional në vitin 2015 përsëri lidhi memorandume për bashkëpunim me më shumë shoqata edhe atë Shoqatën e Psikiatërve, Shoqatën për Punëtor Social të Qytetit të Shkupit, Odën e Psikologëve, Lidhjen e Defektologëve të Republikës së Maqedonisë, Shoqatën e Forenzikëve në Institutin për Mjekësi Ligjore, Shoqatën për të Drejtë Penale dhe Kriminologji, si dhe Shoqatën Maqedonase për Juristë të Rinj.

Këta persona si bashkëpunëtorë të jashtëm, në pajtim me memorandumun dhe marrëveshjet që me ta ishin lidhur në mënyrë shtesë, ndërmorën një pjesë të autorizimeve të MPN-së gjatë kryerjes së vizitave. Me lidhjen e tyre në vizitat parandaluese, Mekanizimi Parandalues Nacional siguroi qasje eksperte dhe profesionale gjatë analizës së gjendjeve, veprimit dhe kushteve në vendet e privimit ose kufizimit të lirive të lëvizjes, ndërsa këto analiza eksperte ishin përfshirë në raportet e veçanta të cilat ANPM-ja i dorëzonte te organet kompetente dhe institucionet.

Si rezultat i bashkëpunimit me Komisaratin e Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara-UNHCR, Avokati i Popullit-Mekanizimi Parandalues Nacional kah fundi i vitit nënshkroi memorandum për bashkëpunim me këtë organizatë ndërkombëtare, me qëllim të kryerjes së monitorimit të kushteve, veprimit dhe trajtimit të emigrantëve/refugjatëve, të vendosur në Qendrën për të Huaj dhe Qendrën për Azilkerkues në Shkup dhe qendrat e përkohshme tranzitore "Tabanocë" dhe "Vinojug".

### **1.3. BASHKËPUNIMI ME ORGANET DHE INSTITUCIONET**

---

Sipas nenit 3 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, organet kompetente, organizatat dhe institucionet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar, janë të obliguara të veprojnë sipas sugjerimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe për veprimin ta njoftojnë në afat prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit të Raportit të veçantë.

Si në vitin e kaluar ashtu edhe gjatë këtij viti, për një pjesë të raporteve të dorëzuara MPN-ja në afatin e përcaktuar ligjor mori përgjigje me kohë, por në raste të caktuara për shkak të mungesës së përgjigjes duhej të ndërhynte në mënyrë shtesë, kështu që te institucionet e caktuara, entet dhe ministritë kompetente dërgoi në mënyrë shtesë urgjenca me shkrim.

Në vitin 2015, MPN-ja vazhdoi bashkëpunimin e mirë me personat zyrtarë në institucionet e vizituara dhe kishte qasje të pakufizuar në kushtet materiale të vendeve ku qëndrojnë, ose mbahen personat e privuar nga liria. Në kryerjen e vizitave të tyre të rregullta dhe të njëpasnjëshme, MPN-ja ka pasur takime të papenguara dhe me këtë rast ka folur me numër të madh të personave të privuar nga liria me zgjedhje të vet, pa mbikëqyrje dhe dëshmitarë. Ekipeve të Mekanizmit Parandalues Nacional në asnjë moment nuk i ishte kufizuar hapësira e lëvizjes e as liria e zgjedhjes së personave për bisedë.

### **1.4. INICIATIVA DHE MENDIME**

---

Në vitin 2015 Avokati i Popullit-Mekanizmi Parandalues Nacional, në përputhje me kompetencat që dalin nga Protokollin fakultativ ndaj Konventës kundër torturës dhe veprimit ose ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruar, Ligji për Avokatin e Popullit dhe Rregulloja e punës së Avokatit të Popullit, të Ministria e Punëve të Brendshme paraqiti mendim mbi Projekt-strategjinë nacionale për zhvillimin e sistemit të burgjeve në Republikën e Maqedonisë (2015-2019).

Në mendim, Avokati i Popullit-Mekanizmi-Parandalues Nacional theksoi se në Projekt-Strategjinë nacionale për zhvillimin e sistemit penitenciar në fakt janë paraqitur gjendjet në institucionet ndëshkuese përmirësuese, si dhe nevoja për të përmirësuar dhe për të përsosur sistemin për kryerje të sanksioneve, i cili është një angazhim i MPN-së me qëllim të parandalimit të torturës së mundshme ose llojit tjetër të veprimit mizor ose çnjerëzor.

MPN-ja përshëndeti vendosjen e sistemit të shërbimit të provës, por edhe përforcimin e resurseve njerëzore që janë parakushte për reduktimin e një pjese të dobësive në sistemin penitenciar, dhe theksoi se si pjesë e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë nacionale duhet të shtohet edhe Ministria e Financave. Në Mendim, MPN-ja theksoi se ministritë kompetente, veçanërisht Ministria e Financave duhet t'i pranojnë Strategjinë dhe Planin të veprimit, në të cilat janë paraparë implikimet financiare dhe periudha për realizimin e tyre, me prioritet për sa i përket sigurimit të resurseve njerëzore dhe kushteve materiale për vendosje të personave të dënuar. Sipas MPN-së, është i nevojshëm zbatimi në përputhje dhe në kohë i Planit të veprimit, me qëllim që Strategjia për zhvillim të sistemit penitenciar të jetë efektive, në drejtim të arritjes së sistemit penitenciar efikas që i plotëson standardet më të larta

evropiane për kryerjen e sanksioneve me respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të personalitetit të personave.

Në aspektin e harmonizimit të rregullativës ligjore në fushën e kryerjes së sanksioneve, MPN-ja theksoi se është e nevojshme që në Ligjin për kryerjen e sanksioneve të vendosen edhe risitë, në pikëpamje të standardeve në institucionet ndëshkuese përmirësuese, veçanërisht rekomandimet në lidhje me fëmijët dhe gratë. MPN-ja theksoi vërejtjen e tij në lidhje me përdorimin e nocionit "të mitur" dhe vuri në dukje se është i nevojshëm harmonizimi me terminologjinë e cila përdoret në Konventën për të drejtat e fëmijës përkatësisht për të mitur të përdoret nocioni „fëmijë“, i cili përfshin personin deri në moshën 18 vjeçare.

Gjithashtu MPN-ja rekomandoi miratimin e një Ligji të ri për kryerjen e sanksioneve, i cili do ta përcaktojë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të masave të sigurisë të parashikuara në të. Në këtë kuptim MPN-ja vuri në dukje se edhe pse formulimi aktual i Ligjit parashikon kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor është e nevojshme që dhe Drejtoria të ketë kompetencë në këtë pjesë, si organ që para së gjithash ka një rol në kryerjen e sanksionit përkatësisht masës së shqiptuar. Drejtoria, gjithashtu duhet të ketë kompetencë edhe në mbikëqyrjen e zbatimit të arsimit dhe kujdesit shëndetësor, si të drejta themelore gjatë shqiptimit të sanksioneve mbi personat e dënuar, edhe pse drejtpërdrejt përgjegjës për zbatimin e këtyre dispozitave janë Ministria e Arsimit dhe Ministria e Shëndetësisë.

## **1.5. PROMOVIMI I MPN-së DHE PËRFORCIMI I KAPACITETEVE NË FUSHËN E ZBATIMIT TË TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA**

Në kuadër të Tuning projektit me ombudsmanin Austriak dhe Institutin Ludvig Boltzmann, Avokati i Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional organizoi një Konferencë rajonale mbi gjendjen dhe sfidat e emigrantëve dhe azilkërkuesve, të mbajtur më 26 qershor në Shkup. Në Konferencë, krahas prezantimit të Mekanizmit Parandalues Nacional, u shpалosën edhe standardet e Komitetit Kundër Torturës të Këshillit të Evropës, si dhe roli i organeve ndërkombëtare për të përmirësuar situatën dhe mbrojtjen e personave - azilkërkues dhe të huajve që hyjnë në vend ilegalisht. Përvoja krahasuese u ndanë edhe nga përfaqësuesit e institucioneve austriake dhe Mekanizmi Parandalues Nacional Sloven, institucionet shtetërore dhe organizatat joqeveritare që punojnë në këtë fushë.

Në fushën e përforsimit të kapaciteteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar u realizua udhëtim studimor në Austri, i cili u organizua në kuadër të Tuning projektit me Ombudsmanin austriak dhe Institutin Ludvig Boltzmann. Në këtë udhëtim studimor delegacioni i Mekanizmit Parandalues Nacional me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira vizitoi stacionin e policisë, ku mbahen të huajt që hyjnë në mënyrë të paligjshme, dhe Qendrën për Strehimin e Azilkërkuesve. Gjithashtu, në kuadër të Tuning projektit një ekip i përbashkët nga MPN-ja maqedonase dhe MPN-ja austriake realizuan vizitë të Qendrës për Azilkërkues në Vizbeg.

Viti Raportues iu përkushtua situatës së emigrantëve të paligjshëm dhe azilkërkuesve, dhe në këtë drejtim u zhvilluan aktivitetet për përforsimin e kapaciteteve të Seksionit për Parandalimin e Torturës. Për më tepër, MPN-ja ka marrë pjesë në trajnimet bazike për intervistimin e viktimave të torturës që është kryer bashkërisht nga organizatorët e Tuning projektit,

përkatësisht ekspertët nga Instituti Ludwig Boltzmann, si dhe Ombudsmani Austriak.

Në Ditën ndërkombëtare për mbështetje të viktimave të torturës, Mekanizmi Parandalues Nacional prezantoi Raportin vjetor për vitin 2014, i cili përmban një pjesë të veçantë tematike për mbrojtjen e të drejtave gjatë hospitalizimit të detyrueshëm në institucionet psikiatrike në Republikën e Maqedonisë.

## **1.6. DUKSHMËRIA DHE TRANSPARENCA NË PUNËN E MPN-së**

---

Në drejtim të sigurimit të punës transparente, nëpërmjet veb-faqes së tij, Mekanizmi Parandalues Ndërkombëtar edhe gjatë vitit 2015 vazhdoi të informojë publikun për të gjitha aktivitetet në drejtim të vizitave të realizuara parandaluese dhe iniciativat dhe mendimet e parashikuara në lidhjen e mëposhtme: [http://www.ombudsman.mk/ombudsman/MK.nacionalen\\_preventiven\\_mehanizam](http://www.ombudsman.mk/ombudsman/MK.nacionalen_preventiven_mehanizam)

Me qëllim të rritjes së transparencës dhe qasjes së qytetarëve, të dhënat dhe informatat janë publikuar në tri gjuhë (maqedonisht, shqip dhe anglisht).

## **1.7. PARAQITJA DHE SHPËRNDARJA E RAPORTI VJETOR**

---

Me rastin e Ditës ndërkombëtare në mbështetje të viktimave të torturës, Mekanizmi Parandalues Nacional më 25/06/2015 paraqiti përkatësisht publikoi Raportin vjetor për vitin 2014, i cili përmban edhe një pjesë të veçantë tematike për mbrojtjen e të drejtave gjatë hospitalizimit të detyrueshëm në institucionet psikiatrike në Republikën e Maqedonisë.

Më vonë, raporti i është dorëzuar Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, ministrive kompetente, por edhe organeve, institucioneve dhe institucioneve ku kryhet privimi ose kufizimi i lirisë së lëvizjes.

Ajo që është më e rëndësishme, dhe që si një detyrim që rrjedh nga Protokollin opsional i Konventës kundër torturës, është se raporti vjetor i është dorëzuar Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës të Kombeve të Bashkuara. Gjithashtu, raporti i dorëzohet edhe Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Veprimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës, si dhe institucioneve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare për parandalimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

## 1.8. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE DHE BASHKË-PUNIMI ME INSTITUCIONET NDËRKOMBËTARE PËR PARANDALIMIN E TORTURËS DHE VEPRIMIT OSE NDËSHKIMIT TJETËR MIZOR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES

Në vitin 2015 MPN-ja ka marrë pjesë në përgatitjen e Raportit alternativ të cilin Avokati i Popullit ia dërgoi Komitetit Kundër Torturës të Kombeve të Bashkuara. Në Raportin Alternativ u prezantuan gjendjet në vendet e privimit nga liria të cilat MPN-ja i ka vizituar, si dhe situata shqetësuese me kushtet dhe trajtimin e refugjatëve dhe azilkërkuesve të vendosur në Qendrën e Pranimit për të Huaj në Gazi Babë.

Njëkohësisht Komiteti Kundër Torturës i KB-së u informua edhe për mungesën e buri-meve njerëzore në kuadër të MPN-së, përkatësisht kufizim në aspektin e punësimit të rregullt të profileve përkatëse me çka do të përforcohet roli si dhe efektiviteti i këtij mekanizmi, i cili përveç vizitave të rregullta parandaluese është mandatuar për të marrë pjesë në përgatitjen e zgjidhjeve ligjore, që janë në interes të personave të privuar nga liria, por edhe në pjesën e edukimit të të punësuarve në vendet e privimit të lirisë.

Në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare ka qenë edhe pjesëmarrja në 25-vjetorin e Komitetit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës, si dhe pjesëmarrja në dy punëtori që u mbajtën në Tiranë në kuadër të MPN Rrjetit të Evropës Juglindore. Punëtorja e parë ishte e përkushtuar për kujdesin shëndetësor në vendet e privimit nga liria, ndërsa tjetra e përfshiu temën e monitorimit të vendeve ku ndodhen ose mbahen emigrantë të paligjshëm dhe azilkërkues.

Avokati i Popullit-Mekanizmi Parandalues Nacional, gjithashtu mori pjesë në Konferencën me temë "Ombudsman/Institucionet Nacionale për të Drejtat e Njeriut-Sfidat për të drejtat e refugjatëve dhe emigrantëve në kohë krize", të mbajtur në Beograd, të organizuar nga Mbrojtësi i qytetarëve/Ombudsmani i Republikës së Serbisë.

Në Konferencë MPN-ja foli mbi temën "Sfidat e veprimit të Avokatit të Popullit në kushtet e krizës së emigrantëve". Pjesëmarrësit diskutuan për sfidat me të cilat përballen vendet e tranzitit dhe vendet që janë destinacioni i fundit në kushte të krizës së emigrantëve, për mënyrën e monitorimit dhe mbrojtjes së të drejtave të refugjatëve dhe emigrantëve për të zhvilluar vetëdijen dhe ndikimin e institucioneve të ombudsmanit në krijimin e politikave pozitive të shteteve për trajtimin dhe mbrojtjen e emigrantëve dhe refugjatëve.

Gjithashtu, u theksua nevoja për promovimin e të drejtave të refugjatëve dhe emigrantëve, përforcimi i bashkëpunimit me sektorin joqeveritar dhe shkëmbimi i përvojave të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e ballafaqimit me krizën e emigrantëve. Në Konferencë u miratua Deklarata mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të refugjatëve dhe emigrantëve, në përpilim e të cilës mori pjesë MPN-ja në takimin përgatitor të mbajtur paraprakisht në Beograd.

Me ftesë të Këshillit të Evropës, Avokati i popullit-Mekanizmi Parandalues Nacional mori pjesë në Konferencën „Liria e shprehjes-ende një parakusht për demokracinë“, të mbajtur në Strasburg, Francë.

Në kuadër të aktiviteteve të rrjetit të të mekanizmave parandalues nacionalë të Evropës



Juglindore, përfaqësues i MPN-së dhe bashkëpunëtor i jashtëm i Asociacionit të Juristëve të Rinj të Maqedonisë morën pjesë në Konferencë- në Punëtorinë me titull „Azilkërkesit, refugjatët dhe kthimi i emigrantëve në Evropën Juglindore.



# VIZITA TË RREGULLTA PARANDALUESE NË VITIN 2015

Protokolli fakultativ ndaj Konventës kundër torturës të Kombeve të Bashkuara ka konstatuar se qëllimi i vizitave të rregullta në vendet ku personat janë të privuar nga liria është të identifikojë rreziqet me qëllim parandalimin e torturës ose llojin tjetër të veprimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Në këtë drejtim, MPN-ja gjatë periudhës raportuese realizoi vizita të rregullta si pjesë e mandatit të tij, me ç’rast u angazhuan edhe bashkëpunëtorë të jashtëm.

Disa nga vizitat janë kryer pa paralajmërim, në përputhje me programin vjetor të punës të përcaktuar dhe miratuar më parë, ndërsa një pjesë e vizitave janë kryer me njoftim paraprak për shkak se u zhvilluan në kuadër të Tuining projektit në mbështetje të Institucionit Avokati i Popullit dhe u zhvilluan bashkë me anëtarët e Mekanizmit Parandalues Nacional të Austrisë.

Gjegjësisht, gjatë vitit 2015 Mekanizmi Parandalues Nacional-MPN realizoi 7 vizita të rregullta, duke përfshirë 1 vizitë në stacionin e policisë me kompetencë të përgjithshme (SP Negotinë), 2 në institucionet ndëshkuese-përmirësuese, nga të cilat 1 në pjesën e paraburgimit Burgu Shkup dhe 1 në Burgu Shkup (repart i mbyllur), 1 në Institucionin Shëndetësor Publik (ISHP Enti Gjerontologjik „13 Nëntori” Shkup-reparti „Nënë Tereza”), dhe 3 vizita në institucione të tjera (IP „Instituti për Rehabilitim të Fëmijëve dhe të Rinjve”, Shkup, IP për kujdesin e fëmijëve me probleme edukativo-sociale „25 Maj”, Shkup dhe IP për kujdesin, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve „Ranka Milanoviq” Shkup).

Në të gjitha vizitat e kryera MPN hasi në dialog konstruktiv dhe bashkëpunim efektiv nga ana e personave zyrtarë, realizoi kontroll të papenguar në të gjitha objektet dhe bisedë me të gjithë personat me zgjedhje personale, në besueshmëri të plotë, pa praninë dhe mbikëqyrjen e personave zyrtarë.

## 2.1. STACIONI POLICOR ME KOMPETENCË TË PËRGJITHSHME NEGOTINË

Stacioni policor me kompetencë të përgjithshme Negotinë (SPKP), sipas vendimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme është përcaktuar si vend për mbajtjen e personave të privuar nga liria. Vizita e këtij stacioni policor është kryer nga ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional, së bashku me bashkëpunëtorin e jashtëm nga Shoqata e Avokatëve të Rinj të Maqedonisë, në bazë të Memorandumit për mirëkuptim të nënshkruar më parë.

Në një vizitë të paparalajmëruar në Stacionin Policor Negotinë, ekipi i MPN-së i përcaktoi gjendjen dhe kushtet në qendrat për mbajtjen e personave të privuar nga liria dhe trajtimin e



personave të mbajtur. Gjatë vizitës në PS Negotinë nuk kishte persona të mbajtur të vendosur në vende të përshtatshme për mbajtje.

Stacioni policor Negotinë është në kompetencë të SPB Veles. Në vitin 2015, në këtë stacion policor janë evidentuar rreth 100 privime nga liria dhe mbajtje të personave, që është numri më i madh i ndërhyrjeve policore nga stacionet policore të rrethit në Veles dhe Kavadar, si rezultat i rritjes së numrit të mbajtjes së personave të dyshuar për vepër penale kontrabandë e emigrantëve.

### 2.1.1. Kushtet materiale

Stacioni policor Negotinë nuk ishte përfshirë me projektin për rinovimin e vendeve për mbajtjen e personave të privuar nga liria që është zbatuar nga MPB-ja, që reflektohet edhe në kushtet materiale në stacion.

MPN-ja konstaton se në përbërje të stacionit policor ka dy lokale të vjetra për mbajtje, që janë vendosur në katin përdhes në afërsi të zyrës së udhëheqësit të turnit, por nuk ekziston lokal i veçantë për mbajtje të fëmijës. Njëri lokal është për mbajtje individuale me një shtrat, ndërsa tjetri për mbajtje kolektive, me dy shtretër

Në përcaktimin e gjendjeve në lokale, MPN-ja udhëhiqej nga standardet ndërkombëtare në lidhje me nivelin e lejuar të lagështisë dhe të dritës, me ç'rast konstatoi:

Hapësira individuale e dedikuar për ndalimin e një personi është me sipërfaqe prej 3.18 m<sup>2</sup> (gjatësi) dhe 1.75 m<sup>2</sup> (gjerësi), me çka përmbushet standardi minimal prej 4 m<sup>2</sup> për person. Lagështia e ajrit në hapësirë ishte 63%<sup>1</sup>. e që është mbi nivelin e lejuar të lagështisë, të cilin duhet ta ketë hapësira ku ndalohen personat Shtroja ishte e pastër dhe e rregullt, ndërsa në hapësirë higjiena mirëmbahej mirë. MPN vërejti se ndriçimi natyror në hapësirë është i dobët dhe nuk është në përputhje me standardet për vendet ku privohen dhe ndalohen personat e privuar nga liria, ndërsa ndriçimi artificial nga jashtë, hyn përmes një hapjeje të vogël në pjesën e sipërme të derës.

Lokali i dytë për vendosje kolektive është i dedikuar për të mbajtur maksimum dy persona, ku është matur lagështi prej rreth 63%, me çka edhe në këtë lokal lagështia e tejkalon kufirin e përcaktuar. Edhe në këtë lokal ka vetëm një dritare të vogël ku ka një depërtim të

1 Standardet e pranueshme për lagështi prej 20-60 % R.H

vogël të dritës gjatë ditës. Ekipi i MPN-së gjatë inspektimit të lokalit vërejtë më shumë gjurmë gjaku në dy muret, gjë që mund të ndikojë negativisht dhe të krijojë frikë te personi i mbajtur se do të ekspozohet në torturë dhe keqtrajtim, në mënyrë që ai të detyrohet për të pranuar diçka. Të dy lokalet kanë siguruar video mbikëqyrje që gjendet në zyrën e pranimit.

Në lokalet për mbajtje nuk ishte instaluar interfon as sistem tjetër për thirrje, me çka pamundësohet kontakti i personave të privuar nga liria me personat zyrtarë në Stacionin Policor.

Në të dy lokalet nuk është instaluar sistem i veçantë i ngrohjes qendrore, ndërsa ngrohja është nëpërmjet trupave ngrohës të vendosur në korridor, me të cilët nuk mund të arrihet temperatura e dëshiruar.

Ekipi i MPN-së gjatë vizitës së lokaleve për mbajtje, si dhe të lokaleve të tjera zyrtare nuk hasi mjete me të cilat mund të kryhet frikësimi ose gjëra tjera të dyshimta.

### **Nyja sanitare**

BNë korridorin prej ku hyhet në të dy lokalet për mbajtje të personave të privuar nga liria është një tualet i cili dedikohet vetëm për personat e mbajtur. Duke pasur parasysh konkluzionin se në lokalet për mbajtje nuk është instaluar interfon as ndonjë sistem tjetër për thirrje, personat e mbajtur nuk mund të realizojnë kontakt me personat zyrtarë, pra së këtejmi kryerja e nevojave bazë fiziologjike dhe higjienike është e diskutueshme. Përndryshe tualeti është pa derë, me çka personave të mbajtur u pamundësohet kryerja e nevojave fiziologjike në kushte dinjitoze, nuk ka ujë, me çka pamundësohet mbajtja dhe plotësimi i nevojave higjienike të personave të mbajtur.

Sipas MPN-së kushtet e tilla shkaktojnë që personat e mbajtur të ekspozohen në turp dhe degradim të dinjitetit njerëzor.

### **Lokalet dhe kushtet për bisedë dhe marrje në pyetje**

Në PS Negotinë nuk ka vend të veçantë për marrje në pyetje. Biseda me personat e mbajtur kryhet në zyrën e udhëheqësit të turnit që është lokal i rregulluar për zyrë dhe nuk është i përshtatshëm për bisedë me personat e mbajtur (sidomos jo marrje në pyetje), kryesisht për shkak të pozitës dominuese në të cilën vendoset personi zyrtar i cili e kryen marrjen në pyetje lidhje me personin e mbajtur.

Ka një numër të pamjaftueshëm të personave për pranim, ose udhëheqës të turnit obligimi i të cilëve është të kryejnë pranimin e personit të mbajtur, e të cilët janë përgjegjës edhe për mbajtjen e procedurës së mëtejshme për lirim të personit, përkatësisht deri në dorëzimin e personit te organet tjera kompetente, në varësi të rezultatit të procedurës. Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional-MPN-së i është dhënë për shqyrtim akti në Urdhëresë e Komandantit të SP Negotinë për angazhimin e nëpunësve policorë kujdestarë si udhëheqës të turnit kur është e nevojshme.

## **2.1.2. Realizimi i të drejtave të personave të mbajtur**

### **Informatat dhe këshilla për të drejtat**

MPN-ja gjatë inspektimit konstatoi që të drejtat e qytetarëve ishin theksuar në mënyrë të rregullt në stacionin policor edhe atë në derën hyrëse, në korridor dhe dyert e të dy lokaleve për mbajtje. Janë përgatitur edhe fletëpalosje në disa gjuhë që janë në dispozicion për personat nga momenti i privimit nga liria.

Të drejtat e personave të mbajtur janë theksuar në mënyrë përkatese edhe në pjesën e lokaleve për mbajtje, përkatesisht ato janë vendosur në dyert e lokaleve për mbajtje.

### **E drejta për ujë dhe ushqim**

Sipas standardeve ndërkombëtare personave të privuar nga liria u garantohet e drejta për ushqim, ndërsa procedurat standarde operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme personit të mbajtur i përcaktojnë së paku një vakt në kohën e mbajtjes (nëse mbahet më shumë se 6 orë).

MPN-ja arriti në përfundimin se stacioni policor nuk disponon me zë të veçantë buxhetor për sigurimin e ushqimit për personat e mbajtur. Ushqimi, përkatesisht vakti sigurohet nga mjetet me para për personin e mbajtur, ndërsa në rastin kur personi i mbajtur nuk ka mjete të veta, atëherë sigurohet nga mjetet e nëpunësve policorë.

### **E drejta për avokat dhe njoftimi i familjes**

Nga kontrollimi i dosjeve të personave të mbajtur dhe të paraburgosur, si dhe nga informatat e marra nga udhëheqësi i turnit, si dhe nga procesverbali për të drejta dhe këshilla për avokat, është e qartë se personat janë të informuar për të drejtën e tyre për të angazhuar avokat dhe ai është i angazhuar që nga fillimi i privimit të tyre nga liria.

Personat e mbajtur më së shpeshti angazhojnë avokat me zgjedhje dhe shpenzime të tyre, nga lista e avokatëve të dërguar nga Oda e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë, e cila shpesh nuk është e përditësuar në kohë.

Realizimi i të drejtës për avokat shpesh varet nga gjendja materiale e personit të mbajtur. Sipas informatave të marra nga personat zyrtarë personat e mbajtur janë të informuar në lidhje me të drejtën për avokat, por shpesh për shkak të gjendjes së vështirë financiare refuzojnë për të angazhuar ndihmë juridike.

Në bazë të Ligjit për ndihmë juridike falas, personat e mbajtur nuk bëjnë pjesë në të ashtuquajturit shfrytëzues të ndihmës juridike falas dhe nuk mund të marrin avokat falas i cili do të sigurohet nga shteti. Sipas Ligjit për procedurë penale personat mund të marrin ndihmë juridike falas në një fazë të mëvonshme të procedurës, kur personi ka statusin e një të dyshuari edhe atë për vepra penale për të cilat është paraparë mbrojtje e detyrueshme.

MPN-ja konstaton se qasja në të drejtën për avokat të personave të mbajtur të cilët janë në gjendje materiale të pavoritshme si e drejtë themelore është e kufizuar, përkatesisht e kufizuar është qasja në drejtësi e këtyre personave të cilët janë të vendosur në një pozitë të pabarabartë në krahasim me qytetarët e tjerë në Republikën e Maqedonisë.

### **E drejta për mjek**

Procedurat standarde operative për veprim me persona të cilëve u është kufizuar e drejta e lirisë së lëvizjes parashikojnë se gjatë vet pranimit konstatohet gjendja psiko-fizike e personit të mbajtur (lëndime të dukshme, shenja të sëmundjes, çrregullim mendor, etj). Në qoftë se personi i mbajtur është i lënduar, nëpunësi policor për pranim - udhëheqësi i turnit kërkon ekzaminim mjekësor. Në rast të lëndimit të rëndë ose nëse personi i mbajtur ankohe për dhimbje ose lëndime, e drejta për sugjerim të ndihmës mjekësore është primare dhe e domosdoshme para marrjes së të gjitha veprimeve tjera.

Në SP Negotinë, sipas informatave të marra nga udhëheqësit e turneve, nëse personat e

mbajtur kërkojnë të ekzaminohen nga mjeku apo kanë lëndime të dukshme detyrimisht thirret shërbimi urgjent mjekësor ose personi dërgohet në institucion të përshtatshëm mjekësor për dhënien e ndihmës mjekësore.

Ekipi i NPM-së nga inspektimi i dosjeve individuale konstatoi se thirret mjek, përkatësisht e drejta për mjek realizohet në mënyrë përkatëse dhe me kohë.

### 2.1.3. Inspektimi i evidencës dhe regjistrave për personat e mbajtur

Gjatë vizitës së SP-Negotinë u inspektuan regjistrat dhe dokumentet për: evidencën e personave të privuar nga liria dhe të personave të mbajtur, evidencën e personave të arrestuar; evidencën e ngjarjeve të ditës, evidencën e parashtrësive të parashtruara të qytetarëve kundër nëpunësve policorë dhe masat e marra në dosjet për personat e mbajtur (6 dosje me zgjedhje të rastësishme).

Mekanizmi Parandalues Nacional inspektoi dokumentacionin e plotë që mbahet për personat e privuar nga liria, me ç'rast konstatoi se ato (evidenca e ngjarjeve ditore, evidenca e personave të mbajtur dhe atyre të privuar nga liria, evidenca e personave të paraburgosur, evidenca e parashtrësive dhe ankesave të parashtruara) si dhe lëndët individuale për persona të mbajtur të cilët janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme mbahen me rregull pa gabime të mëdha dhe korrigjime.

Deri në ditën e vizitës (në tetor 2015) në librin e ngjarjeve ditore të regjistruara janë - 1791 ngjarje, në librin e të arrestuarve - 68 persona, në librin e personave të mbajtur - 92 persona, në librin e parashtrësive dhe ankesave janë paraqitur 2 parashtrësia në vitin 2014 dhe 1 në 2015. Gjatë kontrollimit të 6 dosjeve me përzgjedhje të rastësishme është konstatuar lidhshmëri numerike ndërmjet Librit për ngjarje ditore dhe Regjistrat për persona të thirrur, të arrestuar ose të mbajtur, që jep mundësi për kontrollin e lehtë të të dhënave, sidomos në aspektin e kohës së mbajtjes.

Lëndët e veçanta i përfshijnë të gjitha dokumentet përkatëse, si: procesverbalin e mbajtjes, në të cilin është theksuar dita dhe ora e privimit nga liria të personit, procesverbalin e këshillimit të personit për të drejtat e tij, procesverbalin e të drejtës për avokat, procesverbalin e nevojës për mjek dhe ndihmë mjekësore si dhe dokumentet për të cilat vet SP në mënyrë interne ka vendosur se është e nevojshme të përgatiten.

Praktikë pozitive është se stacioni policor mban evidencë për marrje të masave dhe veprimeve në lidhje me personat e arrestuar dhe të mbajtur edhe atë nga fillimi deri në datën e përfundimit të masës.

MPN-ja konstatoi se në dosje mungojnë të dhëna rreth ushqimit që e marrin personat e mbajtur, sepse Stacioni Policor Negotinë nuk disponon me buxhet për sigurimin e ushqimit për personat e mbajtur, që shpie në situatën që personat ta sigurojnë ushqimin nga mjetet e tyre, ose ai të blihet nga mjetet personale të nëpunësve policorë.

### 2.1.4. Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

Avokati i Popullit-MPN për gjendjet e konstatuara nga vizita ka përgatitur një Raport të veçantë me rekomandime konkrete të cilin e dorëzon te Ministria e Punëve të Brendshme dhe Komandanti i Stacionit Policor Negotinë.

Ministria e Punëve të Brendshme dorëzoi përgjigje jashtë afatit të paraparë ligjor, ndërsa

pas sugjerimit të urgjencës nga MPN-ja, ndërsa komandanti i Stacionit Policor Negotinë, as pas sugjerimit të urgjencës nuk dorëzoi përgjigje.

Në lidhje me rekomandimin e dorëzuar nga MPN-ja që të rinovohet lokali për mbajtje kolektive, Ministria informon se lokali ndërkohë është gëlqerosur dhe gjurmët e gjakut janë mënjanuar.

Në lidhje me rekomandimin e dorëzuar nga MPN-ja që të vendoset sistem për thirrje, përkatësisht interfon, Ministria u përgjigj se rekomandimi është në fazën e realizimit. Në këtë kontekst njoftohet se SPM Veles te Njësia për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta e Ministrisë së Punëve të Brendshme ka dorëzuar kërkesë për sigurimin dhe instalimin e pajisjes –sistem për thirrje.

MPN-ja është e njoftuar se është dorëzuar edhe kërkesë për rikonstruktimin e dritareve në lokalet e mbajtjes ndërsa është dërguar edhe kërkesë te Oda e Avokatëve të Maqedonisë për përditësimin e listës së avokatëve të zonës së qytetit të Negotinës.

Në lidhje me rekomandimin e MPN-së për punësim të personit për praninë – udhëheqës të turnit Ministria u përgjigj se bëhen përpjekje për plotësim kadrovik të vendit të lirë.

Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka dorëzuar përgjigje në lidhje me rekomandimin e MPN-së për ndërtimin urgjent të lokaleve të reja për mbajtje, të cilat do t'i plotësojnë në tërësi standardet minimale për mbajtje të personave (me tualete të veçanta) dhe të rregullohet lokal i veçantë për mbajtjen e fëmijëve.

## 2.2. INSTITUCIONET NDËSHKUESE PËRMIRËSUESE

Në vitin 2015 Mekanizmi Parandalues Nacional zhvilloi një vizitë të rregullt të **paparalajmëruar në repartin e Burgut Shkup** dhe një vizitë të rregullt në **seksionin e mbyllur të Burgut Shkup**. Vizita u organizua në kuadër të mandatit dhe kompetencave që dalin nga Protokollin fakultativ i Konventës kundër torturës dhe veprimeve ose ndëshkimeve të tjera, çnjëzore ose poshtëruese dhe Ligji për Avokatin e Popullit. MPN-ja e realizoi vizitën e shoqëruar nga një bashkëpunëtor i jashtëm i Shoqatës së Psikiatërve të Maqedonisë, në bazë të një Memorandumi të nënshkruar më parë për bashkëpunim.

### 2.2.1. Vizita e Burgut Shkup-reparti i paraburgimit

#### Kushtet materiale

Seksioni i paraburgimit në Burgun Shkup disponon me kapacitet prej 310 persona të paraburgosur, ndërsa në momentin e vizitës ishin vendosur 322 persona. Gjatë inspektimit u konstatua se ka filluar me rinovimin e një pjese të paraburgimit, me ç'rast është evidente përmirësimi i dukshëm i kushteve materiale në lokalet e rinovuara në të cilat janë vendosur personat e paraburgosur.

Ekipi i MPN-së vizitoi disa lokale të pjesës së vjetër dhe të re, me ç'rast konstatoi:

Nga inspektimi i lokaleve në pjesën e vjetër të njësies së paraburgimit, MPN konstatoi përmirësim të kushteve në disa lokale të cilat ishin gëlqerosur plotësisht (lokalet e qëndrimit dhe korridoret). Janë vërejtur edhe aktivitete për rinovim të mëtejshëm të lokaleve të tjera të paraburgimit me qëllim të përmirësimit të kushteve materiale në pjesën e vjetër të njësies së paraburgimit.

MPN konstatoi se në një lokal të madh janë vendosur 12 persona të paraburgosur që kanë në dispozicion vetëm një nyjë sanitare. Edhe pse lokali ishte gëlqerosur, ai nuk i plotëson standardet për vendosje të personave të privuar nga liria, për shkak të depërtimit të dobët të dritës gjatë ditës, ajrosjes së pamjaftueshme dhe për shkak të numrit të madh të personave të vendosur. Shtroja ishte personale e personave të paraburgosur, por ishte e papastër dhe e parregulluar.

Temperatura e ajrit në dhomë ishte 19°C dhe lagështia 59%, që përfaqësojnë vlerat normale dhe të pranueshme për vendet ku janë vendosur personat e privuar nga liria<sup>2</sup>. Personat e vendosur në të njëjtën dhomë thanë se rregullisht bëjnë dush, dhe se të drejtën për ajër të pastër e shfrytëzojnë vetëm një orë, ndërsa sipas Ligjit për Procedurë Penale personat e paraburgosur kanë të drejtë për ajër të pastër të paktën dy orë në ditë.

Nga inspektimi i kryer rezultoi përfundimi se kushtet materiale në repartin e paraburgimit në Burgun Shkup, ndryshojnë nga njëri krah në tjetrin.

Gjegjësisht, në krahun C kushtet materiale janë në gjendje shumë të keqe. Lokalet dhe korridori i këtij krah janë tepër të vjetra, ndërsa ka edhe sasi të madhe të lagështisë.

Ekipi i MPN-së nga inspektimi në një lokal të këtij krah konstatoi se ai është në gjendje shumë të keqe materiale, muret janë të rrënuara dhe të vjetra e të ndyra. Në shtretërit në të njëjtin lokal ishin vendosur dyshekë të vjetër, baza e krevateve ishte e dëmtuar, e në të ishin vendosur shishe të zbrazëta plastike dhe dërrasa prej druri. Në dhoma nuk ka dollapë të veçanta dhe të paraburgosurit e vendosur në këtë dhomë, sendet e tyre personale i mbajnë nën shtretër.

Shumica e objekteve të paraburgimit nuk kanë të instaluar sistemin e alarmit (zile), ndërsa edhe në ambientet ku ka alarme të instaluara, ato nuk punojnë. Duke pasur parasysh gjendjen me alarme në objektet e paraburgimit parashtrohet pyetja se në cilën mënyrë personat e privuar nga liria i informojnë personat zyrtarë për nevojat e tyre urgjente.

Nga inspektimi i një dhome në pjesën e re të seksionit të paraburgimit MPN konstatoi se ishin vendosur 3 krevate ku ishin vendosur tre persona të paraburgosur, në të njëjtin lokal është matur temperaturë prej 20°C dhe lagështi prej 37%, që përfaqësojnë vlerat normale dhe të pranueshme për vendet ku vendosen personat e privuar nga liria. Në lokal kishte të vendosur trupa për ngrohje, ndërsa në bazë të informatave të marra nga personat e paraburgosur ngrohja edhe në periudhën e dimrit ishte e kënaqshme.

Në lokalet e tjera të paraburgimit në pjesën e re MPN konstatoi inventar të shkatërruar, ndërsa muret e këtyre lokaleve ishin të pista dhe të pa gëlqerosura. Është matur temperaturë prej 200°C dhe lagështi prej rreth 51%, ndërsa kishte depërtim të mjaftueshëm të dritës gjatë ditës.

Edhe pse këto lokale janë të vendosura në repartin e ri, ku do të duhej që kushtet materiale të jenë në një nivel më të lartë, përkatësisht si në lokalin e lartpërmendur, megjithatë ekipi i MPN-së gjatë vizitës konstatoi kushte të këqija materiale edhe në këtë pjesë të paraburgimit.

Nga vizita e pjesës ku janë vendosur persona të gjinisë femërore, MPN-ja konstatoi se kushtet materiale dhe higjiena janë në nivel të kënaqshëm. Gjegjësisht, gjatë inspektimit, në një nga lokalet ekipi konstatoi se aty ka depërtim të mjaftueshëm të dritës gjatë ditës, në shtretër kishte batanije të pastra dhe shtroja ishte e rregulluar.

Për mbajtjen e pastërtisë në lokale personat e paraburgosur marrin mjete për pastrim, ndërsa për higjienë personale shfrytëzojnë mjete të tyre. Tualetet ishin në gjendje mjaft të mire, ndërsa higjiena e tyre ishte në nivel mjaft të kënaqshëm.

Nga ekipi I MPN-së u vizituan lokalet ku ishin vendosur persona të mitur dhe është kryer inspektim i kushteve materiale në lokale. Me këtë rast takoi dy persona të mitur të vendosur me urdhër të gjykatës kompetente.

<sup>2</sup> Standardet e pranuar për temperaturën janë prej 18-25°C, ndërsa për lagështi prej 20-60 R.H



Dy personat e mitur ishin kontrolluar me kohë nga mjeku, të kontrolluar dhe të vizituar nga psikiatri, përkatësisht ishin ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme nga personeli i burgut.

Nga inspektimi i lokalit ku ishin vendosur personat e mitur konstatohet s kishte të vendosur dy shtretër dhe një tryezë prej druri, por nuk kishte asnjë karrige për tu mundësuar të miturve të ulen dhe të konsumojnë ushqimin në mënyrë përkatëse. Lokali nuk kishte në dispozicion dollap të veçantë ku personat e mitur do të mund t'i ruanin gjërat e tyre personale.

Sipas MPN-së kushtet për vendosje nuk janë përkatëse për këtë kategori të personave dhe duhet t'i kushtohet më tepër kujdes të gjitha aspekteve të paraburgimit të personave të mitur, para së gjithash shëndetit të tyre mendor dhe mbështetjes së vazhdueshme sociale.

### ***Hapësira për shëtitje në ambient të hapur***

Në pjesën e seksionit të paraburgimit ekzistojnë shëtitore ku personat e paraburgosur e realizojnë të drejtën e qëndrimit në ambient të hapur.

Ekipi i MPN-së inspektoi dy prej tyre, me ç'rast konstatoi se në shëtitore nuk ka të vendosur vend për pushim (tavolinë, karrige, etj) pushimi, por ka një pjesë të vogël të mbuluar mbrojtëse (nën vazhdim të ndërtesës), e cila shfrytëzohet për shëtitje të personave të paraburgosur gjatë kushteve të motit të keq.

### **Të drejtat e personave të paraburgosur**

#### ***E drejta e mbrojtjes shëndetësore***

Mbrojtjen shëndetësore në pjesën e paraburgimit të Burgut Shkup e kryejnë 2 mjekë, 2 stomatologë dhe 2 infermiere. Mbrojtja shëndetësore është në dispozicion 24 orë, me mjek në dispozicion në thirrje. Gjithashtu në burg është i punësuar psikiatër që kryhen vizitë të të personave të paraburgosur një herë në javë, ndërsa sipas nevojës angazhohen edhe mjek të tjerë-specialistë. Sipas informatave, nëse ka nevojë të paraburgosurat dërgohen në kontroll gjinekologjik në institucion të përshtatshëm mjekësor, për shkak se në burg nuk ka të punësuar mjek-gjinekolog.

Qëndrimi i MPN-së është se për mbrojtje shëndetësore të përshtatshme të grave është i nevojshëm siguri i kontroleve të rregullta gjinekologjike, rrjedhimisht angazhimi i mjekut-gjinekolog.

Gjatë vizitës MPN-ja bisedoi me dy persona të mitur të cilët informuan se u është bërë kontroll me kohë nga mjeku. Bashkëpunëtori i jashtëm i MPN-së, mjek-psikiatër zhvilloi bisedë individuale (të besueshme) me një person të mitur i cili u ankua se një kohë të gjatë nuk mund të flinte dhe se vazhdimisht i paraqitet imazhi nga vepra penale e kryer. Ekipi i MPN-së mjekut të Burgut Shkup I sugjeroi që në vazhdimësi ta ndjekë gjendjen shëndetësore dhe psikike të fëmijës.

Në burg ka dy ambulanca, për pjesën e burgut dhe për pjesën e paraburgimit të cilat janë të pajisura siç duhet, aty higjiena mbahet në mënyrë solide, ndërsa dokumentacioni ruhet në mënyrë adekuate. Ekipi i MPN-së inspektoi dokumentacionin mjekësor, dhe njëkohësisht diskutoi edhe me personelin mjekësor - mjekun dhe infermierën, me ç'rast konstatoi se në të gjitha rastet janë marrë të gjitha procedurat e nevojshme diagnostikuese, përkatësisht personat janë dërguar në institucione përkatëse, me ç'rast udhëheqësia e burgut ka mundësuar mbështetje me kohë në pjesën e transportit. Për të gjitha rastet e përkeqësimit akut të shëndetit janë marrë masa me kohë, dhe është reaguar në mënyrë përkatëse.

MPN-ja konstaton se personat e paraburgosur kontrollohen para pranimit në institute,

në afat prej 24 orësh.

Nga biseda me personat e paraburgosur MPN-ja mori disa ankesa në lidhje me përfshirjen e vonshme në terapi, ndarjen jo në kohë të terapisë, veprimin jo në kohë me ankesat në lidhje me problemet e shëndetit, si dhe dërgimin jo në kohë në institucion shëndetësor. Pas marrjes së masave për kontrollim të ankesave, MPN-ja nuk konstatoi raste të ofrimit të papërshtatshëm dhe jo në kohë të mbrojtjes shëndetësore të personave të paraburgosur. Gjegjësisht, nga kontrollimi i dokumentacionit për çdo rast në veçanti, është konstatuar se personat e përmendur janë kontrolluar nga mjeku gjatë pranimit në institucion, si dhe në çdo nevojë të tyre për mbrojtje shëndetësore emergjente, ndërsa është dhënë kujdes i duhur mjekësor dhe trajtim për të gjitha rastet kronike. Personat e paraburgosur vizitohen një here në javë nga mjeku, ndërsa edhe më shpesh nëse ka nevojë. Personeli shëndetësor, gjithashtu është i përfshirë në procesin e planifikimit të ushqimit.

Gjithashtu, MPN-ja konstaton se janë respektuar parimet për besueshmëri të dokumentacionit mjekësor, si dhe besueshmëri gjatë kontrollit.

Gjatë vizitës, MPN-ja konstatoi se para mbajtjes së sanksionit disiplinor për dërgim në qeli është siguruar mendim nga mjeku për gjendjen shëndetësore të personit të dënuar, që ishte e qartë në dokumentacionin përkatës.

### ***E drejta për pushim dhe qëndrim në ambient të hapur***

Personat në pjesën e paraburgimit me të cilët MPN-ja realizoi bisedë theksuan se ata shpenzojnë ndërmjet 1-2 orë në ditë në shëtitje, dhe si edhe në dy vizitat e mëparshme janë ankuar për hapësirën e kufizuar të lëvizjes.

Duke pasur parasysh se të gjithë personat e paraburgosur u ankuar se ata shpenzojnë më pak se 2 orë në ditë në ambient të hapur, MPN-ja përsëriti sugjerimin dhe i rekomandoi drejtorisë së burgut se ajo është në kundërshtim me ligjin dispozita ligjore<sup>3</sup> që kërkojnë të burgosurve tu mundësohet lëvizje në ambient të hapur të paktën dy orë në ditë. Në këtë pjesë NPM-ja i rekomandoi drejtorisë së burgut, se e drejta për pushim dhe për qëndrim në ambient të hapur duhet të realizohet në përputhje me dispozitat ligjore të cilat parashihet personat e paraburgosur të kalojnë të paktën dy orë në ditë jashtë lokaleve të mbyllura.

### ***E drejta për ushqim***

Shumica e personave të paraburgosur kishin ankesa në lidhje me ushqimin që ata marrin në Burgun Shkup, në aspektin e sasisë dhe cilësisë së ushqimit në mënyrë të veçantë u ankuar për darkë, sepse, ashtu siç na informuan, për darkë marrin vetëm supë.

Personat e mitur të paraburgosur ushqimin e marrin dhe e konsumojnë në dhomën e tyre, në të cilën ka vetëm një tavolinë, nuk ka karrige, kështu që këta persona ushqimin e konsumojnë në këmbë. Ekipi i MPN-së i sugjeroi Sektorit për Sigurim dhe drejtorisë së burgut që menjëherë të sigurojnë kushte të përshtatshme për konsumim të ushqimit të personave të mitur.

MPN-ja gjatë vizitës konstatoi se në përgatitjen e ushqimit kujdesen për ndjenjat fetare dhe nevojat e personave të privuar nga liria fetare. Gjithashtu në kuzhinë theksohet lista e ushqimeve në çdo dy javë, e cila është nënshkruar me rregull nga personat përgjegjës të Burgut Shkup.

### ***Trajtimi dhe realizimi i të drejtave***

Gjatë vizitës së Paraburgimit në Shkup u bënë biseda të besueshme në grupe por edhe individuale me numër më të madh të personave në lokalet për vendosje, me ç'rast shërbimi i

3 Neni 194 të Ligjit mbi procedurën penale

sigurimit nuk ishte i pranishëm në zbatimin e bisedës.

Personat me të cilët MPN-ja zhvilloi bisedë në përgjithësi theksuan se nuk kanë vërejtje për sjelljen e personave zyrtarë, përkatësisht informuan për sjellje korrekte ndaj tyre. Numri më i madh i vërejtjeve janë bërë në pjesën e të ushqyerit, shëtitjes në ajër të pastër dhe disa ankesa për mbrojtjen shëndetësore.

Personat e parburgosur dhanë një vlerësim pozitiv për sjelljen e drejtorit të institucionit, duke theksuar se i pranon për bisedë me kërkesë të tyre. Disa nga personat e parburgosur theksuan se drejtori shpesh i viziton në lokalet e tyre, dhe i pyet nëse ata kanë ndonjë nevojë dhe nëse ata kanë ankesa për sjelljen e personave zyrtarë.

Ekipi i MPN-së bisedoi edhe me personat e mitur në seksionin e parburgimit, të cilët dhanë vlerësim pozitiv për qëndrimin e personave zyrtarë dhe theksuan se është korrekt.

Nga vizita, ekipi i MPN-së konstatoi se në parburgim nuk është regjistruar ndonjë rast i dhunës apo keqtrajtimit nga ana e personave zyrtarë, as në mesin e personave të parburgosur.

Sa për gratë - e parburgosura, për to janë përgjegjës personat për sigurim të gjinisë femërore. Sipas deklaratave të grave të parburgosura, ato janë të kënaqura me qëndrimin e punëtorëve të sigurimit dhe deklaruan se u ofrohet mbështetje e duhur psiko-sociale, që nuk ka raste të dhunës ndaj tyre nga ana e Sektorit të Sigurimit dhe as dhunë mes tyre.

### **Kontrolli në evidencën e personave të parburgosur**

Nga kontrolli në Librin për vizita, Librin raportues dhe Librin e ankesave nga personat e parburgosur, MPN-ja arriti në përfundimin se mbajtja e shënimeve është në nivel të kënaqshëm. Gjegjësisht Libri i vizitave mbahet me rregull dhe aty evidentohet çdo vizitë. Libri raportues gjithashtu mbahet në mënyrë adekuate dhe të duhur.

Libri i ankesave të personave të parburgosur përmban një listë të bisedave, dhe aty është vërejtur se në çka ankohet personi i parburgosur, dhe çka ka ndërmarrë Drejtoria e Burgut lidhur me ankesën.

### **Veprimi pas rekomandimeve të dhëna**

Avokati i Popullit-MPN për gjendjet e konstatuara nga vizita e pjesës së parburgimit të Burgut Shkup-Shkup dorëzoi Raport të veçantë te Drejtoria e Burgut Shkup dhe te Drejtoria për Kryerje të Sanksioneve.

Me rastin e dorëzimit të Raportit të veçantë, Drejtoria e Burgut Shkup-Shkup, dorëzoi përgjigje në kohë në të cilën informoi se veprohet sipas rekomandimeve të MPN-së për respektimin dhe realizimin e të drejtës për qëndrim në ambient të hapur, në bazë të Rregullores së rendit shtëpiak për realizimin e masës parburgim, përkatësisht se personave të parburgosur u mundësohet qëndrimi në ajër të freskët me kohëzgjatje prej dy orë në ditë.

Drejtoria, gjithashtu njoftoi se në bazë të rekomandimeve, në burg për çdo ditë mbahet higjienë në lokale shtroja ajroset një herë në javë, ndërrohet çdo dy javë, dhe dyshekët e vjetër janë zëvendësuar me të rinj.

Lidhur me rekomandimin për të vendosur alarme dhe dollapë, Drejtoria informoi se pas rekomandimit është vepruar plotësisht dhe në ndërkohë janë vendosur dollapë dhe alarme në lokalet ku mungonin.

Gjithashtu edhe rekomandimi për zvogëlimin e numrit të personave në lokalin ku u konstatua se qëndrojnë 12 persona në tërësi është implementuar, duke marrë parasysh se në lokal janë vendosur 6-8 të parburgosur.

Nga ana tjetër, Drejtoria për Kryerjen e Sanksioneve e informon MPN-në për masat e marra me rastin e rekomandimeve të dhëna, me ç'rast theksoi se përmirësimi i kushteve në repartin e paraburgimit në Burgun Shkup për sigurimin e standardeve minimale ndërkombëtare dhe nacionale është qëllim strategjik Drejtorisë, siç është edhe përforsimi i kapaciteteve njerëzore dhe atyre materiale-teknike për funksionimin normal të institucioneve ndëshkuese përmirësuese.

Drejtorja për kryerjen e sanksioneve informonte se në Planin aksionar të Strategjisë nacionale për zhvillim të sistemit penitenciar për periudhën prej vitit 2015 deri 2019 janë paraparë afate për aktivitete dhe subjekte që janë të obliguara për implementimin e tyre.

### 2.2.2. Vizita e Burgut Shkup – Pjesa e burgut

Vizita e MPN-së në pjesën e burgut të Burgut Shkup-Shkup, u realizua me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm nga Shoqata e Psikiatërve, Shoqata e Mjekësisë Ligjore, si dhe Shoqata për të Drejtë Penale dhe Kriminologji. Gjatë vizitës u kontrollua zbatimi i rekomandimeve të dhëna më parë në Raportin e veçantë të përgatitur nga MPN-ja me rastin e realizimit të vizitës së rregullt në Burgun Shkup të kryer më 28.05.2013.

Vizita e mëvonshme u realizua nga dy nënëkipe të MPN-së, njëri prej të cilëve vizitoi repartin e pranimit, të hapur dhe gjysmë të hapur dhe lokalet tjera ndihmëse, ndërsa ekipi i dytë vizitoi seksionin e mbyllur, lokalin HA-5, qelitë dhe ambulancën. Gjithashtu, u zhvilluan biseda me të punësuarit në sektorin për risocializim dhe Sektorin për Sigurim dhe, dhe u shqyrtua evidenca lidhur me personat e privuar nga liria.

Gjatë vizitës në Burgun Shkup ishin të pranishëm 189 persona të dënuar prej të cilëve 179 në vend, dhe pjesa tjetër ishin në pushim në shtëpi dhe pushim vjetor. Në repartin e pranimit qëndronin 7 persona. Në repartin gjysmë të hapur- të hapur qëndronin gjithsej 137 persona. Në repartin e mbyllur 31 persona dhe në lokalin HA-5 ishin vendosur 2 persona.

MPN-ja nga drejtori i burgut mori informatë se 123 persona të dënuar janë të angazhuar me punë brenda në institucion, ndërsa 11 persona të dënuar jashtë burgut. Personat e dënuar që gjenden në repartin e pranimit nuk janë të angazhuar me punë.

Gjatë vizitës MPN-ja u informua se në 7 lokale personat e dënuar mbajnë grevë, përkatësisht refuzuan të marrin ushqimin (në repartin B dhe një dhomë në G2), por në fund të vizitës u mor informatë se greva është ndërprerë dhe se të gjithë personat filluan të marrin ushqimin.

Duke pasur parasysh se një nga rekomandimet nga vizita e mëparshme ishte ndërtimi i repartit të ri të burgut apo riparimi i tij, nga drejtori i burgut u mor informatë se janë siguruar 900.000,00 denarë për rinovimin e kësaj pjese të burgut.

Nga biseda me komandantin MPN-ja mori informatë se nuk janë vërejtur raste të dhunës ndërmjet të burgosurve dhe se nuk ka pasur raste të vetëlëndimit. Rasti i fundit i dhunës ishte vërejtur në vitin 2014.

Nga kontrolli në Librin për kontroll është konstatuar se ai mbahet me rregull. Në shumicën e rasteve gjatë kryerjes së kontrollit të lokaleve për vendosje janë gjetur telefona mobilë. Për këto gj;ra përpilohet raport dhe në qoftë se njihet pronari ato ruhen në institucion, dhe në bazë të vërtetimit për sende të të sekuestruara përkohësisht i kthehen personit të dënuar gjatë lirimimit nga institucioni, përkatësisht pas mbajtjes së dënimit me burg. Telefonat celularë pronari i të cilëve është i panjohur, ruhen në një depo të veçantë.

MPN-ja konstaton se në momentin e vizitës, reparti i pranimit, gjysmë-i hapur dhe i hapur ku qëndronin 135 të burgosur, ishin të siguruar vetëm nga dy pjesëtarë të policisë së burgut.

### **Kushtet materiale**

Në momentin e vizitës së **repartit të pranimit** të Burgut Shkup nuk u konstatua stërm-bushje. Gjegjesisht, në njërin lokal ishin vendosur 2 të burgosur, në të dytin 1 dhe në të tretin kishte 3 të burgosur, gjithsej 6 në tre lokale. Përndryshe, nga kontrolli I lokaleve u konstatua se ato janë të pajisura me nga 5 shtretër, që kur do të plotësoheshin me shtretër të tjerë do të ishte në kundërshtim me standardet që përcaktojnë se për çdo person të gjykuar duhet të sigurohen së paku 9m<sup>3</sup> hapësirë.

Rendi shtëpiak i institucionit nuk është theksuar në vend të dukshëm dhe në bisedë me edukatorin u konstatua se Rendi shtëpiak disa herë është theksuar, por ishte grisur nga të burgosurit. Nga biseda e kryer me një pjesë të të burgosurve të kombësisë shqiptare MPN-ja konstaton se nuk e njohin mire gjuhën maqedonase, për çka konsideron se rendi shtëpiak duhet të përkthehet dhe vendoset në gjuhën shqipe.

Edhe krahas gjendjes së keqe materiale në të cilën gjenden lokalet në repartin e pranimit, u vërejt se higjiena është në nivel të kënaqshëm, për të kujdesen vet të burgosurit, ndërsa nga Burgu u janë siguruar mjete e nevojshme higjienike.

MPN-ja konstatoi se të gjithë të burgosurit në repartin e pranimit ishin kontrolluar me kohë nga mjeku pas pranimit të tyre. Asnjëri prej tyre nuk u ankua për sjellje të keqe nga policia e burgut.

Vërejtje kishte në lidhje me ushqimin (kualitetin dhe sasinë), ndërsa u ankuan edhe se lokalet nuk janë të ngrohura përkatësisht me kushtet e motit. Njëkohësisht, të burgosurit theksuan se të drejtën për shëtitje në ajër të pastër e realizojnë vetëm 30 minuta në ditë.

Gjatë kontrollit u vërejt se në lokale nuk ka tavolinë dhe karrige ku të burgosurit do të mund ta konsumonin ushqimin.

Në momentin e vizitës së **repartit gjysmë të hapur**, në lokalet për vendosje ishin të pranishëm të burgosurit të cilët për shkaqe shëndetësore nuk janë angazhuar me punë.

MPN-ja konstatoi se në lokalet e repartit gjysmë të hapur, ka nga 7 shtretër që është larg plotësisht të standardeve për hapësirë të siguruar në minimum për të burgosur, madje edhe jashtë rregullës për maksimum 5 persona në lokal. Përveç shtretër të vjetër, në lokal nuk ka inventar themelor (dollarë, tavolinë, karrige, etj). Tualetet janë në gjendje shumë të keqe, por higjiena është e kënaqshme për shkak se drejtoria siguron mjete të mjaftueshme për mbajtjen e higjienës. Të burgosurit vunë në dukje se çdo kohë ka ujë të ngrohtë, por në sasi të pamjaftueshme dhe për këtë arsye duhet të presin radhë për dush sepse në kat ka vetëm një ngrohës uji.

Në muret e lokaleve vërehej lagështi, ndërsa lokalet nuk ishin të ngrohura përkatësisht me kushtet e motit. Matësi I lagështisë nuk regjistronte lagështi, por duhet të theksohet se dritaret në të gjitha lokalet ishin të hapura që mund të ketë ndikim në vet matjen.

MPN-ja nga kontrolli i repartit të hapur konstatoi se ka 7 lokale për vendosje me nga 5 shtretër, ndërsa në një lokal ka 6 shtretër. Të gjithë shtretërit janë të plotësuar dhe është evidente stërm-bushja e lokaleve për vendosje. Në lokale nuk ka inventar përkatës (dollarë, sirtarë, tavolinë, karrige, etj.).

Në lidhje me aktivitete e lira, në repartin e hapur ka hapësirë që shfrytëzohet për shëtitje, por nuk ka pjesë të mbuluar të cilën do ta shfrytëzonin gjatë motit të keq. Lokali për aktivitete ditore është në gjendje shumë të keqe dhe është i vogël, nuk përputhet me numrin e të burgosurve që do të duhej ta shfrytëzonin. Burgu Shkup ka bibliotekë, por fondi i librave është i kufizuar.

Gjatë vizitës së repartit të mbyllur u konstatua se në këtë moment nuk ekziston stërm-

bushje si gjatë vizitës së mëparshme të zbatuar më 28.05.2013, por kushtet tjera ishin pothuajse të pandryshueshme.

Kushtet materiale në këtë repart janë të këqija, ndërsa të dënuarit u ankuan në pamundësi për realizimin e disa nevojave elementare-ndjekje e kufizuar e programit televiziv për shkak të instalimit elektrik tepër të vjetër.

Nyejt sanitare janë në gjendje të keqe, një pjesë e tyre nuk funksionon, që ndikon në higjienën e personave të dënuar.

Ishte dhënë ankesë për dhomën për qëndrim ditor, mospasje të kushteve për ruajtje të ushqimit (në funksion të frigoriferit që nuk i plotëson nevojat sipas numrit të personave të dënuar) dhe ankesa për higjienën e përgjithshme. Gjithashtu, një pjesë e personave të dënuar theksuan se në dhoma ka insekte dhe se është i nevojshëm dezinfektim i tërë hapësirës.

MPN-ja kontrolloi edhe lokalin magazinues dhe konstatoi se ka numër të caktuar të dyshekëve që janë relativisht të rinj, por në praktikë dyshekët personave të dënuar u ndërrohen vetëm nëse plotësisht janë vjetruar ose janë të papërdorshëm.

Gjatë vizitës të burgosurit nuk u ankuan për zbatimin e dhunës, as nga personeli, as ndërmjet të dënuarve.

Duke pasur parasysh se gjatë vizitës paraprake të lokalit Ha-5 u has në gjendje të keqe dhe aty ishin vendosur tetë persona dhe dy prej tyre nuk kishin krevat, MPN-ja gjatë vizitës në vitin 2015 konstatoi rënie në numrin e personave të vendosur në këtë lokal, përkatësisht respektim të standardeve dhe detyrimeve të parapara në nenin 103 të Ligjit për kryerje të sanksioneve, si dhe nenin 15 të Rendit shtëpiak për të burgosurit që mbajnë dënimin me burg në institucionet ndëshkuese edukuese.

Megjithatë, në të njëjtin lokal ishte vërejtur lagështi e dukshme në mure, ndërsa si dyshekë përdorëshin sfungjerë dhe batanije të vjetra. Gjatë vizitës, tualeti nuk ishte në funksionim, përkatësisht ishte bllokuar me shishe plastike, ndërsa lavamani ishte ndryshkur plotësisht, në mënyrë që si paraqet burim të mundshëm të sëmundjeve infektive. Edhe pse lokali ka dritë është e nevojshme që të ajroset dhe të zvogëlohet sasia e lagështisë që ishte hasur.

MPN-ja konstatoi se në kuadër të **punëtorisë automekanike** ka lokal për vendosje, ku janë vendosur tre të burgosur që njëkohësisht janë të angazhuar me punë aty. Për angazhimin e tyre ata marrin kompensim simbolikë Respektohen rregullat për mbrojtje gjatë punës, përkatësisht gjatë punës përdorin kushte minimale teknike për mbrojtje gjatë punës. Në punëtorinë e zdrukthëtarisë, edhe pse janë të angazhuar disa të burgosur, nuk u vërejt aktivitetet.

Pas realizimit të vizitës MPN-ja përfundoi se ka përmirësim në Burgun Shkup, përkatësisht se një pjesë e rekomandimeve që I ka dhënë MPN-ja janë implementuar ose janë në fazën e përgatitjes për implementim. Megjithatë, mbetet edhe më tej një pjesë e rekomandimeve të implementohen, veçanërisht në pjesën e kushteve materiale, si dhe në përmirësimin e kualitetit të ushqimit.

### **Të drejtat e personave të dënuar**

#### ***Mbrojtja shëndetësore***

Siç tani më përmendëm mbrojtja shëndetësore në Burgun Shkup është organizuar nga sektori shëndetësor, me 2 mjekë, një stomatolog dhe dy infermiere. Është në dispozicion 24 orë, me mjek që është me angazhim të përhershëm, por me honorar angazhohen edhe mjekë të tjerë specialistë. Sipas nevojës angazhohet edhe psikiatër që detyrimisht vjen një herë në javë.

Ambulanca në pjesën e burgut është e pajisur mire, e rregulluar ndërsa dokumentacioni ruhet në mënyrë përkatëse dhe të gjithë janë të kontrolluar pas pranimit në institucion, në afat prej 24 orësh.

Shumica e të burgosurve kishin vlerësim të mirë për kujdesin shëndetësor në burg, si dhe në dispozicionin e personelit mjekësor, nivelin e kujdesit shëndetësor, mundësinë për kompletim të procedurave diagnostikuese. Të gjitha ankesat individuale ekipi i MPN-së i vërejti dhe menjëherë kontrolloi dokumentacionin mjekësor, ndërsa bisedoi edhe me personelin mjekësor-mjekun dhe infermieren. Në të gjitha rastet u konstatua se nga personeli mjekësor janë marrë të gjitha procedurat e nevojshme diagnostikuese, personat janë dërguar në institucione përkatëse shëndetësore, përkatësisht se udhëheqësia e burgut u mundësoi mbështetje me kohë-transport .

MPN-ja konstatoi se në të gjitha rastet e përkeqësimit akut të gjendjes shëndetësore të personave të mbrojtur, personeli mjekësor ndërmori masa me kohë, dha ka reaguar përkatësisht.

Gjatë kontrollit konstatohet se është mundësuar kujdes përkatës shëndetësor, si dhe terapi për të gjitha rastet kronike kur personat e dënuar vizitohen një herë në javë nga mjeku ndërsa edhe më shpesh sipas nevojës. Personeli shëndetësor është përfshirë në procesin e planifikimit të ushqimit, por edhe krahas kësaj personat e dënuar më së shumti u ankuan për ushqimin, përkatësisht se shpesh marrin vetëm supë, dhe se nuk marrin prodhime qumështi. Njëkohësisht në bisedë me personat e dënuar të sëmurë kronikë u fitua përshtypje se ata nuk kanë regjim të veçantë të ushqimit, përkatësisht se ushqimi është i njëjtë për të gjithë personat e dënuar.

Sipas informative të mara, personeli shëndetësor është i trajnuar përkatësisht, vazhdimisht ndjek edukime. Një prej mjekëve nga Burgu Shkup është në specializim në psikiatri me mbështetjen e burgut, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e kujdesit shëndetësor në këtë institucion. Për vërejtje është konstatuar bashkëpunim i mirë në mes të sektorit të shëndetësisë dhe udhëheqësisë së Burgut Shkup.

NPM-ja kontrolloi dokumentacionin shëndetësor, me ç'rast konstatoi se respektohen parimet e besueshmërisë së dokumentacionit mjekësor si dhe të besueshmërisë gjatë vet kontrollit.

MPN-ja konstatoi se Ambulanca është e pajisur në mënyrë adekuate me ilaçe të nevojshme nga grupi thelbësor, si dhe ilaçe për çrregullime të zakonshme somatike dhe psikike, si dhe për sëmundjet e caktuara që janë diagnostikuar në mesin e të burgosurve. Terapia mjekësore është e caktuar në mënyrë të përshtatshme e kontrolluar dhe u jepet në kohën e duhur të dënuarve nga ana e personelit shëndetësor. Megjithatë të dënuarit shprehën pakënaqësinë e tyre me furnizimin e barnave, përkatësisht se nuk jo gjithmonë i marrin në vazhdueshmëri, përkatësisht vetë furnizohen me barna të caktuara për sëmundje kronike (hipertension, dobësi kronike e zembrës, mushkërive, diabet, etj). Gjithashtu janë marrë njoftime se ekzistojnë periudha gjatë vitit kur mungojnë barna për sëmundje akute dhe kronike.

MPN-ja vërejti se terapia me metadon ruhet në dollap të veçantë mjekësor që është i mbyllur dhe ndahet në doza ditore nga mjeku ose infermieri. Terapija me metadon sigurohet në vazhdimësi.

Respektohet besueshmëria dhe fshehtësia e kontrollit mjekësor. Personat e dënuar kontrollohen në Ambulancë, pa praninë e personelit mjekësor. Në lidhje me besueshmërinë e dokumentacionit, ai ruhet në Ambulancë, ku qasje kanë vetëm punëtorët e shëndetësisë. Ordinancat ku kontrollohen personat e dënuar janë të vogla, por janë të pajisura me aparate themelore mjekësore.

Meqë gjatë vizitës nuk kishte persona me masë të shqiptuar-qeli MPN-ja bisedoi me personat të cilët më pare kanë qenë në vuajtjen e kësaj mase disiplinore. Me këtë rast, janë marrë

informata ase janë kontrolluar nga mjeku para se të dërgohen në qeli, dhe kjo u konstatua edhe dokumentacionin shëndetësor.

### ***E drejta për ushqim***

Pothuajse të gjithë të burgosurit në pjesën e burgut të Burgut Shkup u ankuan për kualitetin dhe sasinë e ushqimit. Për tu përshëndetur është fakti se pothuajse të gjithë të burgosurit nga reparti gjysmë I hapur janë të angazhuar me punë (në kuzhinë, lavanderi, punëtori, etj).

MPN-ja konstatoi se të dënuarit që punojnë në kuzhinë nuk kanë librezë shëndetësore dhe nuk u merren në mënyrë të vazhdueshme brise për ekzaminime bakteriologjike. Vetëm personeli profesional në kuzhinë kanë librezë shëndetësore të cilat ishin të plotësuar siç duhet me rezultatet e ekzaminimeve të rregullta bakteriologjike që bëhen çdo gjashtë muaj. Gjithashtu, bëhen testime mikrobiologjike të briseve që merren nga sipërfaqet e punës të kuzhinës. Higjiena në kuzhinë ishte e kënaqshme ndërsa ishte theksuar meni për javën e tanishme. Në meni është evidente mungesë e dukshme e qumështit dhe produkteve të qumështit, dhe fruta. Në depo ku mbahen sendet ushqimore është vërejtur lagështi dhe myk.

### ***Trajtimet dhe realizimi i të drejtave***

Gjatë vizitës në pjesën e burgut në Burgun Shkup u realizuan biseda të besueshme në grup por edhe individuale me më shumë persona në lokalet e vendosje it, ku shërbimi i sigurisë nuk ishte i pranishëm gjatë realizimit të bisedës.

Asnjë nga të burgosurit nuk u ankua për keqtrajtim nga ana e policisë së burgut, edukatorëve dhe punonjësve të tjerë të burgut, as nuk u ankuan për dhunë nga të burgosurit e tjerë.

Ankesat e personave të dënuar u drejtuar në ushqim, përkatësisht shprehën pakënaqësi për cilësinë dhe sasinë e ushqimit që e marrin të dënuarit dhe për ushqimin e njëjlojtë. MPN-ja konstatoi se në dhomën e ngrënies ka mungesë të inventarit, si dhe të veglërisë për ushqim. Të burgosurit u shprehën se të drejtën për shëtitje në ajër të pastër e realizojnë në kohëzgjatje prej 30 minutash në ditë, përkatësisht nuk respektohet rregulla ligjore për të qëndruar në të hapur në kohëzgjatje prej 2 orësh.

### ***Veprimi për rekomandimet e dhëna***

MPN -ja dorëzoi raport të veçantë për gjendjet e konstatuara nga vizita e Burgut Shkup-Shkup-pjesa e të dënuarve te Drejtoria e Burgut dhe Drejtoria për Kryerje të Sanksioneve.

Nga Burgu Shkup - Shkup te MPN-ja është dorëzuar përgjigje në kohë. Lidhur me rekomandimin për të përmirësuar kushtet për vendosje, Burgu Shkup - Shkup informon MPN-në se gjatë muajve qershor/korrik vitin 2015 ishte përfunduar renovimi i TV sallës, gjashtë dhomave të gjumit dhe 2 banjave, dhe në momentin e paraqitjes së përgjigjes është iniciuar renovimi edhe i 5 tualeteve dhe banjave.

Gjithashtu është zbatuar është rekomandimi i MPN-së dhe lokali Ha-5 më nuk përdoret për vendosje të personave të dënuar.

Rekomandimi për rinovim të repartit gjysmë të hapur pranohet, me vërejtjen se ajo do të nisë pas përfundimit të punimeve të ndërtimit në repartin e mbyllur.

Lidhur me rekomandimin për përmirësimin e cilësisë së ushqimit në ndërkohë është lidhur marrëveshje për furnizim publik të numrit më të madh të produkteve ushqimore, ndërsa respektohen edhe standardet me të cilat është paraparë futje prej 12 500 xhul për çdo të



dënuar.

Është përmbushur edhe rekomandimi për regjim të veçantë të ushqimit për të sëmurët kronikë, kështu që për këtë kategori personash u vendos regjim përkatës i ushqimit. Në të njëjtën kohë, është zbatuar rekomandimi për blerjen e barnave, përkatësisht në ndërkohë është zbatuar procedura adekuate për furnizim të barnave.

Lidhur me kontrollin e produkteve ushqimore Burgu Shkup në ISHP Qendra e Shëndetit Publik ka lidhur marrëveshje për kontrollin e produkteve ushqimore, me ç'rast kryhet ekzaminimi me marrjen e briseve nga sipërfaqet punuese në kuzhinë, çdo gjashtë muaj.

Është vepur edhe sipas rekomandimit për theksimin e Rendit shtëpiak, kështu që ai ishte theksuar në vend të dukshëm (i mbrojtur me foli plastike), ndërsa personat e dënuar janë të njohur me përmbajtjen e tij gjatë pranimit në institucion. Nga Drejtoria për Kryerjen e sanksioneve nuk është dorëzuar përgjigje me rastin e Raportit të veçantë.

## 2.3. VENDE TJERA TË VIZITUARA

Sipas nenit 11 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit siguron mbrojtje të veçantë për të drejtat e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe personave që i nënshtrohen torturës apo veprimit ose ndëshkimit tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, ndërsa në përputhje me nenin 31-a, për realizimin e këtyre aktiviteteve kryen vizita të rregullta dhe të paparalajmëruara në organet, organizatat dhe institucionet ku liria e lëvizjes është e kufizuar, për çka përgatit dhe dorëzon raport te vendet e vizituara dhe ministritë kompetente.

Në vitin raportues 2015, MPN-ja si edhe në vitet e mëparshme realizoi vizita në institucionet publike ku nuk ka privim konvencional të lirisë, por liria e lëvizjes, në një masë të caktuar është e kufizuar.

### 2.3.1. Vizita e ISHP Enti Gjerontologjik «13 Nëntori» - Shkup - Reparti „Nënë Tereza“

Mekanizmi Parandalues Nacional, së bashku me një ekip të Seksionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta, përfaqësues të Mekanizmit Parandalues Nacional të Austrisë dhe bashkëpunëtor të jashtëm- përfaqësues i Shoqatës së Infermiereve, Teknikëve dhe Mamive të Republikës së Maqedonisë realizoi vizitë në ISHP Enti Gjerontologjik „13 Nëntori“ - Shkup - Reparti „Nënë Tereza“ në Zllokuqan.

MPN-ja realizoi vizitë të rregullt të ISHP Enti Gjerontologjik „13 Nëntor“ - Shkup - Reparti „Nënë Tereza“ në Zllokuqan, në kuadër të mandatit dhe kompetencave që dalin nga Protokollin fakultativ i Konventës kundër Torturës dhe Veprimit ose ndëshkimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues, Ligjit për Avokatin e Popullit, e gjithashtu si aktivitetet e planifikuara në kuadër të Tuninig projektit për mbështetje të institucionit Avokati i Popullit, i cili është realizuar me bashkëpunim të ndërsjellë me Ombudsmanin e Austrisë.

Gjatë vizitës në ISHP Enti Gjerontologjik „13 Nëntori“ - Shkup - Reparti „Nënë Tereza“ ekipi i MPN-së është udhëhequr nga Kodi i etikës së veprimit me persona të moshuar, i cili kërkon që këta persona të trajtohen si individë dhe të respektohen të drejtat e njeriut, të mos kryhet diskriminim, të ketë qasje në ushqim të shëndoshë përkatës, ujë të pastër, strehim,

veshje dhe mbrojtje shëndetësore. Në korniza të këtij Kodi, theksohet edhe përdorimi i llojeve të përshtatshme të kujdesit institucional dhe jashtë-institucional, por gjithashtu është theksuar se personat e moshuar duhet të mbrohen nga çdo formë e dhunës fizike ose psikike, të dinë të vërtetën, nëse ata janë në gjendje në mënyrë të pavarur të gjykojnë dhe të shprehin ndjenjat e tyre në mënyrën e vet.

### **Struktura e të punësuarve**

Në Repartin "Nënë Tereza", përveç drejtorit të punëtorëve të institucionit janë të punësuar edhe 5 infermiere, 4 gjerontoamvise (njëra prej tyre shpesh ishte në pushim mjekësor për shkak të psikodiagnozës së vërtetuar), 1 punëtor social, 1 terapeut pune dhe 3 punëtorë në kuzhinë, të cilët kujdesen për personat e moshuar.

Brenda institucionit, punëtori social është edhe udhëheqës i Repartit "Nënë Tereza" - Shkup. Sipas informatës të marrë në Shtëpi nuk ka të punësuar fizioterapist, as psikolog, ndërsa ka nevojë edhe për një punëtor social. Gjithashtu, nuk ka mjaft njerëz për të punuar në lavanderi, dhe për mbajtjen e pastërtisë, kështu që për momentin gjerontoamviset kujdesen edhe për higjienën në Shtëpi.

### **Kushtet materiale**

MPN-ja konstaton se kushtet e jetesës së shfrytëzuesve në Shtëpinë „Nënë Tereza” nuk janë në nivel të kënaqshëm. Edhe pse objekti është me karakter kohor, ai është në përdorim për 50 vjet, aspak nuk është rinovuar, dhe nuk janë kryer riparime të mëdha.

Gjatë inspektimit MPN bëri matjen e temperaturës dhe lagështisë në dhoma. Në dhomën e parë është matur temperaturë prej 21,8°C, dhe lagështi prej 39.8% ndërsa në dhomën e dytë temperatura ishte 21,8°C dhe lagështia 43.7%, e cila është brenda standardeve të pranueshme.

Nëse merret parasysh vlera optimale e temperaturës dhe lagështisë<sup>4</sup> mund të përfundohet se objektet janë ngrohur sa duhet, përkatësisht gjatë vizitës i përmbushnin standardet e parapara për temperaturë, ndërsa lagështia është gjithashtu brenda intervalit të vlerave optimale. MPN-ja u informua nga vetë shfrytëzuesit se temperatura edhe gjatë periudhës së dimrit ka qenë në nivel të kënaqshëm. Në qëndrimin ditor, gjithashtu temperatura është në një nivel të kënaqshëm prej 21.5°C dhe lagështia ishte 37.1%.

MPN-ja arriti në përfundimin se tualetet janë të vjetra dhe të shkatërruara me pllaka të vjetra, ndërsa dushet janë të vjetruara, kështu që është e vështirë për të ruajtur higjienën në nivel të kënaqshëm, dhe gjithashtu nuk janë të përshtatur për nevojat e kategorisë persona të moshuar.

Në kuadër të Shtëpisë ka një kuzhinë e cila shpërndan ushqim për konsumatorët në të cilën higjiena nuk është e kënaqshme. Gjatë inspektimit në kuzhinë MPN-ja konstatoi se dolapët në të cilat janë vendosur takëmet ushqimit janë të vjetër dhe të pista, që paraqet rrezik real për shëndetin e përdoruesve.

Përdoruesit janë përgjithësisht të kënaqur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit i cili vetëm shpërndahet, që do të thotë, nuk përgatitet në Shtëpinë, por është me cilësi të certifikuar nga kontrolli i kryer i Entit për Amvisëri dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Për konsumatorët të cilët kanë probleme shëndetësore sigurohet ushqim i veçantë.

Në përbërje të kuzhinës, ku ishte theksuar lista e ushqimeve ndodhej edhe dhoma e ngrënies ku janë vendosur tavolina dhe karrige dhe kjo është e rregulluar, dhe higjiena në

<sup>4</sup> Standardet e pranuar për temperaturën janë prej 18-25°C, ndërsa për lagështi prej 20-60 R.H.

dhomë mbahet rregullisht.

Konkluzioni i përgjithshëm i MPN-së është se higjiena në Shtëpi nuk është e kënaqshme, për shkak të kushteve të këqija që dalin nga objekti i vjetruar dhe për shkak të mungesës së personelit të ngarkuar me pastrimin. Njëkohësisht, konstatoi se ka mungesë të personelit për punën në kuzhinë.

### **Trajtimi dhe veprimi me shfrytëzuesit**

Nga biseda me përdorues MPN-ja mori informata që përdoruesit në thelb janë të kënaqur me qëndrimin e personelit, konfirmuan që kanë kujdes përkatës dhe respektohet personaliteti i tyre. Megjithatë gjatë vizitës MPN-ja vërejti se për shkak të mungesës së personelit adekuat, disa nga përdoruesit të cilët janë në gjendje më të mirë shëndetësore kujdesen dhe u ofrojnë ndihmë atyre shfrytëzuesve të cilët janë në gjendje më të rëndë shëndetësore. Kjo u konfirmua në një bisedë me disa nga shfrytëzuesit.

Gjatë vizitës MPN-ja bisedoi me disa shfrytëzues, disa prej tyre ishin të kënaqur me kushtet në shtëpi, e disa nuk ishin të kënaqur me kushtet materiale në të. Gjithashtu, disa nga shfrytëzuesit ishin të kënaqur me cilësinë e ushqimit që e merrnin, e të tjerët nuk ishin. Disa shfrytëzues u ankuan se sasia e ushqimit që ata marrin nuk është e mjaftueshme.

Ekipi i MPN-së zhvilloi bisedë me një shfrytëzues i cili theksoi se disa nga shfrytëzuesit janë të privilegjuar dhe kanë kushte më të mira për vendosje.

MPN-ja mori informata kundërtënëse në lidhje me mbajtjen e higjienës personale. Disa shfrytëzues theksuan se bëjnë dush çdo javë, dhe disa prej tyre se bëjnë dush çdo 2 javë. MPN-ja mori informatë nga shfrytëzuesit se shtroja ndërrohet një herë në javë, ndërsa te personat e palëvizshëm më shpesh.

MPN-ja mori informatë se institucioni ka përpunuar Programin vjetor të aktiviteteve të shfrytëzuesve në vitin 2015, për të përmbushur kohën e lirë, në mënyrë që gjatë vitit janë organizuar piknikë të përbashkëta dhe vizita të vendeve kulturore, ndërsa ishin organizuar manifestime edhe në institucion.

Nga biseda me shfrytëzuesit dhe me personat zyrtarë MPN-ja erdhi në përfundim se në Shtëpinë „Nëna Terezë“ shfrytëzuesit janë të përfshirë në terapi punuese, në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre. Shfrytëzuesit kanë bërë vepra artizanale dhe kanë marrë pjesë në përgatitjen e pjekurinave.

Në Shtëpi respektohen zakonet fetare të shfrytëzuesve.

### **Mbrojtja sociale e shfrytëzuesve**

MPN-ja vërejti se shfrytëzuesit në Shtëpinë „Nënë Tereza“ e njohin punën profesionale të punëtorit social dhe se punëtor social punon në mënyrë individuale dhe në grupe me shfrytëzuesit dhe familjet e tyre. Gjatë trajtimit individual punëtori social krijon kontakt fillestar me shfrytëzuesin e institucionit së bashku me infermieret dhe të punësuarit tjerë, krijon një lidhje me familjen e shfrytëzuesit dhe Qendrës për Punë Sociale, në qoftë se personi është dërguar me vendimi nga qendra kompetente.

Shfrytëzuesve u sigurohet ndihmë në arritjen e të drejtave dhe shërbimeve nga sistemi i sigurimit social, si dhe asistencë profesionale në zgjidhjen e disa situatave konfliktuozë. Punëtori social kryen punë të rregullt në terren duke vizituar Qendrat për Punë Sociale, Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, Fondin e Sigurimit Pensional dhe invalidor, vizitë të familjeve të shfrytëzuesve, etj, me të cilat në interes të shfrytëzuesve është vendosur bashkëpunim i mirë.

### **Mbrojtja shëndetësore**

Në lidhje me mbrojtjen shëndetësore, MPN-ja arriti në përfundim se shfrytëzuesit e të drejtës për mbrojtje shëndetësore e realizojnë plotësisht në Shtëpi, përkatësisht mbrojtja shëndetësore ofrohet nëpërmjet një sistemi të koordinuar të mjekëve në specialitetin përkatës.

Çdo shfrytëzues në Shtëpi ka të zgjedhur mjekun amë i cili rregullisht i viziton një herë në javë dhe nëse është e nevojshme dërgohen te mjeku amë, si dhe në kontrole përkatëse specialiste. Shfrytëzuesit që kanë nevojë për terapi fizike pas një rekomandimi të ftiazitrit dërgohen në Kabinetin për terapi fizike në ISHP "13 Nëntori", ku mbeten aq kohë sa do të rekomandojë specialisti.

### **Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna**

ISHP Enti Gjerontologjik „13 Nëntori” dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale pas urgjencës së drejtuar nga Mekanizmi Parandalues Nacional dorëzuan përgjigje në Raport të veçantë.

Lidhur me rekomandimin për të rritur numrin e të punësuarve në Shtëpi, si të kuadrit profesional ashtu edhe për punësimin e pastruesve dhe gerentoamviseve, udhëheqësi i Repartit e informoi MPN-në se kanë parashtruar kërkesë disa herë në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale për punësim të personelit, por ende nuk kanë marrë një përgjigje pozitive.

Lidhur me rekomandimin e MPN-së për të përmirësuar ushqimin, udhëheqësi dha shpjegime se ushqim në Shtëpi ka mjaftueshëm për çdo shfrytëzues, se në qoftë se dikush kërkon, i jepet një vakt shtesë, ndërsa për sasinë dhe cilësinë e ushqimit është marrë një vlerësim pozitiv nga ISHP Qendra e Shëndetit Publik.

Lidhur me rekomandimin për të përmirësuar higjienën në shtëpi udhëheqësi u përgjigj se mungesa e higjienës është për shkak të mungesës së personelit pastrues, për çka janë njoftuar disa herë autoritetet dhe është kërkuar punësim, i cili deri tani nuk është realizuar.

Për sa i përket vjetërsisë së objektit, MPN-ja është informuar se nuk është i mundur rinovimi i tij, në të kundërt, parashikohet zhvendosja e tij, duke pasur parasysh se objekti ndodhet në lokalitet arkeologjik.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka konfirmuar informacionin që është paraparë zhvendosje e objektit. Ministria po ashtu ka deklaruar se pranon rekomandimin e MPN-së për të zgjeruar listën e ushqimeve dhe për këtë qëllim, Seksioni për Institucione Publike dhe Private i Ministrisë, në ISHP Enti Gjerontologjik „13 Nëntori” - Reparti Nëna Terezë është dorëzuar një listë e zgjeruar e ushqimeve me një rekomandim që ajo të realizohet, përkatësisht që vaktet të përgatiten në bazë të kësaj liste.

Gjithashtu, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e informoi MPN-në se e kanë ngarkuar Drejtorin e ISHP Enti Gjerontologjik „13 Nëntori” - Reparti „Nëna Terezë” që urgjentisht të vepronte në pajtim me raportin e veçantë dhe rekomandimet e paraqitura nga MPN-ja, në veçanti në pjesën e mirëmbajtjes së higjienës në kuzhinë dhe objektin në përgjithësi, si dhe punësimin e personave profesionistë dhe pastruesve.

### 2.3.2. Vizita e IP për Përkujdesje të Fëmijëve me Probleme Edukative-Sociale „25 Maj“ - Shkup

Mekanizmi Parandalues Nacional, së bashku me një ekip të Seksionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me nevoja të veçanta, përfaqësues të Mekanizmit Parandalues Nacional të Austrisë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm nga Shoqata e Punëtorëve Socialë të Qytetit të Shkupit dhe Oda e Psikologëve të Republikës së Maqedonisë realizoi një vizitë të IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme edukative - sociale dhe sjellje të dëmtuar Shkup.

#### **Struktura e të punësuarve**

IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme edukativo-sociale dhe sjellje të dëmtuar Shkup është institucion në të cilin kryhet pranimi përkujdesja afat-shkurtër e personave të mitur të moshës 7-18 vjet ose deri në përfundimin e shkollës së mesme, vëzhgimi dhe diagnoza, strehimi, vendosje i, edukimi arsimimi dhe trajtimi korrigjues i personave të mitur në varësi të nevojave të tyre, në kohëzgjatje prej tre vjetësh.

Në institucion janë të punësuar gjithsej 31 persona nga të cilët 20 profesionistë, edhe atë pedagog i diplomuar, psikolog i diplomuar, punëtor social i diplomuar, jurist i diplomuar dhe disa mësimdhënës lëndorë. Edukatorët punojnë në tri ndërrime edhe atë: ndërrimi i parë nga ora 07.00 deri në 17.00, ndërrimi i dytë nga 13.00 deri në orën 20.00 dhe ndërrimi i tretë nga 20.00 deri në 07.00.

Rendi shtëpiak i institucionit ishte vendosur në vend të dukshëm, ndërsa ishte theksuar edhe orari mujor për angazhimin e të punësuarve.

#### **Mbrojtja sociale**

MPN-ja mori informatë se IP për përkujdesje të fëmijëve me probleme edukativo-sociale dhe sjellje të dëmtuar - Shkup pjesën e punës profesionale me shfrytëzuesit, si pjesë e ekipit multidisiplinar në institucion (pedagog, psikolog) e realizojnë dy punëtorë socialë të cilët janë të punësuar dhe punojnë në ndërrime . Ata e kryejnë punën profesionale, marrin pjesë në përpunimin e rezultatit individual dhe mendimit për shfrytëzuesin, për çka zakonisht shfrytëzojnë teknikën intervistë. Gjatë përgatitjes së planit individual të punës me shfrytëzues, punëtorët socialë në institucion marrin parasysh nevojat, interesat dhe prioritetet e shfrytëzuesve, të drejtat dhe shërbimet që ata kanë nevojë për mbrojtje sociale, vlerësohen aftësitë e tyre për t'u angazhuar në aktivitetet individuale dhe të grupit dhe tejkalimin e problemeve ekzistuese.

MPN-ja konstatoi se punëtori social në lidhje me metodat e punës me shfrytëzuesit zbaton metodën e punës sociale individuale dhe të grupit. Kryesisht në fazën e vëzhgimit, diagnostikimit risocializimit zbatohet puna (trajtimi) individual me shfrytëzuesit, sipas nevojave të shfrytëzuesit. Në listën për ndjekjen e punës me shfrytëzuesin e mbrojtjes sociale, punëtori social i evidenton të gjitha aktivitetet e ndërmarra në trajtimin me shfrytëzuesin, ndërsa të cilat nuk janë shënuar në planin individual të punës - trajtimi i shfrytëzuesit.

Ekipi i MPN-së gjatë vizitës, ndërsa nga biseda me një pjesë të fëmijëve konstatoi se punëtori social ka kontakte të përditshme me ta, të cilat i evidenton në Ditarin dhe Listën për ndjekje të shfrytëzuesit. Gjithashtu, punëtori social është në kontakt të vazhdueshëm me Qendrat për Punë Sociale, ndërsa ka kontakte edhe me familjet e shfrytëzuesve. Pjesa më e madhe të kontakteve me familjet e shfrytëzuesve janë pjesë e punës profesionale të Qendrave për Punë Sociale që duhet të punojnë me familjet me qëllim të përfortimit të kapaciteteve të tyre, zgjidhjen e problemeve të tyre dhe krijimin e mundësive për kthimin dhe riintegrimin në të shpejtë të fëmijës në familje.

Në thelb MPN-ja erdhi në përfundimet se bashkëpunimi i institucionit me Qendrat për Punë Sociale është i mirë, por edhe krahas kësaj ka nevojë për angazhim më të madh të Qendrave të caktuara për Punë Sociale të cilat, për shkak të kushteve të kufizuara teknike nuk janë në gjendje tu përgjigjen nevojave të institucionit dhe të shfrytëzuesve. Punëtori social i institucionit paraqet raportin gjashtëmujor për çdo fëmijë te qendra kompetente për punë sociale.

Psikologu është, gjithashtu anëtar i ekipit multidisiplinar, me çka kontribuon në realizimin e aktiviteteve të planifikuara. Gjithashtu ka njohuri të plotë dhe informatë për çdo shfrytëzues, dhe të gjithë këtë e evidenton. Mban dosje individuale për çdo shfrytëzues dhe dosje kumulative me të tjerët në ekipin profesional. Psikologu në punën e tij zbaton punë individuale dhe punë në grupe me shfrytëzuesit, kryen vëzhgimin e shfrytëzuesve, kryen intervista, të ashtuquajturat matrica e Ravenit dhe teknike vizatimi.

MPN-ja konstaton se instrumentet që i zbaton psikologu janë vjetruara, dhe këtë e konfirmon edhe psikologu, për çka u informuam se drejtoria nuk ka vesh për përparimin e këtij segmenti të punës.

## Kushtet materiale

### *Lokalet shkollore*

Në ditën e vizitës MPN-ja inspektoi lokalet shkollore ku realizohet mësimi. Procesi arsimor realizohet në dy klasa, njëra prej të cilave është për mësim klasor, ndërsa tjetra për mësim lëndor. Nga kontrolli i kryer në lokalet shkollore u konstatua se higjiena në to nuk është në nivel të kënaqshëm, klasat nuk janë të gëlqerosura, ndërsa në to nuk kishte numër të mjaftueshëm të bankave. Në klasa ka të vendosura trupa për ngrohje, ka dritare të mëdha dhe depërtim të mjaftueshëm të dritës gjatë ditës. Në pjesën e dedikuar për procesin arsimor është e vendosur edhe zyra e mësimdhënësit.

Ekipi i MPN-së inspektoi edhe tualetet e shkollës, me ç'rast konstatoi se ato nuk janë në gjendje të mirë, kanë dyer të thyera dhe çezma të shkatërruara Megjithatë në tualete nuk kishte sende të rrezikshme apo të thyeshme, me ç'rast u konstatua se nuk ekzistojnë rreziqe për lëndimin e fëmijëve ose çrregullimin e gjendjes së tyre shëndetësore.

### *Kapacitetet e vendosjes*

Ekipi i MPN-së inspektoi lokalet për vendosje në pjesën për meshkuj dhe për femra, me ç'rast konstatoi se dhomat janë të pajisura mirë, ato kanë kushtet themelore për vendosje (krevat dhe dollap për gjërat personale), dhe kushtet tjera materiale (karrige, tavolinë pune, etj).

Lokalet për vendosje në pjesën e femrave janë të pajisura me dy ose tre krevate, në shtojtë të pastër dhe të rregullt, ka të vendosura dritare të mëdha prej ku hyn dritë e mjaftueshme. Në përbërje të kësaj pjese ka edhe kënd të lojërave ku ata kryejnë detyrat e shtëpisë dhe e kalojnë kohën e tyre të lirë. Në këtë lokal ka një pjesë që është e shkatërruar, muret ishin të pista dhe të pagëlqerosura, por në bisedë me punëtorin social u informuam se kjo pjesë do të marrë lokal të ri-kënd lojërash, për të cilin kishte edhe plan dhe për të cilin është planifikuar të jetë i pajisur me mobile të reja me çka do të sigurohen kushte më të mira.

Në anën tjetër të korridorit janë të vendosura tualetet të cilat në përgjithësi ishin të pastra, por në dysheme kishte një sasi të madhe të ujit, kështu që krijohet përshtypja ujësjellësi nuk është në gjendje të mirë funksionale.

Në pjesën e meshkujve në një lokal janë të vendosur dy deri tre fëmijë. Gjatë vizitës së

kësaj njësie është konstatuar se lokalet janë të rregullta, të pastra me shtroja të pastra dhe të rregulluara. Në dhoma ka të vendosura dritare të reja, prej ku hyn dritë e mjaftueshme. Lokalet janë të pajisura edhe me sende të tjera për aktivitete të kohës së lirë, të tilla si televizor, kompjuter, radio dhe kështu me radhë.

### ***Kuzhina dhe mensa***

Ekipi i MPN-së inspektoi në kuzhinën në të cilën përgatitej ushqimi për fëmijë, me ç'rast ishte konstatuar se kuzhina është në rregull dhe e pastër dhe se disponon me aparate të domosdoshme për përgatitjen dhe ruajtjen e ushqimit për më tepër persona. Në këtë pjesë është vendosur edhe magazina me 2 frigoriferë për ruajtjen e ushqimit. Në pajtim me informatat e personelit, fëmijët janë të kënaqur me ushqimin që u përgatitet në Institucion.

MPN-ja përcaktoi se fëmijëve u përgatitet ushqim i llojllojshëm, e kjo ishte përcaktuar edhe gjatë inspektimit në listën e ushqimeve e cila ishte në rregull dhe e vendosur në vendin ku shihet në kuzhinë. Lista përmban meny të ushqimeve për dy javët rrjedhëse, në të janë të shënuara tri racionet që përmbajnë ushqim të llojllojshëm, përkatësisht pemë, perime, prodhime të qumështit, mish dhe prodhime të mishit dhe këtë e nënshkruan kuzhinieri, drejtori dhe infermierja. Në pajtim me informatat e marra edhe fëmijët përfshihen me propozimet e tyre në hartimin e listës së ushqimit, por gjithashtu, fëmijët kanë mundësi edhe të përfshihen në përgatitjen e mëngjesit sipas dëshirës së tyre. Edukuesi i mbrëmjes i informon kuzhinierët se sa fëmijë janë prezent në atë moment në institucion, dhe për aq fëmijë përgatitet ushqimi, me plus katër pjata rezervë. Në kuzhinë vërejtëm edhe certifikatë të sistemit implementues për sigurinë e ushqimit.

### **Mbrojtja shëndetësore**

Ekipi i MPN-së e vizitoi edhe repartin e mbrojtjes shëndetësore, përkatësisht dhomën e ambulancës, me ç'rast përcaktoi se kjo ishte pajisur me byro të punës dhe me kompjuter. Në lokalin e ambulancës ekzistojnë medikamentet themelore dhe mjetet ndihmëse mjekësore. Në këtë lokal nga infermierja realizohen kontrollet sistematike të fëmijëve.

### **Trajtimi i fëmijëve të vendosur në institucion**

Ekipi i MPN-së bisedoi me disa fëmijë të cilët ishin të moshave të ndryshme, të gjinive të ndryshme dhe të përkatësive të ndryshme etnike pa prezencën e të punësuarve në institucion. Fëmijët janë të kënaqur nga institucionet dhe nga veprimi me ta dhe asnjëri nuk u ankua në veprimin e dobët, llojin fizik apo llojin tjetër të dhunës nga ndonjëri prej të punësuarve në institucion. Gjithashtu, nga biseda me disa shfrytëzues u mor informata se fëmijët e njohin punën e punëtorit social dhe të psikologut dhe se janë të kënaqur prej saj.

Nga biseda me disa fëmijë të gjinisë femërore, MPN-ja ishte informuar se janë të kënaqur prej ushqimit, por si problem e theksojnë ngrohjen e pamjaftueshme në periudhën e dimrit, për këtë shkak nga institucioni u janë siguruar edhe batanije.

Disa prej shfrytëzuesve me të cilët MPN-ja bisedoi theksuan se u mungon kontakti me familjen e ngushtë. Gjatë bisedës nga shfrytëzuesit u theksua se në mes tyre kanë zhvilluar një interaksion, si i ndërsjellë në kornizat e institucionit, ashtu edhe jashtë tij, sepse institucioni është i llojit të hapur. Fëmijët theksuan se nuk ekziston formë e dhunës, me përjashtim të shfrytëzimit të ofendimeve të caktuara verbale ndërmjet shfrytëzuesve.

Në lidhje me shqiptimin e masave disiplinore, shërbimet njoftuan se është shqiptuar vetëm një masë disiplinore, kundër një fëmije për shkak të rrahjes. Masa ka qenë „vendosja e të miturit në institucion“, dhe kjo është shqiptuar në mënyrën që fëmija në Institucion është

vendosur 20 ditë drejtpërdrejtë pas ngjarjes.

### **Procesi arsimor**

MPN-ja përcaktoi se të gjithë fëmijët që janë të vendosur në Institucion janë të përfshirë në procesin arsimor i cili edhe më tutje zbatohet nga shkolla fillore „Zhivko Brajkovski“ - Shkup, me ç’rast mësimitdhënësit i mbajnë orët në këtë institucion në të cilin ka klasa të pajisura. Arsimi i mesëm realizohet jashtë institucionit me përfshirjen në sistemin e rregullt të shkollës së mesme.

Në lidhje me procesin arsimor, Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se nxënësit kanë mendim pozitiv për mësuesen e mësimit klasor, por ajo shpesh është e sëmurë dhe nuk mban mësim. Shqetëson fakti që sipas deklaratave të fëmijëve, në mungesë të mësueses, zëvendësimin e kryen njëra ndër nxënëset apo edukatorja që është në ndërrim.

Sipas vlerësimit të MPN-së, nevojitet që nxënësit të mësojnë në shkollën më të afërt, e jo të veçuar në Institucion. MPN-ja konsideron se ka nevojë për përfshirjen e fëmijëve në shkollat fillore, me qëllim fëmijët më mirë të integrohen në bashkësi.

### **Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna**

Në lidhje me rekomandimet e dhëna në Raportin e veçantë, në lidhje me vizitën e bërë në IP për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Sociale Edukuese dhe Sjellje të Çrregulluar - Shkup, institucioni dorëzoi përgjigje jashtë afatit të paraparë ligjor, përkatësisht pas urgjencës së dorëzuar nga MPN-ja. Gjithashtu, edhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dorëzoi përgjigje pas urgjencës së dorëzuar.

Në përgjigjen, drejtori i institucionit na informoi se higjiena në Institucion rregullisht mirëmbahet, por në ditën e vizitës në tualetet në pjesën e femrave kishte pëlçitje të gypit të ujësjetillësit që shkaktoi grumbullimin e një sasive të madhe të ujit. Drejtori, gjithashtu, informoi se duke vepruar sipas rekomandimeve të MPN-së, në ndërkohë janë zëvendësuar rubinetet e prishura, kurse në rrjedhë është procedura për furnizimin e dymve të reja në tualete dhe zëvendësimi i dymve ekzistuese.

Në lidhje me rekomandimet dhe shqetësimin e MPN-së për cilësinë e mësimit, drejtori i institucionit na informoi se edhe pse mësuesja e klasës shpesh mungon, si zëvendësim thirret mësuesja tjetër nga SHF „Zhivko Brajkovski“ - Shkup.

Rekomandimi i MPN-së, për nevojën që nxënësit të mësojnë në shkollën më të afërt (SHF „Zhivko Brajkovski“ - Shkup), e jo të veçuar në Institucion dhe përfshirjen e tyre në procesin arsimor në shkollat fillore, nga Institucioni në tërësi është i pranuar. Duke vepruar sipas rekomandimeve të MPN-së, drejtori mbajti më tepër mbledhje me udhëheqësin e shkollës më të afërt, ashtu që është arritur marrëveshje për regjistrimin e dyfishtë të nxënësve në shkollën e përmendur, me pritje se në vitin shkollor 2016/2017, procesi i arsimit për shfrytëzuesit e Institucionit në tërësi do të zhvillohet në këtë shkollë.

Në lidhje me ngrohjen, MPN-ja ishte informuar se lokalet në periudhën e dimrit ngrohen mjaftueshëm dhe se vërejtjet nga fëmijët në lidhje me këtë çështje, sipas tij, janë të pabaza.

Në lidhje me nevojën për përparimin e teknikave për punën e psikologut, është dhënë sqarimi se në punën me fëmijët zbatohen teknikat përkatëse, dhe u shmangen teknikave për të cilat nevojitet kohë më e gjatë për realizim (tri deri katër orë), dhe të cilat marrin shumë kohë dhe krijojnë shqetësim te fëmijët, veçanërisht nëse janë në procesin e përshtatjes.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e informoi MPN-në në lidhje me rekomandimet për bashkëpunim të madh me organizatat joqeveritare, Ministria është transparente për përparimin e bashkëpunimit, nëse organizata të caktuara tregojnë interes, kurse sa i përket



edukimit të ekipit profesional të IP për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Sociale Edukuese dhe Sjellje të Çrregulluar - Shkup, Ministria jep mbështetje të plotë.

MPN-ja prej Ministrisë ishte informuar se në lidhje me rekomandimet për nevojën nga përfshirja e nxënësve në procesin arsimor në shkollat fillore, nga Ministria janë marrë masat përkatëse dhe janë realizuar kontaktet me Ministrinë e Arsimit dhe me Vetëqeverisjen Lokale - Butel.

### **2.3.3. Vizitë në IP për Përkujdesjen, Edukimin dhe Arsimimin e Fëmijëve dhe të Rinjve „Ranka Millanoviq“ - Shkup**

Në kornizat e realizimit të Tuning Projektit për mbështetjen e institucionit Avokat i Popullit, Mekanizmi Parandalues Nacional së bashku me përfaqësuesit e Seksionit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Personave me Nevoja të Veçanta në përbërjen e Avokatit të Popullit, përfaqësuesit e Mekanizmit Parandalues Nacional të Austrisë dhe bashkëpunëtorët e jashtëm - përfaqësuesit e Shoqatës së Punëtorëve Socialë të Qytetit të Shkupit dhe Odës së Psikologëve të Republikës së Maqedonisë, realizoi vizitë në IP për Përkujdesjen, Edukimin dhe Arsimimin e Fëmijëve dhe të Rinjve „Ranka Millanoviq“ - Shkup.

#### **Struktura e Institucionit Publik**

Në pajtim me rregullativën ligjore, IP për Përkujdesjen, Edukimin dhe Arsimimin e Fëmijëve dhe të Rinjve „Ranka Millanoviq“ - Shkup është institucion që ka për detyrë të sigurojë për shfrytëzuesit kushte përkatëse për vendosje, ushqim, zbatim të planifikuar dhe të organizuar të përmbajtjeve, masave dhe aktiviteteve në procesin e edukimit dhe arsimimit të tyre, aktiviteteve të lira dhe jetës argëtuese kulturore, si dhe të përkujdeset për jetën dhe shëndetin e shfrytëzuesve të përkujdesur.

Kapaciteti për vendosje në IP për Përkujdesjen, Edukimin dhe Arsimimin e Fëmijëve dhe të Rinjve „Ranka Millanoviq“ - Shkup arrin 75 persona. Në momentin e vizitës sipas dokumentacionit u regjistruan 22 fëmijëve, prej të cilëve 5 fëmijë të gjinisë femërore dhe 17 fëmijë të gjinisë mashkullore. Prej tyre 17 fëmijë janë të dërguar në Institucion si rezultat i vendimit të shqiptuar gjyqësor, kurse 5 janë me probleme sociale edukuese.

Gjatë kohës së vizitës ishte përcaktuar se vetëm 4 fëmijë ishin prezent në Institucion, dhe 2 fëmijë ishin në mësim në shkollë të mesme. 9 fëmijë mungonin nga Institucioni pa leje, për të cilët me kohë ishte shpallur fletarrestim, 2 fëmijë ishin larguar në shtëpitë e tyre me lejen e drejtorisë, kurse 5 fëmijë ishin në përshtatje në shtëpitë e tyre.

Sipas MPN-së, shqetëson fakti që një numër i madh i fëmijëve mungojnë pa arsye nga Institucioni Publik.

Në IP për Përkujdesjen, Edukimin dhe Arsimimin e Fëmijëve dhe të Rinjve „Ranka Millanoviq“ - Shkup ka fëmijë të përkujdesur që nuk kanë arsim fillor, kurse janë të moshës 17-vjeçare dhe shkojnë në klasë të parë, sipas programit të rregullt të Byrosë së Arsimit.

MPN-ja mori informatë se në Institucionin Publik ka të punësuar edukues, një psikolog, një pedagog, një punëtor social, arkëtar, jurist, sekretar, instruktor, kuzhinier dhe 8 mësimdhënës klasorë të angazhuar nga Ministria e Arsimit. Por, nga vizita ishte konstatuar se në Institucionin Publik nuk ka të punësuar person mjekësor, kurse një pjesë e fëmijëve nuk kanë sigurim shëndetësor. Nga 01.07.2015, IP për Përkujdesjen e Fëmijëve me Probleme Sociale Edukuese dhe Sjellje të Çrregulluar - Shkup dhe IP për Përkujdesjen, Edukimin dhe Arsimimin e Fëmijëve dhe të Rinjve „Ranka Millanoviq“ - Shkup janë bashkuar dhe juridikisht përbëjnë një institucion.

## **Kushtet materiale**

### ***Lokalet shkollore dhe kapacitetet për vendosje***

Mekanizmi Parandalues Nacional inspektoi në klasat e parapara për mbajtjen e mësimit. Pastaj konstatoi se këto lokale nuk kanë mjaft kushte teknike për punë, mjete mbikëqyrëse, përkatësisht tabelat ishin të vjetra. Edhe pse pas inspektimit të ditëve ishte konstatuar se në institucion ka të regjistruar më tepër fëmijë, për shkak të ikjes nga Institucioni apo dërgimit në përshtatje, mësimin e ndjekin një numër mjaft i vogël i fëmijëve.

**Seksioni i femrave** - Gjatë vizitës në seksionin e femrave, përfaqësuesit e Mekanizmit Parandalues Nacional takuan vetëm një vajzë. Dhoma në të cilën ajo qëndronte ishte relativisht e pastër, por mundej të ndihej era e lagështisë, mirëpo gjithashtu, ishte vërejtur se muret nuk ishin të lyera me gëlqere. Lokalet tjera të seksionit të femrave ishin të zbrazura, kurse kishte edhe një lokal (dhomë) më të madh në të cilin ishin të deponuar krevetet dhe dyshekët që në këtë moment nuk përdoren. Tualetet dhe banjat ishin të pastra, kishte ujë të ngrrohtë, me atë që disa nga çezmat dhe kazanët në tualetet nuk ishin në funksion.

**Seksioni i meshkujve** - MPN-ja inspektoi në disa dhoma të fjetjes edhe në seksionin e meshkujve, me ç'rast përcaktoi se mobilja ishte në gjendje të dobët. Çarçafin që e shfrytëzojnë fëmijët ishte i vjetër. Megjithatë, lokalet ishin të pastra, ashtu që higjiena ishte në nivelin e duhur.

### ***Kuzhina dhe mensa***

MPN-ja inspektoi në kuzhinë dhe përcaktoi se mirë është e pajisur me aparate elektrike përkatëse, kurse higjiena në të ishte në nivelin e duhur. Ekipi ishte informuar se çdo ditë përgatiten tri racione për mëngjes, drekë dhe darkë (nga dhjetë pjata). Të punësuarit lajmëruan se ushqimi është i njëjloshëm. Sipas deklaratave të fëmijëve, ata nuk i marrin çdoherë racionet e parapara, e ndonjëherë mungon pema, qumështi apo perimet.

### **Trajtimi dhe veprimi me shfrytëzuesit**

Gjatë vizitës, MPN-ja bisedoi me tre shfrytëzues. Gjatë bisedës me njërin nga shfrytëzuesit, MPN-ja mori informatë se është i kënaqur nga ushqimi, merr para, merr leje për dalje, merr leje për Vitin e Ri ta vizitojë shtëpinë e tij, me çka në Institucionin Publik është kthyer me kohë. Personi e informoi MPN-në se askush prej personelit nuk ushtron dhunë mbi të dhe se nuk ka qenë dëshmitar i dhunës mbi shfrytëzuesit tjerë. Shfrytëzuesi informoi se ka sulme të përkohshme nga shfrytëzuesi i vjetër i cili është i dhunshëm, por Drejtorja mori masa për parandalimin e dhunës, kurse dhunuesi shfrytëzues është dënuar me ndalim për dalje dhe shkurtim të parave. Shfrytëzuesi i njëjtë e informoi MPN-në se rregullisht viziton mësim, ka edhe një vjet të mbarojë shkollën fillore, për çka pret të shkojë në shtëpi dhe ta vazhdojë arsimin në shkollën e hotelerisë në vendlindje.

Në lidhje me aktivitetet tjera, përveç kryerjes së obligimeve të shkollës, në hartimin e detyrës së shtëpisë, shfrytëzuesi deklaroi se merr pjesë në pastrimin e lokaleve dhe oborrit, por nuk merr pjesë në aktivitetet rekreative sportive dhe aktivitetet tjera.

Personi i dytë me të cilin ekipi i MPN-së bisedoi është vendosur në Institucionin Publik që katër muaj e gjysmë. Personi deklaroi se është i kënaqur nga kushtet për jetë në Institucion dhe nga raporti i të punësuarve. Theksoi se shpesh kontakton me psikologun, zyra e të cilit është çdoherë e hapur për shfrytëzuesit dhe se ai shpesh e viziton. Sipas tij, ushqimi nuk është i mirë, e as që i përmbush nevojat e tyre, edhe pse kanë mundësi të kërkojnë pjata plotësuese.

Në lidhje me aktivitetet plotësuese, personi deklaroi se merr pjesë në pastrimin e lokaleve të qëndrimit dhe të oborrit, ndonjëherë i ndihmon mjeshtrit të Institucionit, kurse dëshira e tij është të vizitojë shkollën e natës për elektrikistë. Shfaq interes edhe për aktivitetet sportive, por në institucion nuk zhvillohen kurrfarë aktivitetesh tjera.

MPN-ja në bisedë me vajzën e vetme që ishte e pranishme në Institucionin Publik, në pyetjen nëse është e kënaqur nga trajtimi që merr, u përgjigj pozitivisht dhe theksoi se është e kënaqur nga raporti i të punësuarve, e veçanërisht nga psikologu. Shfrytëzuesja u ankua për higjienën në kuzhinë dhe në cilësinë e ushqimit. Njëkohësisht, na informoi se nuk ndjek mësimin, sepse nuk i pëlqen mënyra në të cilën zhvillohet programi mësimor dhe se nuk është mjaft e motivuar nga të punësuarit.

Në bisedë me njërin ndër të punësuarit edukatorë, MPN-ja u informua se një periudhë të gjatë kohore fëmijët nuk kanë përkujdesje përkatëse në aspekt të përparimit dhe përmirësimit të edukatës, nuk kanë angazhime plotësuese, dhe përveç leximit dhe rregullimit të lokaleve ku qëndrojnë, nuk kanë aktivitete konkrete për risocializimin dhe përmirësimin e sjelljes së tyre.

Këtë e përcaktoi edhe ekipi i MPN-së gjatë vizitës, pra gjatë gjithë kohës derisa zgjati vizita, fëmijët ishin në oborr pa kurrfarë aktivitetesh.

MPN-ja mori informatë se në Institucionin Publik më e përfaqësuar është sjellja destruktive ndaj inventarit (goditja e dyerve, thyerja e dyerve, thyerja e karrigeve, thyerja e televizorit, etj.). Dhuna në mesin e fëmijëve ndodhë me incident, dhe kjo evidentohet në libër të veçantë.

### **Mbrojtja sociale**

Sipas informatave të marra nga ekipi profesional i Institucionit Publik dhe sipas dokumentacionit profesional, MPN-ja përcaktoi se për çdo fëmijë në Institucion mbahet një dosje kumulative për të cilën është ngarkuar punëtori social dhe e cila përmban: Dokumentacionin socio-pedagogjik; Teknikat psikologjike; Dokumentacionin pedagogjik; Konstatimin dhe mendimin e punëtorit social; Konstatimin dhe mendimin e pedagogut; Dokumentin socio-pedagogjik të Qendrës Ndërkomunale për Punë Sociale; Raportin për planin dhe programin për Qendrën Ndërkomunale për Punë Sociale; Dokumentacionin për pranim; Formularët për ndjekje një herë në javë; Dëftesat dhe vërtetimin mjekësor se fëmija është i shëndoshë psikofizik; Listën me aktivitetet e përditshme; Dokumentacionin për pranime dhe lëshime.

Ekipi profesional i Institucionit Publik përgatit plan individual për secilin shfrytëzues, që revidohet në çdo gjashtë muaj, e njëkohësisht në çdo gjashtë muaj dorëzon raport te Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale dhe te gjykata, nëse fëmija është dërguar në institucion me masën e shqiptuar nga gjykata kompetente.

Gjatë inspektimit, MPN-ja përcaktoi se raporti mujor për realizimin e planit dhe programit për çdo shfrytëzues ishte plotësuar me rregull nga punëtori social, psikologu dhe pedagogu. Punëtorët socialë në Institucion punojnë në dy turne, një herë në javë kanë kujdestari ditore dhe janë koordinatorë në ndërrim, dy herë në muaj gjatë fundjavave njëri ndër punëtorët socialë është i pranishëm në Institucion.

Në realizimin e punës profesionale dhe gjatë hartimit të konstatimit dhe mendimit, punëtorët socialë e shfrytëzojnë intervistën dhe gjenogramin si metoda dhe teknika për punë. Lista për ndjekjen e punës me shfrytëzuesin, gjenogrami, konstatimi dhe mendimi i punëtorit social janë pjesë e dosjes së çdo fëmije në institucion.

Plani për punë i punëtorit social është integruar në konstatimin dhe mendimin e ekipit profesional të Institucionit.

MPN-ja nga inspektimi në dokumentacion përcaktoi se punëtori social me rregull mban regjistër me rend alfabetik (formuari US3-1) të shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale në institu-

cion, libër për pranimin e shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale, libër të amzës për shfrytëzuesit e mbrojtjes sociale, libër për verifikimin e aktvendimeve të dërguara nga prokurori publik themelor dhe gjykata themelore për çdo fëmijë dhe libër për shfrytëzuesit e fshirë. Në libër të veçantë evidentohen ftesat e të miturve për në gjykatë.

MPN-ja konstatoi se punëtori social ka kontakte të përditshme me fëmijët në Institucionin Publik, që i evidenton në listën e afateve, e pastaj evidentohen në Listën për bisedën e realizuar individuale. Çdo fëmijë që duhet të paraqitet në gjykatë shoqërohet nga punëtori social.

Gjatë vizitës, punëtori social e informon ekipin e MPN-së se nuk ka takime me prindërit/kujdestarët e fëmijëve, edhe pse në planin e tij parashihen takime dhe njohja me mënyrën institucionale të jetesës. Në planin dhe programin, punëtori social nuk ka paraparë punë profesionale me familjen e shfrytëzuesve, e as vizitën e shtëpisë së tij nëse ka nevojë prej saj, për shkak të pamundësisë për realizimin e këtyre aktiviteteve.

MPN-ja konsideron se është e domosdoshme të realizohen kontakte me prindërit e shfrytëzuesve dhe të zbatohet puna sociale grupore.

Ekipi i MPN-së nga bisedat e bëra me shfrytëzuesit e vendosur në Institucion mori përshtypjen se fëmijët e njohin punën e punëtorit social, si dhe se janë të kënaqur nga puna e tij.

### **Mbrojtja shëndetësore**

Në lidhje me realizimin e mbrojtjes shëndetësore, ekipi i MPN-së përcaktoi se fëmijët e vendosur në këtë Institucion nuk e realizojnë të drejtën e mbrojtjes shëndetësore, përkatësisht nuk kanë mjek amë, sepse Ligji për mbrojtje shëndetësore nuk lejon më tepër se dy herë të ndërrohet mjeku amë, e duke pasur parasysh faktin që fëmijët janë nga qytete të ndryshme, nevojitet të mundësohet ky ndryshim. Nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të pranuar në këtë Institucion, 4 fëmijë janë shfrytëzues të mjeteve narkotike të cilëve Institucionin u lejon të mungojnë për shkak të mjekimit në institucionin përkatës për heqjen dorë dhe trajtimin e shfrytëzuesve të mjeteve narkotike.

MPN-ja u informua se nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të vendosur në këtë Institucion, 4-5 fëmijë thithin ngjitëse, kurse disa fëmijë konsumojnë alkool.

### **Procesi arsimor**

Procesi arsimor zhvillohet sipas programit mësimor për shkollat e rregullta fillore.

MPN-ja konsideron se duke pasur parasysh se këta fëmijë janë me aftësi intelektuale mesatare, programi që zbatohet në shkollat e rregullta fillore nuk është përkatës për ta, sepse nuk janë në gjendje ta ndjekin. Kjo, nga shkak që tek ata, edhe pse janë me aftësi intelektuale mesatare, ekzistojnë pengesa emocionale, vonesa emocionale dhe sociale. Në këtë lidhen pengesat në arsim, si rrjedhojë ekzistojnë zbrazëtira në njohuritë, madje edhe në rastet kur kanë të mbaruar nivel të caktuar të arsimit. Si rrjedhojë, fëmijët kanë mangësi të mëdha në njohuri dhe nuk mund të lidhen në procesin arsimor rrjedhës në klasën ku janë të përfshirë.

Në bisedën me njërin ndër të punësuarit edukues, MPN-ja u informua se një periudhë të gjatë kohore fëmijët nuk kanë përkujdesje përkatëse në aspekt të përparimit dhe përmirësimit të edukatës, nuk kanë angazhime plotësuese dhe përveç pastrimit dhe rregullimit të lokaleve ku qëndrojnë nuk kanë aktivitete për risocializimin dhe përmirësimin e sjelljes së tyre.

Psikologu shfrytëzon një metodologji përkatëse dhe ka inspektim në gjendjen psikike të shfrytëzuesve. Pasi numri i shfrytëzuesve shpesh është i vogël, më tepër angazhohet me punën individuale me çdo shfrytëzues. Edhe pse ka ndjekur trajnime të caktuara për punën

me fëmijët dhe të rinjtë me sjellje të çrregulluar, ka nevojë për zgjerimin e njohurive, sepse në praktikën psikologjike futen teste të reja dhe teste psikologjike moderne dhe teknika përkatëse për ndihmën e personave me probleme të kombinuara, veçanërisht emocionale dhe sociale.

MPN-ja konstaton motivim të pamjaftueshëm të të punësuarve për realizimin e procesit arsimor, që nuk mund të arsyetohet me specificitetin e shfrytëzuesve.

### **Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna**

Në lidhje me vizitën e bërë paraprakisht në IP për Përkujdesjen, Edukimin dhe Arsimimin e Fëmijëve dhe të Rinjve „Ranka Millanoviç“ – Shkup dhe Raportin e veçantë të dorëzuar, Institucioni dorëzoi përgjigje jashtë afatit të paraparë ligjor, përkatësisht pas urgjencës së dorëzuar nga MPN-ja. Gjithashtu, edhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dorëzoi përgjigje pas urgjencës së dorëzuar.

Në përgjigjen, drejtori i Institucionit në tërësi u pajtua me rekomandimin për përmirësimin e kushteve për qëndrim, kurse në lidhje me sasinë dhe cilësinë e ushqimit konsideron se ky është në nivel të duhur.

Në lidhje me faktin se shfrytëzuesit që janë të vendosur në Institucion në bazë të aktvendimeve të gjykatave themelore nuk janë të liruar nga pagesa e participimit, institucioni shumë herë kërkoi ndryshimin e rregullativës ligjore, por situata mbeti e pandryshuar.

Rekomandimi i MPN-së për punësimin e kuadrit profesional plotësues, si dhe nevojën nga zbatimi i punës sociale grupe, në tërësi pranohet.

Në lidhje me arsimin, drejtori theksoi se për nxënësit me vështirësi edukative të cilët deri në momentin e përkujdesjes nuk ishin përfshirë në sistemin arsimor, hartohen programe të veçanta individuale për punë sipas nivelit arsimor të fëmijës.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e informon MPN-në se përparon bashkëpunimi me Byronë e Arsimit për shkak të nevojës nga ndërhyrja në programin mësimor dhe metodat për realizimin e mësimin.

Në lidhje me rekomandimin për sigurimin e kuadrit profesional plotësues, Ministria theksoi se në të ardhmen do të bëhen përpjekje për përparimin e kapaciteteve në institucion, dhe për motivim të mirë të kuadrit profesional për realizimin e detyrave të punës.

Që rekomandimi të gjejë vendosje alternative të personave të pastrehë, Ministria informon se kërkohet zgjidhja përkatëse, por se problemi nuk është zgjidhur për shkak të mungesës së mjeteve materiale.

## **2.3.4. Vizita në IP Enti për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve (Fusha e Topanës) - Shkup**

Mekanizmi Parandalues Nacional - MPN, së bashku me ekipin e Seksionit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Personave me Nevoja të Veçanta tek Avokati i Popullit, përfaqësuesit e Mekanizmit Parandalues Nacional të Austrisë dhe bashkëpunëtorin e jashtëm të Shoqatës së Defektologëve, zbatoi vizitë në IP Enti për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve - Shkup.

### **Veprimtaria dhe struktura**

Enti për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve – Shkup është Institucion Republikan me interes publik dhe është në rjetin e institucioneve publike me karakter social. Veprimtaria themelore e Entit për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve është sigurimi i trajtimit

përmirësues rehabilitues të fëmijëve dhe të rinjve me pengesa të konsiderueshme, të vështira dhe të kombinuara në zhvillimin intelektual. Ky trajtim bën përfshirjen ditore dhe të internatit, përkujdesje, edukim, arsim, aftësi të punës, angazhim të punës dhe okupim të punës, mbrojtje shëndetësore, si dhe jetë argëtuese kulturore dhe jetë rekreative sportive të personave nën përkujdesje. Personat në Entin për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve – Shkup qëndrojnë në bazë të aktvendimit të Qendrës për Mbrojtje Sociale.

Në momentin e vizitës, në Ent qëndronin 63 shfrytëzues. Prej tyre 37 shfrytëzues janë të moshës prej 9 deri 30 vjeç, prej tyre 23 shfrytëzues janë pa përkujdesje prindërore, kurse 26 shfrytëzues çdo ditë merren nga familjet dhe pas mbarimit të mësimit në mënyrë të organizuar kthehen në shtëpitë e tyre.

Ka përjashtime, përkatësisht 9 persona pa përkujdesje prindërore qëndrojnë në Ent edhe pas moshës 26-vjeçare, deri në momentin e sigurimit të vendbanimit përkatës. Gjatë vitit, Enti siguroi mjete për pajisjen e njërive për të jetuar me mbështetje, në të cilat planifikohet të vendosen personat mbi moshën 26-vjeçare.

### **Kushtet materiale**

Në përbërjen e Entit hyjnë tri objekte të ndërtimit të fortë me sipërfaqe prej 3.009 m<sup>2</sup>, ato janë: Internati, objekti për aftësim për punë dhe objekti në të cilin janë të vendosur Drejtoria, Qendra Ditore e të Rriturve dhe Seksioni i Edukimit. Oborri është me sipërfaqe prej 16.000 m<sup>2</sup>, prej të cilave fushat sportive me sipërfaqe 4.500 m<sup>2</sup> dhe oborri me sipërfaqe prej 11.500 m<sup>2</sup>.

MPN-ja përcaktoi se objektet janë më të vjetra se 40 vjet dhe se për funksionim normal të Entit nevojitet të bëhet renovimi dhe zëvendësimi i dritareve, zëvendësimi i instalimit për furnizimin e ujit, instalimit për ngrohje dhe llojin tjetër të rekonstrukcionit.

Në të gjitha klasat ekziston plani dhe orari i aktiviteteve, kushtet e mira të lokalit dhe kushtet teknike për punë dhe numri i kufizuar i mjeteve mbikëqyrëse të cilat defektologët shpesh vetë i përpunojnë. Klasat janë të pajisura me tabelë, banka dhe karrige. Në këtë Seksion ekziston edhe kabineti i logopedit, por ky nuk është në funksion.

### **Trajtimi dhe veprimi me shfrytëzuesit**

MPN-ja konstaton se në Entin për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve – Shkup, aktivitetet zhvillohen sipas Planit dhe Programit të përcaktuar, me të cilat planifikohen të gjitha segmentet e punës me shfrytëzuesit. Në kornizat e Institucionit, funksionon ekipi profesional në përbërje: defektologu ndihmës drejtor, psikologu, punëtori social dhe mjeku. Ekipi profesional në mënyrë aktive punon në planin për pranimin e shfrytëzuesve të rinj, observacionin dhe sistematizimin e shfrytëzuesve të sapopranuar në nivelin përkatës, respektivisht grupin përkatës, transferimin prej njërit grup në grupin tjetër dhe prej njërit Seksion në Seksionin tjetër. Për secilin shfrytëzues mbahet dosja që vazhdimisht plotësohet me plane dhe rezultate nga edukimi dhe aftësia për punë.

Në Entin për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve - Shkup, logopedi është i angazhuar në aftësimin për punë të shfrytëzuesve. Te numri më i madh i shfrytëzuesve, të folurit është i pazhvilluar në tërësi dhe këta në komunikim shfrytëzojnë gjeste dhe udhëheqje fizike.

Numri më i madh i fëmijëve nuk kanë të vendosur shprehë higjienike kulturore, por duke pasur parasysh se nuk ka të përfshirë edukatore, në masë të madhe është e rënduar puna e defektologut, i cili shpesh duhet ta ndërpresë procesin edukativo-arsimor dhe t'i dërgojë fëmijët në Internat.

Nga bisedimet e kryera, MPN-ja përcaktoi se nxënësit janë të kënaqur nga mësimi dhe

nga raporti i mësimdhënësve ndaj tyre, dhe se mund lirisht të shkojnë në shtëpi gjatë pushimit dhe të dalin vetë (kanë kartela për identifikim). Gjithashtu, shfrytëzuesit shprehën kënaqësi nga cilësia e ushqimit dhe nga kushtet për vendosje.

### **Edukimi**

Në Institucion realizohet trajtimi edukativo-arsimor dhe trajtimi përmirësues rehabilitues. Trajtimi përmirësues rehabilitues është një proces i gjatë, i cili ka për qëllim të bëjë korigjimin e domosdoshëm apo zbutjen e pasojave sekondare, të shkaktuara nën ndikimin e pengesës primare në zhvillim, me qëllim të shfrytëzimit të mundësive dhe aftësive individuale, me të cilat disponon fëmija për shkak të sigurimit të mënyrës së mëvetësishme dhe cilësore të jetës dhe socializimit.

Puna profesionale zhvillohet në Seksionin e Edukimit, Aftësimit për Aktivitetet Prodhuese të Punës dhe Qendrën Ditore për të Rritur dhe zhvillohet nga personat profesionalë – defektologë, të sistematizuar në katër nivele, me nga një apo dy grupe në secilin nivel, në varësi nga numri i fëmijëve. Fëmijët sipas niveleve përkatëse, janë të sistematizuar në varësi nga mosha kalendrike dhe mentale, si dhe në varësi nga mundësitë dhe aftësitë e tyre.

MPN-ja u informua se trajtimi defektologjik profesional të cilin secili defektolog e zbaton përbëhet prej një varg mënyrash dhe metodash specifike të punës për realizimin e procesit rehabilitues. Si moment plotësues dhe kompleks në procesin e edukimit është prania e shpeshtë dhe pranimit të fëmijëve dhe të rinjve me pengesa të kombinuara në zhvillim, si dhe fëmijëve me simptoma të autizmit, fëmijëve hiperaktivë dhe fëmijëve me sjellje psikotike.

MPN-ja konsideron se për një realizim të suksesshëm të qëllimeve dhe detyrave të para para nga edukimi dhe arsimimi i kësaj kategorie të fëmijëve, i domosdoshëm është procesi i vazhdueshëm dhe mirë i organizuar dhe i sistematizuar edukativo-arsimor i cili për shkak të ndërlikimit të tij kërkon dhënien maksimale të punës dhe energjisë nga të punësuarit.

Sipas të dhënave të marra, në Entin për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve - Shkup, momentalisht ka 20 shfrytëzues prej nivelit të parë deri në nivelin e katërt, të sistematizuar në katër grupe që ndjekin mësim në ndërrimin e parë dhe të dytë, prej të cilëve 5 shfrytëzues janë më të moshuar, por janë të përfshirë në grupet me programin e integruar për jetë të pavarur.

Me shfrytëzuesit që kanë mbaruar nivelin e katërt, por të cilët për shkak të llojit të pengesës nuk kanë mundësi të përfshihen në procesin e aftësimit për punë zbatohet programi për okupimin me punë. Bëhet fjalë për 10 shfrytëzues të cilët janë të sistematizuar në dy grupe të kombinuara për okupim me punë. Mësimin e realizojnë gjithsej 11 mësimdhënës - defektologë.

Nga inspektimi në planet dhe programet mësimore, MPN-ja përcaktoi se mësimdhënësit punojnë me programe të veçanta, zbatojnë punë individuale dhe planifikim individual në mësim. Në secilin grup mbahet ditari për punën edukativo-arsimore, kurse për secilin fëmijë ekziston Plani arsimor individual dhe mbahet evidencë e sukseseve. Ekziston Plani për realizimin e aktiviteteve të projektit, Plani për realizimin e aktiviteteve jashtë mësimin dhe aktiviteteve të lira, etj.

### **Aftësimi për punë**

Pas mbarimit të nivelit të katërt, shfrytëzuesit përfshihen në aftësimin për punë. Përfshirja theksohet në mënyrën si vijon: së pari vlerësohen afinitetet dhe aftësitë e shfrytëzuesve për profesionin e caktuar, pastaj shfrytëzuesit njihen me të gjitha grupet për aftësimin për punë, me çka e shprehin interesin e tyre, që në fund të vendos ekipi profesional, duke mbajtur llogari edhe për interesin e shfrytëzuesit.

Në Seksionin e Aftësisimit për Punë janë të përfshirë gjithsej 15 shfrytëzues të cilët janë të ndarë në tri grupe për punën edukativo-arsimore dhe katër grupe për mësimin praktik: servisi për pastrim dhe hekurrosje, auto-servisi, punëtorja e zdrukthëtarit dhe punëtorja e metalit. Me shfrytëzuesit punojnë tre mësimdhënës - defektologë dhe katër instruktorë. Në këtë Seksion, shfrytëzuesit aftësohen për kryerjen e punëve të rëndomta nga procesi i punës, në pjesën në të cilën janë të orientuar, në pajtim me aftësitë dhe interesat e tyre.

Gjatë vizitës në lokalet në të cilat realizohet mësimi praktik, MPN-ja bisedoi me instruktorët dhe shfrytëzuesit dhe konstatoi se ekziston interes i madh të shfrytëzuesit për aftësimin për punë, por aftësitë e tyre janë të kufizuara vetëm në aktivitetet e rëndomta.

Lokalet për mësimin praktik në pjesën më të madhe janë të pajisura me vegla dhe makina për punë, por mungojnë materialet për punë dhe pajisje mbrojtëse. Disa nga lokalet nuk ishin të rregulluara, të ngrohta dhe të ndriçuara në mënyrë përkatëse. Aftësimi për punë nuk lidhet me sektorin real të ekonomisë, për shkak të së cilës është i rënduar punësimi i shfrytëzuesve.

### **Qendra Ditore për Persona të Rritur**

Shërbimet e Qendrës Ditore i shfrytëzojnë gjithsej 18 persona, prej të cilëve 11 shfrytëzues meshkuj dhe 7 shfrytëzuese femra. Aktivitetet në Qendrën Ditore i zbatojnë një defektolog dhe dy instruktorë, sipas programit të përcaktuar prej përpara për punën dhe planifikimin ditor. Shfrytëzuesit merren dhe kthehen në shtëpitë e tyre me transportin e organizuar - autobus i cili është shumë i vjetër, pa ngrohje dhe shpesh prishet. Shfrytëzuesit merren nga shtëpitë në ora 7:15, kurse kthehen në ora 15:00, me shoqërimin e punëtorit social. Ata mund të mbesin edhe më gjatë se ora 15:00, por në atë rast i marrin prindërit apo kujdestarët. Për shfrytëzuesit në Qendrën Ditore është i siguruar mëngjesi, kafeja, lëngu dhe dreka. Qendra Ditore është e pajisur me kuzhinë për çaj, lokal për pushimin ditor, gardërobë, tualet për meshkuj dhe për femra, etj.

Lokali për pushimin ditor në të cilin theksohen edhe aktivitetet është shumë i vjetër dhe në tërësi nuk i përmbush kushtet e nevojshme për qëndrim ditor dhe aktivitete të shfrytëzuesve. Në lokalin ka një aparat të TV-së, disa krevate dhe karrige, tryezë pingpongu dhe inventar të imët.

Në bisedë me shfrytëzuesit përcaktuam se këta janë të kënaqur nga përfshirja e tyre në Qendrën Ditore, por e shprehën nevojën nga siguri i kushteve më të mira për qëndrim dhe aktivitete.

### **Seksioni i Shëndetësisë dhe Internati me Kuzhinë**

Nga inspektimi i kryer në Institucionin Publik, MPN-ja konstatoi se Seksioni i Shëndetësisë dhe Internati me Kuzhinë siguron vendosjen, mbrojtjen shëndetësore primare dhe rehabilitimin, përkujdesjen e plotë dhe kujdesin për gjendjen shëndetësore të çdo individit. Në të janë të punësuar pesë persona mjekësorë, prej të cilëve një mjek, dy infermiere dhe dy teknikë mjekësorë. Për higjienën kujdesen dy pastruese që punojnë në dy ndërrime.

Mbrojtja shëndetësore primare zhvillohet nëpërmjet mjekut amë nga ambulanca "Viktoria" që gjendet në afërsinë e Entit dhe ka për detyrë ordinimin e terapisë mjekësore apo dërgimin e mjekut specialist. Njëkohësisht në Ent ka të punësuar mjek i cili e ndjek gjendjen shëndetësore të shfrytëzuesve dhe njëkohësisht kujdeset për zbatimin e terapisë dhe mjekimit.

MPN-ja mori informatë se dokumentacionin mjekësor e mban mjeku amë nga ambulanca "Viktoria". Për secilin shfrytëzues të ri në Internat, kontroll dhe konsultim kryen ekipi profesional, bëhet observacioni, dorëzohet dokumentacioni për inspektim në gjendjen shëndet-



tësore të secilit shfrytëzues. Dokumentacioni është pjesë përbërëse e dosjes të cilën e mban te punëtori social.

Internati është i vendosur në objektin që është i përbërë nga kati përdhes dhe dy kate, me kapacitet prej 16 dhomash me nga shtatë krevate, por për shkak të mungesës së personalit shfrytëzohet vetëm njëra gjysmë nga të dyja katet, me nga katër dhoma. Në katin përdhes gjendet kuzhina dhe dhoma për ngrënie dhe gjashtë dhomat për fëmijët parashkollorë, prej të cilave dy nuk janë në përdorim. Dhomat për fëmijët parashkollorë janë mirë të pajisura, kanë aparat të TV-së, garnitura për ngrënie dhe në to shfrytëzuesit e kalojnë kohën e lirë. Për të dyja katet është e siguruar kujdestaria nga një infermiere-edukatore (apo edukator) dhe një defektolog. Fëmijët të cilët janë të vendosur në Internat lirisht mund të vizitohen nga familjet e tyre, kurse për fundjava dhe pushime mund të qëndrojnë në shtëpitë e tyre.

Përndryshe, MPN-ja mori informata se shpesh ndodhë që në ndërrimin e parë të mungojë infermiere.

### **Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna**

Në Raportin e veçantë të dorëzuar në IP Entin për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve - Shkup, MPN-ja dha rekomandime në lidhje me procesin e arsimit dhe në këtë kuptim rekomandoi të furnizohen më tepër mjete mbikëqyrëse në klasa. Sipas vlerësimit të ekipit, nevojitet në lokalet për edukim vazhdimisht të ketë edukatore kujdestare, që të mund defektologët në mënyrë të papenguar ta realizojnë punën edukativo-arsimore dhe përmirësuese, por u rekomandua edhe hapja e Kabinetit për Trajnimin Përmirësues Rehabilitues, ku defektologu do të punojë individualisht me secilin shfrytëzues.

Gjithashtu, MPN-ja rekomandoi që kabineti i logopedit të vihet në funksion, të pajisjet me mjetet e nevojshme dhe aparaturën për trajtimin e logopedit, dhe të mundësohet puna e përditshme me shfrytëzuesit, me qëllim zhvillimin e të folurit të tyre.

Duke e pasur parasysh konstatimin se në pjesën e aftësisimit për punë ekzistojnë më tepër mangësi, MPN-ja theksoi se procesi duhet të mbahet me rregulla dhe aktivitete të përkufizuara saktë, duhet të lidhet me ekonominë reale me shoqatat që punësojnë persona me pengesë intelektuale.

MPN-ja rekomandoi që punëtoritë të pajisen me materiale për punë dhe pajisjen HTZ, të jenë mirë të ngrohura dhe të ndriçuara. Njëkohësisht, të sigurohen trajnime për instruktorë për hartimin e Planit individual për aftësimin për punë për të gjithë shfrytëzuesit dhe të mba-hen dosje për aftësimin për punë.

Në mënyrë shtesë, MPN-ja rekomandoi të rritet numri i infermiereve të punësuarra, me çka do të përmirësohet përkujdesja ndaj shfrytëzuesve, kurse defektologët do të lirohen nga kujdestaria që të mund plotësisht të përkushtohen në veprimtarinë edukativo-arsimore dhe rehabilituese.

Në lidhje me kushtet materiale, MPN-ja e theksoi domosdoshmërinë për blerjen e një automjeti të ri, renovimin e Qendrës Ditore dhe pajisjen e saj me karrige dhe tryeza të reja, mjete mbikëqyrëse dhe inventar tjetër, kurse shfrytëzuesit do ta shfrytëzojnë sallën e fizkulturës dhe të përfshihen në programin intensiv të terapisë së okupimit.

Drejtoria e IP Entit për Rehabilitimin e Fëmijëve dhe të Rinjve - Shkup, edhe krahas obligimit ligjor, nuk dorëzoi përgjigje me rastin e Raportit të veçantë të Avokatit të Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional. Gjithashtu, edhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale nuk dorëzoi përgjigje pas urgjencës së dorëzuar.



## VIZITAT E NJËPASNJËSHME NË VITIN 2015

Në vitin raportues 2015, Mekanizmi Parandalues Nacional zbatoi gjashtë vizita të njëpasnjëshme, prej të cilave tri ishin kryer në stacionet policore me kompetencë të përgjithshme, dy në institucionet ndëshkuese përmirësuese dhe një vizitë në Qendrën e Azilkërkuesve.

Vizitat e njëpasnjëshme u zbatuan me qëllim të kontrollohet zbatimi i rekomandimeve të MPN-së, të përmbajtura në raportet e veçanta, të cilat dolën nga vizitat e rregullta të kryera në institucione.

Në vitin 2015 u zbatuan vizitat e njëpasnjëshme në **SP Gazi Babë, SP Prilep dhe SP Koçanë**. Gjithashtu, u zbatuan vizitat në Seksionin e **Arrestit në INP Idrizovë, Burgun Tetovë dhe Qendrën e Azilkerkuesve në Vizbeg**.

### 3.1. Stacionet policore

#### 3.1.1. Stacioni Policor Gazi Babë

Në pajtim me Programin vjetor për vitin 2015, MPN-ja zbatoi vizitë në SP Gazi Babë, me ç'rast bëri kontrollin nëse janë zbatuar rekomandimet e dhëna për përmirësimin e gjendjeve dhe eliminimin e mangësive dhe rreziqeve që mund të qojnë në torturë apo veprim ose ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor apo poshtërues.

Gjatë vizitës së SP Gazi Babë u konstatua se pjesa më e madhe e rekomandimeve të MPN-së që u dhanë në raportin paraprak janë zbatuar.

MPN-ja inspektoi 4 lëndë individuale të personave të mbajtur, me ç'rast përcaktoi se lëndët përmbajnë dosar të veçantë për personin e mbajtur, në pajtim me Procedurat Operative Standarde, që është i hartuar nga faqja e parë, e dytë dhe e tretë, e njëkohësisht ka edhe pasqyrë të qartë se cilat dokumente janë në shtojcën e dosarit. Në të gjitha dosjet individuale kishte edhe procesverbal për kontrollin e personave të mbajtur, në të cilin ishte theksuar se personi i mbajtur ishte mbikëqyrur në çdo 1 orë. Gjatë inspektimit në dosar për personat e mbajtur ishte përcaktuar se me kohë ishte njoftuar familja e personit të mbajtur, kurse në një rast u realizua e drejta për avokat, për çka edhe në procesverbalin për mbajtje kishte nënshkrim dhe faksimil nga avokati. Në një pjesë të dosarëve të kontrolluar ishte parë se ka qenë i njoftuar edhe Prokurori Publik në pajtim me LPP-në.

Nëpërmjet inspektimit në një dosje individuale për mbajtjen e shtetasit të huaj, MPN-ja përcaktoi se në përbërjen e dosjes kishte fletëpalosje për të drejtat e shumë gjuhëve, prej ku mund të përcaktohet se personi në mënyrë përkatëse ishte mësuar për të drejtat e tij në gjuhën që e kupton.



Gjithashtu, MPN-ja u informua se Stacioni Policor Gazi Babë ka të siguruar buxhet përkatës për ushqimin e personave që vuajnë në stacionin policor, mirëpo një dosje për personin e mbajtur më tepër se 6 orë, nuk përmbante dëshmi se personi ka marrë racion, gjatë mbajtjes së tij.

MPN-ja konsideron se nevojitet të plotësohet shënimi zyrtar me të cilën do të përcaktohet se personit që mbahet më tepër se 6 orë, i është siguruar ushqimi nga stacioni policor.

Gjatë vizitës, MPN-ja konstatoi se udhëzimi për të drejtat e personave të arrestuar dhe personave në vuajtje është theksuar në lokale. Në lokalin për marrjen në pyetje të personave, të drejtat janë theksuar në formë të kopjes së plastikës në listën me format A4 dhe janë të ngjitura në mur.

Gjithashtu, MPN-ja konstatoi se të drejtat janë theksuar edhe në korridor, para lokaleve për mbajtje, por jo edhe në këto lokale për mbajtje, sikurse u kërkua në rekomandimet e MPN-së.

Gjatë vizitës së njëpasnjëshme, MPN-ja inspektoi në lokalet për mbajtje, prej ku përcakttoi se lokalet për mbajtje nga pjesa e jashtme e derës ishin të shënuara me numra.

Gjithashtu, nga inspektimi në 4 dosjet individuale, MPN-ja përcakttoi se këto mbahen me rregull, kurse nga inspektimi në procesverbal për vuajtjen e personit, si dhe procesverbalet tjera të ngjashme për udhëzimin dhe realizimin e të drejtave, MPN-ja konstatoi se në të gjitha ka rrjedhë logjike të ngjarjes, përkatësisht verifikohet koha e parë e privimit nga liria.

Në raportin e vizitës paraprake, MPN-ja rekomandoi të vihen në përdorim të dyja lokalet për bisedime me personat e privuar nga liria. Gjatë vizitës dhe inspektimit në të dyja lokalet, MPN-ja konstatoi se vetëm një ndër lokalet për bisedime është vënë në përdorim, përkatësisht shfrytëzohet për dedikim që edhe është paraparë, kurse lokali i dytë nuk është në përdorim dhe në të ende ruhet pajisja policore.

Nga biseda me një person të mbajtur, MPN-ja mori informatë se bisedën dhe inspektimin inspektorët e kanë zbatuar në zyrat e tyre zyrtare, e jo në lokalet për bisedë me persona të privuar nga liria.

Nga biseda me udhëheqësin e turnit, MPN-ja mori informatë se respektohet e drejta e privatësisë kur personat e privuar nga liria e shfrytëzojnë tualetin, më saktë nëpunësi policor për shkak të sigurisë hyn në tualet, por është i vëmendshëm të mos e rrezikojë intimitetin dhe

privatësinë e personit të privuar nga liria.

Gjatë inspektimit në tualet, MPN-ja konstatoi se janë mënjanuar materialet dhe lëndët e rrezikshme, më saktë në tualet u mënjanua pasqyra, mbajtësi metalik për letrën e tualetit dhe zorra e dushit.

Gjatë vizitës së njëpasnjëshme në Stacionin Policor Gazi Babë, MPN-ja e kontrollloi zbatimin e rekomandimeve të dhëna për Ministrinë e Punëve të Brendshme, me ç'rast konstatoi se një pjesë të rekomandimeve Ministria i ka zbatuar, një pjesë janë zbatuar pjesërisht, kurse një pjesë nuk janë zbatuar.

MPN-ja përcaktoi se gjatë hyrjes në Stacionin Policor Gazi Babë është vendosur një barrierë e arritshme për personat me nevoja të veçanta, kurse gjendja me mbikëqyrje të videos (kamerat) nuk ka ndryshuar, sepse disa nga kamerat ishin në funksion, e disa jo.

Në lidhje me ajrosjen, MPN-ja përcaktoi se nuk është ndërmarrë asgjë nga MPB-ja për zbatimin e këtij rekomandimi, përkatësisht nuk është vendosur një sistem i veçantë për ajrosje në lokalet për mbajtje.

### 3.1.2. Stacioni Policor Koçanë

Mekanizmi Parandalues Nacional zbatoi vizitë të njëpasnjëshme në SP Koçanë i shoqëruar nga bashkëpunëtori i jashtëm, në pajtim me Memorandumin për bashkëpunim të nënshkruar ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj. Gjatë vizitës nuk hasi në persona të mbajtur, dhe për këtë shkak nuk pati mundësi të bisedojë për arsye të përcaktimit të veprimit nga nëpunësit policorë dhe kushteve për mbajtje në këtë stacion policor.

MPN-ja gjatë vizitës së njëpasnjëshme në SP Koçanë, përkatësisht inspektimit në lokalet për mbajtje konstatoi se gjendja në këto lokale është e pandryshuar, përkatësisht nuk është bërë dislokimi i lokaleve për mbajtje nga pjesa e bodrumit, që do të thotë se edhe më tutje shfrytëzohen lokalet e njëjta për mbajtjen e personave që janë të privuar nga liria.

Nga inspektimi në 4 dosjet individuale, MPN-ja konstatoi se këto mbahen me rregull, në pajtim me rekomandimet e dhëna paraprakisht. Nga inspektimi në disa dosje ku personat e mbajtur e kanë realizuar të drejtën e kontrollit nga mjeku, doli se në mënyrë përkatëse dhe me kohë është thirrur mjeku për shkak të sugjerimit të ndihmës së mjekut. Në procesverbalin për mbajtje të personit, është shënuar se cili mjek dhe në cilën periudhë kohore e ka bërë kontrollin e mjekut, mirëpo në përbërjen e dosjeve të njëjta nuk ishte përfshirë dokumentacioni mjekësor plotësues, prej ku mund të konstatohen konstatimet dhe gjendja nga kontrolli i kryer.

Në Evidencën për përdorimin e mjeteve për detyrim për vitin 2015, u shënuan 7 raste që qartë u arsyetuan, kurse evidenca ishte plotësuar me rregull dhe secila grafikë ishte plotësuar. U konstatua se për të gjitha lëndët ekziston Vlerësim për bazueshmërinë, arsyetimin dhe plotfuqishmërinë e përdorimit të mjeteve për detyrim, si dhe raport për përdorimin e mjeteve për detyrim, ku u konstatua rrjedha e plotë e ngjarjes. MPN-ja vërejti një shkallë të lartë të rregullshmërisë gjatë mbajtjes së këtyre lëndëve.

Gjithashtu, në asnjë dokument nuk ishte vërejtur përdorimi i ngjyrës së korrektorit, përkatësisht vendosja e të dhënave gabimisht ishte vizatuar me një vijë dhe ishte e lexueshme.

Gjatë vizitës së njëpasnjëshme, MPN-ja konstatoi se rekomandimet e dhëna për Ministrinë e Punëve të Brendshme nuk u zbatuan, me përjashtim të një rekomandimi. Edhe pse

në pajtim me Planin e veprimit ishte planifikuar që SP Koçanë të jetë në mesin e stacioneve të para policore për rinovim dhe rikonstrukcion, MPN-ja konstatoi se gjendja me lokalet për mbajtje nuk ka ndryshuar dhe lokalet e bodrumit shfrytëzohen për mbajtjen e personave që janë të privuar nga liria.

Në SP Koçanë në pajtim me rregullativën ligjore për delikuecën e të miturve, ende nuk është siguruar lokali i veçantë për mbajtjen e fëmijëve. Por, në përbërjen e stacionit policor është ndërtuar një lokal i veçantë për bisedë me fëmijët, që është donacion i UNICEF-it. Në lokal ka mbikëqyrje video dhe audio, qelq për njohje dhe derë të hyrjes mbrapa me qasje për personat me nevoja të veçanta. Lokali për bisedë me fëmijët është i pajisur në pajtim me nevojat dhe në të janë vendosur mobile me ngjyra të lehta, muret janë me ngjyra të lehta dhe lokali duket i ngrohtë dhe i këndshëm, përkatësisht nuk mund të shkaktojë stres plotësues gjatë bisedës me fëmijën.

MPN-ja konstatoi se në lokalet për mbajtje ende nuk ka të vendosur sistem, përmes të cilit personi i mbajtur do të mund lehtë të thërrasë dikë nga personat zyrtarë, e nëse ka nevojë urgjente personi i mbajtur do të trokasë fuqishëm në derën metalike të lokalit.

Sipas informatës së komandantit të SP Koçanë, stacioni policor disponon me buxhet për ushqimin e personave të mbajtur.

### **3.1.3. Stacioni Policor Prilep**

Vizitën në SP Prilep, MPN-ja e zbatoi i shoqëruar nga bashkëpunëtori i jashtëm i Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, në pajtim me Memorandumin për bashkëpunim të nënshkruar ndërmjet Avokatit të Popullit dhe shoqatës së emëruar.

MPN-ja konstatoi se në SP Prilep, në pajtim me rekomandimet e dhëna paraprakisht të drejtat e personave që janë të privuar nga liria janë të vendosura në vend të dukshëm dhe në disa gjuhë, në lokalet për pranim dhe marrje në pyetje të personave të mbajtur.

Gjatë inspektimit në tualet, ekipi i MPN-së konstatoi se higjiena nuk është në nivelin e duhur dhe nuk vërejtj mjetete për mirëmbajtjen e higjienës (sapun të lëngshëm dhe letër tualeti). Nga ana tjetër, MPN-ja konstatoi se me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve të mundshme nga lëndimi apo vetëlëndimi i personave që janë të privuar nga liria, në tualetet ishin mënjëuar sendet e rrezikshme (pasqyra, mbajtësi metalik për letrën e tualetit dhe zorra e dushit), përkatësisht është vepruar sipas rekomandimeve të dhëna paraprakisht.

Mekanizmi Parandalues Nacional, gjatë vizitës së njëpasnjëshme inspektoi në tërë dokumentacionin që mbahet për personin e mbajtur në procedurën policore, duke e përfshirë edhe procesverbalin për mbajtje, prej ku u konstatua se nuk ka ndërhyrje në asnjë nga kopjet indigo të procesverbalit për mbajtje.

Nga inspektimi në të gjitha dosjet individuale, doli se procesverbali për mbajtje ishte plotësuar në mënyrë përkatëse në pjesën e nevojës për mjek gjatë pranimit të personit. Në një dosje të kontrolluar, për një person të mbajtur për të cilin ishte konstatuar se ka nevojë për mjek, ishte thirrur mjeku dhe në dosje kishte shënim zyrtar të specialistit për udhëzimin dhe terapinë e përcaktuar.

Gjithashtu, në asnjë dokument nuk ishte vërejtur përdorimi i ngjyrës së korrekturës, përkatësisht futja e të dhënave gabimisht ishte vizatuar me një vijë dhe ishte e lexueshme.

Në bisedë me udhëheqësin e ndërrimit dhe personat tjerë zyrtarë, MPN-ja mori informatë se personat e mbajtur nuk vuajnë kolektivisht, por vendosen në lokale të veçanta, përveç në

raste të rralla ku kushtet teknike dhe reale nuk e lejojnë këtë. Në pajtim me informatat e marra nga udhëheqësi i turnit, nëse ka nevojë të bëhet kontrolli i hollësishtëm, ky bëhet në lokalit që nuk është në mbikëqyrje të videos.

MPN-ja mori informatë se SP Prilep disponon me depo për lëndët e marra përkohësisht, si dhe depo për armë të konfiskuara për të cilat nëpunësi kujdestar mban procesverbal/evidencë. MPN-ja nuk inspektoi në këtë lokal për shkak të pamundësisë të hapet, dhe si rrjedhojë nuk pati mundësi të kontrollohet nëse rekomandimi për deponimin përkatës dhe evidentimin e lëndëve të marra dhe armës së zjarrit, të dhënë në raportin e veçantë pas vizitës së kryer të rregullt është plotësuar.

MPN-ja, gjithashtu, vërejti se në hyrje të stacionit policor është ndërtuar një barriërë e arritshme, është zgjeruar edhe dera e hyrjes, me qëllim që të lehtësohet qasja e personave me nevoja të veçanta.

Në lidhje me rekomandimin e dorëzuar të MPB-ja për përmirësimin e mbikëqyrjes me video gjatë natës në lokalet për mbajtje, MPN-ja konstatoi se ky nuk është zbatuar. Nuk është zbatuar as rekomandimi që të sigurohet lokali i veçantë për mbajtjen e personave të mitur, e as që janë marrë masa për pajisjen teknike të lokalit për marrjen në pyetje të personave (kompjuteri, printeri, etj.).

Në momentin e vizitës, ekipi i MPN-së hasi një person të mbajtur, me të cilin bisedoi, me ç'rast u përcaktua se personi ishte arrestuar në ora 22:00 në ditën paraprake. Personi i mbajtur e informoi MPN-në se nëpunësit policorë mirë kanë vepruar me të, se është mësuar për të drejtat e tij në procedurën policore, me atë që i është sqaruar se përse është arrestuar dhe mbajtur dhe i kanë ofruar mundësi të thërrasë avokat. Njëkohësisht, gjatë kohës së qëndrimit në SP Prilep nuk u ballafaqua me kërcënime apo lëndime nga personat zyrtarë. Gjatë periudhës së mbajtjes, disa nëpunës policorë biseduan me të. Por, gjatë inspektimit në evidencë, u konstatua se personi ende nuk ishte evidentuar në librin e personave të arrestuar.

Në lidhje me mbrojtjen shëndetësore, MPN-ja mori informatë se ndihma mjekësore thirret me kërkesën e personit të mbajtur dhe me vlerësimin personal të nëpunësit policor, kurse në rast të shkaillës së lartë të alkoolizmit të personi i mbajtur, detyrimisht thirret mjeku me qëllim të sugjerimit me kohë të ndihmës së mjekut.

Ekipi i MPN-së inspektoi edhe në lokalet për mbajtje, me ç'rast konstatoi se higjiena nuk është në nivelin e duhur. Ishte matur temperatura prej 26°C, kurse lagështia arrinte 53%<sup>5</sup>. Në lokale kishte ajrosje të dobët dhe ndihej ajri i mbetur, kurse në lokalit e dytë kishte dritë të dobët ditore. Udhëheqësi i turit informoi se kamerat e sigurisë në lokalet për mbajtje nuk janë përfshirë gjatë natës. Tualeti ishte në gjendje të dobët higjienike, përkatësisht higjiena ishte në nivel të dobët dhe nuk kishte mjete për higjienë personale (sapun dhe letër tualeti).

### 3.2. Institucionet Ndëshkuese Përmirësuese

Gjatë vitit 2015 zbatuan u vizitat e njëpasnjëshme në 2 Institucione Ndëshkuese Përmirësuese: **Seksioni i Arrestit në INP Idrizovë dhe Burgun Tetovë.**

<sup>5</sup> Standardet e pranueshme për lagështi prej 20-60 % R.H

### **3.2.1. Seksioni i Arrestit INP Idrizovë**

Avokati i Popullit - Mekanizimi Parandalues Nacional e zbatoi vizitën e njëpasnjëshme në Seksionin e Arrestit në INP Idrizovë, i shoqëruar nga bashkëpunëtori i jashtëm i Shoqatës së Infermiereve, Mamive dhe Teknikëve të Republikës së Maqedonisë, në bazë të Memorandumit për bashkëpunim të lidhur paraprakisht.

Gjatë vizitës në Seksionin e Arrestit u vendosën 3 persona të dënuar me shëndet të dëmtuar, kurse 3 persona të dënuar u vendosën në klinikat tjera (njëri në Klinikën e Gastroentero-Hepatologjisë, njëri në ortopedi dhe njëri në Klinikën e Kardiologjisë). MPN-ja u informua se në seksionin e njëjtë është i angazhuar me punë një person i dënuar, si korrier, i cili shfrytëzon njërën ndër dhomat për vendosje .

Në pajtim me informatat e marra nga personi zyrtar që në momentin e vizitës ishte përgjegjës për Seksionin e Arrestit, prej INP Idrizovë rregullisht dorëzohen mjete për pastrim dhe për dezinfektim. Por, gjatë inspektimit në dhomat e fjetjes ku qëndrojnë personat e sëmurë që janë të dënuar, MPN-ja konstatoi se higjiena në lokalet e njëjta nuk është në nivelin e duhur.

Gjatë inspektimit MPN-ja konstatoi se krevatet nuk janë të pajisura me dyshekë, por me sfungjerë të rëndomtë, të cilat janë të mbështjella me çarçafë të papastër dhe të vjetër, me ç'rast në lokalin e parë kishte të vendosur 4 krevate, dritaret ishin të papastra, kurse në tualet ishte konstatuar lagështi e madhe e ajrit. Më tutje, në lokalin e dytë ku qëndronte një person i dënuar ishte vërejtur lagështi, kurse higjiena dhe kushtet materiale në lokal nuk ishin në nivelin e duhur.

Mekanizmi Parandalues Nacional, konstatoi se gjendja e konstatuar gjatë vizitës së rregullt dhe gjatë vizitës së njëpasnjëshme në lidhje me mirëmbajtjen e higjienës në lokale është e pandryshuar. Pra, në të gjitha lokalet, MPN-ja konstatoi nivel të ulët të higjienës, tualetet ishin të papastra, kurse muret e lokaleve ishin të dëmtuara dhe të palyera me gëlqere, edhe pse nga personi zyrtar ishte theksuar se është bërë lyrja me gëlqere e objektit.

Gjithashtu, nga biseda me personin zyrtar dhe personat e dënuar të vendosur në Seksionin e Arrestit, MPN-ja konstatoi se e drejta e qëndrimit në ambient të hapur ende nuk realizohet, andaj personat me sëmundje të caktuar mund të lëvizin vetëm në korridor, por jo edhe jashtë rrethit të Seksionit.

Seksioni i Arrestit disponon me automjet të vjetër për transport, i cili nuk i përmbush kushtet e nevojshme për transportin e personave të dënuar të sëmurë.

MPN-ja nga vizita konstatoi se në Seksion nuk ka mjek të angazhuar me punë, e as infermiere, kurse për rastet urgjente dhe sipas nevojës, vijnë mjekë nga klinikat, të cilët sipas nevojës u japin terapi ampulare dhe infuzion personave të dënuar, kurse në rastet serioze dhe urgjente, personat e dënuar dërgohen në klinikën përkatëse.

Duke e pasur parasysh gjendjen e tillë, MPN-ja konsideron se edhe pse mbrojtja shëndetësore, në pajtim me ndryshimet e Ligjit për kryerjen e sanksioneve është në kompetencë të institucioneve shëndetësore publike që ushtrojnë mbrojtje shëndetësore primare në zonën e së cilës gjendet institucioni ndëshkues përmirësues, kjo nuk e arsyeton mungesën e personelit mjekësor në seksion.

MPN-ja sugjeron se në Seksion duhet të ketë punëtor shëndetësor i cili do të jetë i ngarkuar për shëndetin e personave të dënuar në Seksionin e Arrestit, i cili do të ndihmojë gjatë organizimit të ekzaminimeve paraklinike të personave të dënuar të sëmurë, do të punojë në edukimin shëndetësor dhe zhvillimin e vetëdijes për higjienën personale, si dhe për izolimin e pacientëve me sëmundje.

Ekipi i MPN-së erdhi në përfundim se mungon evidenca për terapinë e përcaktuar që jepet në ditë për pacient dhe fletorja për pranimin e barnave, ku duhet të shënohet se cilin bar e ka marrë pacienti, në çfarë doze dhe kush e ka dhënë atë bar. Pra, në pajtim me informatat e marra, MPN-ja konstatoi se terapia në Seksion merret një herë në javë nga mjeku i cili përkujdeset për personat e dënuar në INP Idrizovë, megjithatë nuk e ka në formë të shkruar, përkatësisht mungon evidenca se cilat barna dhe cilët persona të dënuar i pranojnë në bazë ditore.

Personat që u hasën në Seksionin e Arrestit kishin ankesa për kushtet e këqija dhe kushtet materiale joadekuate dhe për kohën e lejuar për lëvizje, të cilën, si edhe gjatë vizitës së parë e shfrytëzojnë vetëm brenda në korridor, e jo edhe jashtë rrethit të Seksionit.

MPN-ja, gjithashtu, konstatoi se në lokale mungojnë dollapë të veçantë ku personat e dënuar do të mund t'i ruajnë sendet e tyre personale.

### 3.2.2. Burgu Tetovë

Avokati i Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional (MPN), gjatë vitit raportues zbatoi vizitë në Burgun Tetovë, së bashku me bashkëpunëtorët e jashtëm të Shoqatës së Psikiatërve dhe Shoqatës së Mjekësisë Ligjore. Vizita u zbatua në mënyrën që u formuan dy nënëkipe, të cilat inspektuan në seksionin e pranim, seksionin e mbyllur dhe seksionin e hapur, paraburgimin dhe ambulancën, por u kontrollua edhe evidenca profesionale, përkatësisht u inspektua në Librin për dënime disiplinore, Librin për evidencën e bastisjes së kryer, kontrollin e dosjeve profesionale, si dhe dokumentacionin mjekësor.

MPN-ja përcaktoi se gjatë vizitës në Burgun Tetovë ishin të pranishëm 83 persona të dënuar, prej të cilëve 9 të angazhuar me punë jashtë, 8 në fundjavë dhe 4 persona të dënuar në pushim vjetor, kurse në paraburgim ishin të pranishëm 17 persona.

Nga biseda me drejtorin e Burgut, MPN-ja mori informatë se institucioni me vite të tëra ka probleme me buxhetin, që ndikon në sigurimin e kushteve normale për qëndrimin e personave të paraburgosur dhe të dënuar.

Sipas informatave në periudhën e kaluar janë punësuar 2 persona, por edhe më tutje nuk ka plotësim të vendeve të punës në Sektorin e Sigurimit. U theksua se gjendja me kushtet materiale është identike, si edhe paraprakisht dhe se Burgu ka lokal për vizitat e personave të dënuar dhe këto realizohen jashtë në oborrin e Burgut.

Në Burg nuk ka mundësi për punëtori në të cilat do të realizohen aktivitetet ekonomike të instruktorëve, ndërsa nuk zbatohet as procesi arsimor.

Nuk ka përmirësim as në pjesën e rekomandimit që ishte dhënë për Drejtorinë për Kryerje të Sanksioneve për përmirësimin e kushteve në mensën e Burgut Tetovë, nëpërmjet sigurimit të numrit të mjaftueshëm të karrigeve, si dhe renovimin e sallës së TV-së. Drejtorja e Burgut e informoi MPN-në se personat e dënuar mund të angazhohen me punë jashtë institucionit, por për këtë vështirë se marrin pëlqim nga Drejtorja për Kryerje të Sanksioneve. Përndryshe, nga numri i përgjithshëm i personave të dënuar 29 ishin persona të kthyer, kurse 60 kryerës primarë.

Gjatë vizitës së njëpasnjëshme, MPN-ja inspektoi dhe bisedoi me personat në paraburgim në Pjesën e Paraburgimit, me ç'rast konstatoi se në pjesën e vjetër lokalet nuk janë të pastra dhe personat janë të vendosur në kushte substandarde. Edhe pse gjatë vizitës, temperatura e dhomave ishte në kufijtë e lejuar (temperatura 23 °C, si dhe lagështia 50%), përsëri personat në paraburgim u ankuan se lokali nuk ngrohet mjaft gjatë periudhës së dimrit.

MPN-ja konstatoi se një pjesë e lokaleve në pjesën e vjetër të paraburgimit nuk kanë



karrige, as sirtarë. Pjesa më e madhe e tyre janë të furnizuara me dyshekë të sfungjerit, në shumicën e lokaleve janë të dëmtuara sistemet për thirrje (zilet), kurse në muret ishte vërejtur sasi e madhe e lagështisë.

Nga inspektimi në pjesën e re të paraburgimit u vërejtën kushtet e mira, dyshemeja është e mbuluar me laminat, por edhe krevatet janë më të reja, mirëpo sërish mungojnë mjetet tjera ndihmëse për pushim dhe konsumim të ushqimit (tryeza, karrigia, etj.) Personat u ankuan në cilësinë e ushqimit.

Gjatë vizitës, MPN-ja nuk mori ankesa nga personat e vendosur në pjesën e paraburgimit, në lidhje me veprimin ndaj tyre nga Sektori i Sigurimit, e as në mënyrën se si zbatohet kontrolli i dhomave. Në këtë drejtim, MPN-ja konkludoi se rekomandimi i dhënë nga viti 2012 respektohet dhe nuk ekzistojnë ankesa për marrëdhënien jokorrekte, si edhe kërcënimet verbale ndaj personave në paraburgim.

MPN-ja konsideron se duhet të përmirësohen kushtet për vendosje dhe qëndrim në seksionin e paraburgimit nëpërmjet respektimit të standardeve dhe rekomandimeve minimale ndërkombëtare dhe vendore. Në këtë kontekst, lokalet duhet të kenë qasje të drejtpërdrejtë në ndriçimin ditor natyror, lagështia të zvogëlohet dhe në të gjitha lokalet të instalohet sistemi për thirrje (zilet me alarm). Tualeti duhet fizikisht të veçohet prej kapacitetit të vendosjes së lokalit të paraburgimit.

MPN-ja nuk konstaton ndryshime në lidhje me gjendjen e përcaktuar gjatë vizitës së rregullt, përkatësisht personat në paraburgim kanë mundësi për shëtitje prej një ore, kurse kohën e mbetur e kalojnë në lokalet e paraburgimit, dhe nuk janë të përfshirë në aktivitetet e përditshme të Burgut. Lokali për shëtitje është në rregull, por nuk ka pjesë të mbuluar e cila do të shfrytëzohej gjatë kushteve të këqija kohore.

Në vitin 2012, MPN-ja dha rekomandim që vendosja dhe pranimi i personave të dënuar të zbatohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për kryerje të sanksioneve, kurse seksioni i pranimi të mos shfrytëzohet edhe për vendosjen e kategorive tjera të personave të dënuar (persona që vuajnë dënimin disiplinor dhe trajtimin me burg), me qëllim të shmangies së infektimit kriminogjen të personat e dënuar të sapopranuar.

Gjatë vizitës së njëpasnjëshme, MPN-ja hasi në gjendjen e njëjtë, përkatësisht krahas personave që janë pranuar në Burg, në pjesën e pranimi ishte prezent një person të cilit i ishte shqiptuar masa e birucës. Mënyra e tillë e vendosjes, sipas vlerësimit të ekipit të MPN-së mund negativisht të ndikojë te personat e dënuar që janë të sapopranuar në Institucion. Nga biseda me personat e vendosur në seksionin e pranimi, MPN-ja mori informatë se të gjithë ishin kontrolluar nga mjeku në afatin e paraparë prej 24 orësh, kurse personat nuk patën vërejtje për marrëdhënien e të punësuarve të Sektorit të Sigurimit.

Gjatë vizitës, MPN-ja bëri matjen e lokaleve, me ç'rast përcaktoi se në lokalin e parë që është me sipërfaqe prej 14.4 m<sup>2</sup> u vendosën 6 persona të dënuar, që është nën standardet e dëshiruara prej 4 m<sup>2</sup> për person, kurse në lokalin e dytë u vendosën 2 persona. Gjatë bisedës me personat e dënuar, MPN-ja mori ankesë për cilësinë dhe sasinë e ushqimit, ndërsa mori informatë se personat e dënuar çarçafin e sigurojnë prej shtëpisë.

Nga inspektimi në dhomat në seksionin gjysmë të hapur/të hapur konstatohet se në to vendosen personat mbi maksimumin e lejuar të përcaktuar me Ligjin për kryerje të sanksioneve. Pra, në njërin lokal u vendosën 6 persona të dënuar, kurse madhësia e dhomës ishte 13.4 m<sup>2</sup>, në lokalin e dytë kishte 8 persona të dënuar në sipërfaqe prej 16.5 m<sup>2</sup>. Dhomat ishin të rregullta dhe të pastra, dhe në to kishte aparat të TV-së. Temperatura në dhoma ishte në kufijtë e përcaktuar, përkatësisht 22°C, kurse lagështia e ajrit 47%.

Si edhe paraprakisht, MPN-ja konstatoi se kapacitetet e vendosje it në këtë pjesë nuk

janë të mjaftueshme. Një pjesë e tyre u rinovuan dhe janë në gjendje të mirë, por në dhomat e vjetra është i domosdoshëm rekonstrukcioni i plotë.

Në bisedë me personat e dënuar nuk patën vërejtje në Sektorin e Sigurimit dhe në marrëdhënien e tyre, nuk u ankuan në përdorimin tej mase të forcës, as në dhunë ndërmjet personave të dënuar, nuk patën as vërejtje për marrëdhënien e Sektorit të Risocializimit dhe theksuan se çdoherë kanë mundësi të bisedojnë me ta.

Personat e dënuar dhanë vërejtje për ngrohjen e lokaleve gjatë periudhës së dimrit, për cilësinë e ushqimit, për këto shkaqe ushqimin e sigurojnë prej shtëpisë. Njëkohësisht u ankuan se nuk kanë mjaft barna, veçanërisht për sëmundjet kronike.

Sipas informatave, MPN-ja konstatoi se mbrojtja shëndetësore në Burgun Tetovë është e organizuar nga sektori shëndetësor, i përbërë prej 1 mjeku dhe 1 infermiereje. Mbrojtja shëndetësore është e arritshme 24 orë, me mjekun në thirrje. MPN-ja nga inspektimi në dokumentacion përcaktoi se të gjithë personat ishin kontrolluar gjatë pranimit në institucion, në afatin e përcaktuar ligjor prej 24 orësh.

Shumica e personave në paraburgim theksuan se u mundësohet mbrojtja shëndetësore themelore, por se mungon mbrojtja shëndetësore specialiste. Nga personat në paraburgim u morën edhe ankesa se ka mungesë barnash, veçanërisht për sëmundjet kronike dhe se shumica prej tyre vetë e blejnë terapinë medikamentoze.

MPN-ja i shënoi të gjitha ankesat, për çka për rastet e veçanta inspektoi në dokumentacionin mjekësor dhe bisedoi me mjekun dhe infermierën. Pastaj MPN-ja konstatoi se personeli mjekësor me rregull e kreu pjesën mjekësore dhe administrative të punës, por për joefikasitetin e shërbimit shëndetësor ndikon buxheti i pamjaftueshëm, si dhe statusi i tyre i padefinuar.

MPN-ja rekomandoi të ndërpritet praktika e vendosur afatgjate që të kursehet në buxhetin e sektorit shëndetësor.

MPN-ja përcaktoi se Burgu mundëson vetëm mbrojtjen shëndetësore themelore, dhe konstaton se ekziston zgjatja dhe mosrealizimi i procedurave diagnostike dhe terapeutike, që gjithashtu ka të bëjë me buxhetin e pamjaftueshëm shëndetësor. MPN-ja rekomandoi të sigurohet buxheti përkatës për mbrojtjen shëndetësore përkatëse të personave në paraburgim, duke i përfshirë edhe personat e sëmurë kronikë.

MPN-ja konstaton se respektohen të gjitha parimet e besueshmërisë së dokumentacionit mjekësor, si dhe besueshmërisë gjatë kontrollit. Nga dokumentacioni është e qartë se mbahet dokumentacioni shëndetësor përkatës, sikurse për rastet akute, ashtu edhe për nevojat e të sëmurëve kronikë.

MPN-ja inspektoi edhe në ambulancën në të cilën bëhen kontrollet, me ç'rast përcaktoi se kjo është e vogël dhe në të mungojnë: krevati i spitalit, perdja, aparati mobil për EKG-në, si dhe aparatet tjera mjekësore themelore me qëllim të bëhet kontrolli i përgjithshëm i personave të dënuar. Sektori shëndetësor në Burgun Tetovë disponon me aparat për matjen e shtypjes së gjakut, si dhe kompjuter në të cilin me rregull regjistrohet tërë dokumentacioni mjekësor. Dosjet mjekësore me rregull mbahen nga mjeku.

MPN-ja konkludoi se mjeku e njeh mirë gjendjen shëndetësore të secilit person të gjykuar, e në momentin e vizitës kishte tre persona që ishin me terapi metadone dhe ata çdo ditë e marrin dozën e përcaktuar. Mjeku theksoi se në burg gjendet mjeku specialist - psikiatër. Nga mjeku me rregull mbahet evidenca (ditarët për evidencën e sëmundjeve infektive, evidencën e personave të dënuar të lënduar dhe librin për rezultatet nga kontrolli i ushqimit dhe ujit që shfrytëzohet në Burg).

Nga inspektimi në dokumentacion, MPN-ja konstatoi se personat të cilëve u është shqiptuar dënim disiplinor qeli janë kontrolluar nga mjeku para dërgimit të tyre. Evidente në

dokumentacion ishte se për një person të dënuar, mjeku nuk ka dhënë pëlqim, për shkak që kjo masë disiplinore nuk ishte zbatuar.

Gjatë vizitës, MPN-ja hasi një person të moshës 73-vjeçare që qëndronte në seksionin e hapur dhe i cili për shkak të sëmundjeve kronike nuk mund të lëvizte. Nga inspektimi në dokumentacionin e tij mjekësor u vërtetua se janë marrë të gjitha masat, kurse nga mjeku për këtë rast është njoftuar gjykatësi në Gjykatën Themelore Gostivar dhe është kërkuar nga Gjykata që personi të transferohet në Qendrën Klinike. Pas kërkesës nuk është marrë përgjigje edhe pse ka kaluar një afat i gjatë kohor.

Bashkëpunëtorët e jashtëm të MPN-së, dhanë mendim se kushtet në Burg nuk janë përkatëse për mjekimin e atij personi dhe rekomandoi që personi të dërgohet në mjekim përkatës në spital.

Në këtë kontekst, MPN-ja i ka parasysh Rregullat Evropiane të Burgut, sipas të cilave, "të sëmurët e burgosur të cilëve u nevojitet mjekimi specialistik do të zhvendosen në institucione speciale apo spitalet e qytetit nëse nuk është e mundur që mjekimi i tillë të sigurohet në burg". Për këtë rast, MPN-ja hartoi shënim zyrtar, për çka Avokati i Popullit formoi lëndë për mbrojtjen e të drejtave të personit të dënuar.

Në lidhje me ushqimin, MPN-ja konstatoi se ky është me cilësi të dobët, nuk përmban proteina dhe se personave nën përkujdesje u jepet ushqimi i njëjlojshëm. Në kuzhinë punon një kuzhinier profesional me disa persona të dënuar të cilët i ndihmojnë në përgatitjen e ushqimit. MPN-ja përcaktoi se shqyrtimet mikrobiologjike bëhen vetëm te kuzhinieri, e jo edhe te personat tjerë të angazhuar në kuzhinë.

MPN-ja vlerësoi se në depo nevojitet të ndahen mjetet kimike të ushqimit, si dhe mjetet për ngrënie. Higjiena në kuzhinë, dhomë të ngrënies, si dhe në dhomat në të cilat qëndrojnë personat e dënuar ishte në nivelin e duhur, kurse Libri për kontroll të ushqimit mbahej me rregull.

Gjatë vizitës asnjë person i privuar nga liria nuk u ankua në mundimin apo veprimin johuman, por vërejtjet më të mëdha nga personat e dënuar u dhanë për kushtet e këqija materiale.

MPN-ja konsideron se nevojitet dislokimi i objektit, përkatësisht ndërtimi i objektit që do të disponojë me kushtet përkatëse për vendosje, punëtori, si dhe lokale për zbatimin e trajtimit individual dhe grupor. Në të duhet të ketë edhe lokal të veçantë për vizita, si dhe lokal për kontrollin e personave të dënuar.

MPN-ja rekomandoi që personat që vuajnë masën paraburgim të përfshihen më rregullisht në aktivitetet e punës, aktivitetet rekreative ditore dhe tjera.

Në pjesën e mbrojtjes shëndetësore nevojiten aparate të domosdoshme mjekësore pa dallim në cilën kompetencë është mbrojtja shëndetësore, zgjerimi i ambulancës, një herë në javë vizita nga psikiatri, si dhe vaksinimi kundër Hepatit B i tërë personelit dhe personave të dënuar.

Si edhe në raportet paraprake, MPN-ja thekson se nevojitet të rritet numri i kuadrove të përhershme të punësuar në Burgun Tetovë, në pajtim me aktin për sistematizim, në Sektorin e Sigurimit, si dhe punëtori social dhe edukuesit në Sektorin e Risocializimit.

### 3.3. Masat e marra dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna

Pas Raportit të veçantë të dorëzuar për vizitën e njëpasnjëshme të zbatuar në **SP Koçanë**, Mekanizmi Parandalues Nacional nuk mori përgjigje nga stacioni policor, por përgjigjja ishte dorëzuar prej Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ministria e Punëve të Brendshme e informoi MPN-në se rekomandimi për rregullimin e lokaleve të veçanta për mbajtjen e fëmijëve, përkatësisht për zbatimin e Planit të veprimit për rekonstrukcionin e stacioneve policore do të merret parasysh dhe do të realizohet në pajtim me mundësitë financiare. Ministria, gjithashtu, informon se në kornizat e projektit "Përforcimi i kapaciteteve të organeve kompetente për veprimin me personat e mbajtur dhe personat në paraburgim", që zbatohet nga Zyra Programore e Këshillit të Evropës në Shkup, në Stacionin Policor Koçanë janë pajisur 2 lokale për mbajtje, të pajisura me krevat, dyshek dhe çarçaf, si dhe tryezë dhe karrige të fiksuara.

Rekomandimi i MPN-së për vendosjen e sistemit për video dhe audio mbikëqyrje dhe sistemit për thirrje pjesërisht është zbatuar në SP Koçanë, sepse ka qenë i instaluar sistemi interfon për thirrjen e personit zyrtar. Ministria e Punëve të Brendshme, gjithashtu, e informon MPN-në se nëpërmjet Zyrës Programore të Këshillit të Evropës në Shkup, është zbatuar furnizimi i pajisjes në një zyre e cila do të shfrytëzohet për bisedë me personat e mbajtur.

**SP Prilep**, gjithashtu, nuk dorëzoi përgjigje me rastin e Raportit të veçantë, por te MPN-ja ishte dorëzuar përgjigjja prej Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ministria e informon MPN-në se vazhdimisht dhe me rregull mbahet evidenca për personat e mbajtur, kurse nga SP Prilep janë ndërmarrë aktivitete për përmirësimin e vazhdueshëm të higjienës në lokale. Në lidhje me rekomandimet e MPN-së për përmirësimin e sistemit për ajrosje dhe ndriçim të tri lokaleve të theksuara për mbajtje, janë marrë masat edhe nga SPB Manastir, prej ku është dorëzuar akt-kërkesë te Seksioni për Punë të Përbashkëta të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me të cilën është kërkuar marrja urgjente e masave për përmirësimin e gjendjes në lokalet për mbajtje. Me shkresën e njëjtë është kërkuar rregullimi edhe i sistemit për video mbikëqyrje të vendosur në lokalet për mbajtje, si dhe sigurimi i kompjuterit dhe prinetarit në lokalin për qëndrimin e personave të dënuar.

Sa ka të bëjë me gjendjet e konstatuara në **SP Gazi Babë**, MPN-ja nuk ka marrë përgjigje as nga stacioni policor, as nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Drejtoria për Kryerje të Sanksioneve dorëzoi përgjigje me kohë sipas rekomandimeve të Avokatit të Popullit - MPN-së të dhëna në Raportin e veçantë, për tejkalimin e gjendjeve negative të përcaktuara në **Seksionin e Arrestit – INP Idrizovë**, kurse nga Drejtoria e INP Idrizovë nuk është dorëzuar përgjigje.

Në lidhje me rekomandimin për rregullimin e materies ligjore dhe nënligjore për dhënien e mbrojtjes shëndetësore të personave të dënuar, Drejtoria e informoi MPN-në se me rregullativën e paraparë ligjore rregullohen shërbimet shëndetësore të personave të dënuar gjatë mjekimit në spital, gjatë qëndrimit në Seksionin e Arrestit që është në kornizat e Qendrës Klinike – Shkup dhe në të cilën qëndrojnë personat e dënuar që kanë nevojë për trajtim mjekësor. Drejtoria, gjithashtu, informon se planifikohet ndërtimi i një objekti të ri për të sëmurët që vuajnë dënimin me burg, i cili do të ndërtohet me mjetet dhe mbështetjen e Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, në kornizat e Projektit për rekonstrukcionin e institucioneve shëndetësore, që e realizon Ministria e Shëndetësisë.

Duke pasur parasysh se rekomandimi për sigurimin e resurseve njerëzore shtesë për funksionimin e papenguar të Seksionit të Arrestit nuk është në kompetencë të Drejtorisë, kjo e njoftoi MPN-në se nuk mund të veprjë me këtë rekomandim.

Sipas rekomandimit të caktohet punëtor shëndetësor, përkatësisht personal mjekësor i cili do të ngarkohet për shëndetin e personave të dënuar në Seksionin e Arrestit, Ministria e Shëndetësisë nuk ka vepruar, e as nuk ka dorëzuar përgjigje me rastin e Raportit të veçantë për vizitën e Seksionit të Arrestit.

Drejtorja për Kryerje të Sanksioneve, gjithashtu, dorëzoi përgjigje me kohë me rastin e Raportit të veçantë të Avokatit të Popullit – MPN-së për vizitën e Burgut Tetovë, kurse Drejtorja e Burgut Tetovë nuk dorëzoi përgjigje.

Drejtorja për Kryerje të Sanksioneve ka vepruar sipas rekomandimeve të MPN-së, për nevojat e personave të dënuar t'u jepet mundësia që me punë të angazhohen jashtë institucionit, ashtu që në vitin 2015 nga gjithsej 35 kërkesat e parashtruara, është dhënë pëlqimi për 31 kërkesa për angazhimin me punë jashtë institucionit.

Në lidhje me rekomandimin për renovimin e mensës dhe lokaleve tjera në pjesën e paraburgimit dhe pjesën e burgimit, Drejtorja informoi se kjo varet nga mjetet financiare, e nëse këto sigurohen, renovimi do të realizohet në periudhën e ardhshme.

Drejtorja për Kryerje të Sanksioneve, gjithashtu, e informoi MPN-në, se në Burgun Tetovë janë hartuar akte të reja për sistematizimin e vendeve të punës, me të cilat parashihet rritja minimale e vendeve të punës në Sektorin e Sigurimit, për çka është marrë pëlqimi nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës. Sipas Drejtorisë që të realizohet ky rekomandim nevojiten mjete plotësuese, dhe ky do të realizohet kur këto do të sigurohen. Konkretisht, Drejtorja për Kryerje të Sanksioneve e informoi MPN-në se në pajtim me Ligjin për shërbim në Armatën e Republikës së Maqedonisë, në rrjedhë është vlerësimi i nevojave për marrje të ushtarëve profesionalë nga Armata në Institucionet Ndëshkuese Përmirësuese dhe Institucionet Edukuese Përmirësuese, të cilëve u ka pushuar kontrata e punës që paraqet mundësi për rritjen e numrit të të punësuarve në Sektorin e Sigurimit në Burgun Tetovë.

### **3.4. Qendra e Pranimit të Azilkërkuesve**

Avokati i Popullit si Mekanizëm Parandalues Nacional (MPN), gjatë vitit 2015 zbatoi vizitë në Qendrën e Azilkërkuesve, si pjesë e aktiviteteve të planifikuara të Tuining Projektit në bashkëpunim me Ombudsmanin Austriak. Në vizitën mori pjesë bashkëpunëtori i jashtëm i Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe dy përfaqësuesve të Ombudsmanit Austriak.

Vizitën e njëpasnjëshme të Qendrës së Azilkërkuesve, MPN-ja e zbatoi në kornizat e mandatit dhe kompetencave që dalin prej Protokollit fakultativ në Konventë kundër torturës dhe veprimit apo ndëshkimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruar dhe Ligjit për Avokatin e Popullit.

Në pajtim me Ligjin për azil dhe mbrojtje të përkohshme, azilkërkuesi deri në miratimin e vendimit përfundimtar në procedurën për njohjen e së drejtës për azil, ka të drejtë të qëndrimit, vendosjes dhe përkujdesjes në Qendrën e Azilkërkuesve apo vend tjetër për vendosje të caktuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Gjithashtu, azilkërkuesi ka të drejtë të shërbimeve shëndetësore themelore, të drejtë të mbrojtjes sociale, punë vetëm në kornizat e Qendrës së Azilkërkuesve apo vend tjetër për vendosje të caktuar nga Ministria, të drejtë të kontakteve me Komisaratin e Lartë të Refugjatëve, si dhe me organizatat humanitare joqe-

veritare për shkak të sigurimit të ndihmës juridike.

Qendra është institucion publik, i vendosur me vendimin e Qeverisë së RM-së<sup>6</sup>, me qëllim të vendosje it, ushqimit, shërbimeve të punëve sociale, aktiviteteve kulturore argëtuese dhe aktiviteteve rekreative dhe shërbimeve tjera, në pajtim me standardet minimale për pranimin e azilkërkuessve, të përcaktuara me aktet ndërkombëtare, të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

Gjatë vizitës së zbatuar në vitin 2015, MPN-ja përcaktoi se Qendra e Azilkërkuessve e shfrytëzon vetëm ndërtesën e parë ku ka dhoma për vendosje, kurse ndërtesa e dytë i është dhënë në shfrytëzim Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në të vendosen personat me hyrje joligjore në Republikën e Maqedonisë, duke e pasur parasysh stërmbushjen e Qendrës së të Huajve në Gazi Babë.

Gjatë kohës së vizitave paraprake të kryera në vitin 2011 dhe vitin 2013, MPN-ja përcaktoi se ndërtesa e parë është rrënuar. Lokalet ishin të parregulluara dhe të papastra, në to ishte vërejtur sasi e madhe e lagështisë, kurse në një pjesë të lokaleve ishin thyer dritaret. Një pjesë e tualeteve ishin rrënuar plotësisht, të ndyra dhe jashtë përdorimit.

Në momentin e vizitës së MPN-së në Qendrën e Pranimit të Azilkërkuessve u regjistruan gjithsej 74 persona. Përndryshe, Qendra e Pranimit disponon me kapacitet prej 110 personave me mundësi të vendosen krevate shtesë në situata të jashtëzakonshme. Sipas informatave të marra, azilkërkuessit mbahen 2-3 apo 5 ditë para se ta lëshojnë Qendrën, përkatësisht shtetin, kurse kërkuessit që barten prej pikave kufitare mbesin më tepër ditë. MPN-ja konstatoi se në momentin e vizitës nuk ka stërmbushje të kapaciteteve.

### 3.4.1. Struktura e të punësuarve

Sipas të dhënave të marra numri i personave të punësuar në Qendrën e Pranimit është rritur në krahasim me vizitën në vitin 2011: 3 edukues – me punësim të përhershëm, 1 vullnetar dhe 1 i punësuar me kontratë në vepër. Të punësuarit në Qendrën e Pranimit kanë koordinim të përhershëm me organizatat civile për ndarjen e detyrave të veçanta të punës. Gjithashtu, në Qendër janë angazhuar personat – kërkuess të azilit që qëndrojnë në Qendër në bazë vullnetare. Praktikë e zakonshme e Qendrës është të angazhohen personat që nuk kanë mjete materiale dhe nuk duan të punojnë, me ç'rast marrin kompensim të caktuar mujor.

### 3.4.2. Kushtet materiale, trajtimi dhe veprimi

Gjatë vizitës, MPN-ja konstatoi se në Qendër meshkujt dhe femrat janë të ndarë në lokale të veçanta, përkatësisht kati i sipërm i ndërtesës që është në përdorim është rezervuar për meshkuj, kurse në katin e poshtëm të ndërtesës në njërin pjesë janë të vendosura femrat, në njërin pjesë janë të vendosura familjet dhe në njërin pjesë nënat vetëmbajtëse dhe të miturit e pashoqëruar.

MPN-ja mori informatë se pas arritjes në Qendrën e Pranimit të miturit e pashoqëruar vendosen në lokale të veçanta dhe menjëherë u vendoset kujdestari. Në ditën e vizitës në Qendrën e Azilkërkuessve qëndroi një person i mitur me lëndime të vogla në këmbë, i cili ishte i izoluar në lokal të veçantë.

MPN-ja inspektoi në lokalet e katit të parë në të cilat ishin të vendosur personat – kërkuess të azilit, me ç'rast konstatoi se lokali i parë ishte i dedikuar për tre persona, me 3 krevate, të pajisura me jastëkë, batanije dhe çarçafë të pastër. Dhomat ishin të rregulluara dhe nuk

<sup>6</sup> Vendim për themelim të institucionit publik për vendosjen e personave azilkërkuess, Nr.19-5620/1 ("Gazeta zyrtare e RM" nr.122/2007)

kishte lagështi. Tualetet e përbashkëta ishin të rinovuara dhe të pastra, por u vërejt se një pjesë e çezmave ishin të prishura dhe prej tyre rridhte ujë.

Në lokalin e dytë ku ekipi i MPN-së inspektoi, ishte i vendosur një familje. Dhoma dispononte me 4 krevate që ishin të pastra, të pajisura me jastëkë, batanije dhe çarçafë të pastër. MPN-ja përcaktoi se temperatura në dhomë ishte normale dhe në të nuk kishte lagështi. Dhoma disponon me lavaman – çezmë, tavolinë dhe dollap. Tualetet që janë të përbashkëta ishin të pastra, me atë që edhe në këtë pjesë çezmat ishin të prishura, gjë që sjell shpenzimin e pakontrolluar të ujit.

MPN-ja vërejt se secila dhomë e katit të parë të ndërtesës ka grila në dritare. Në pyetjen përse janë të vendosura grila, personi përgjegjës e informoi MPN-në se grilat janë të vendosura për shkak të sigurisë së nënave vetëmbajtëse, familjeve dhe fëmijëve të mitur që janë të vendosur në këtë pjesë të Qendrës.

Dhoma e vendosur në katin e dytë të ndërtesës disponon me 4 krevate dhe në të janë të vendosur 4 persona meshkuj të moshës madhore. MPN-ja përcaktoi se dhoma është e rregulluar, e pastër dhe i përmbush kushtet minimale për qëndrim. Dhoma disponon me frigorifer dhe lavaman - çezmë, kurse personat e shfrytëzojnë lokalin edhe për përgatitjen e ushqimit. Në lokal nuk ka prezencë të lagështisë. Tualetet në këtë pjesë të objektit ishin në gjendje të rregullt, të pastra me mangësitë e njëjta sikurse edhe në lokalet paraprahe.

MPN-ja inspektoi edhe në Qendrën e Edukimit, e cila është e përbashkët edhe për fëmijët, edhe për të rriturit. Në këtë Qendër ishin prezent përfaqësuesit e organizatave joqeveritare (LA STRADA) të cilët janë të detyruar për edukimin e personave që qëndrojnë në Qendrën e Pranimit të Azilkërkuesve.

Nga inspektimi i kryer në lokalin për fëmijë (kopsht), MPN-ja përcaktoi se fëmijët e vendosur në Qendër mund këtë lokal ta shfrytëzojnë disa orë në ditë, në periudhën kohore prej orës 10:00 deri në orën 13:00. Ky lokal është i pajisur me lodra për fëmijë, që është donacion i fondacionit JRS.

Nga biseda me personat që janë kërkues të azilit, MPN-ja mori informatë se këta persona rregullisht marrin mjete/pako për higjienën personale dhe se janë të kënaqur nga kushtet në Qendrën e Pranimit, si dhe nga ushqimi që u sigurohet gjatë kohës së qëndrimit. Sipas nevojës dhe sipas kërkesës së personave, mund të merret pako plotësuese për higjienën personale. Çarçafët rregullisht ndërrohen dhe pastrohen nga personeli në Qendër, kurse Azilkërkuesit kanë në dispozicion makinën për pastrimin e rrobave dhe makinën për tharjen e rrobave.

MPN-ja përcaktoi se sistemi i ankesave funksionon në atë mënyrë që ankesat me shkrim dorëzohen te drejtori i Qendrës apo te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Ankesat duhet të parashtrihen me shkrim, kurse kjo mundësi thuhet se nuk shfrytëzohet nga azilkërkuesit .

MPN-ja vërejt se të drejtat e azilkërkuesve janë të përkthyer në 9 gjuhë, kurse rendi shtëpiak është përkthyer në disa gjuhë – arabisht, anglisht dhe frëngjisht.

### **Kuzhina dhe ushqimi**

MPN-ja inspektoi në kuzhinën e kësaj Qendre, me ç'rast konstatoi se kuzhina është rinovuar, e rregulluar dhe e pastër në pajtim me standardet e nevojshme. MPN-ja konkludoi se kushtet higjienike në kuzhinë janë të mira dhe i përmbushin standardet e përcaktuara.

Pasi vizita e MPN-së u zhvillua në kohën e agjërimit të Ramazanit, nga të punësuarit ishte thënë se për këtë periudhë ushqimi është organizuar sipas rregullit të agjërimit dhe kërkesave të personave që janë të vendosur në Qendër, me atë që ushqimi ndahet pas orës 19:00 dhe në ora 03:00 apo 04:00 në mëngjes. Furnizues i ushqimit është kompania që kryen furnizimin e ushqimit në formë të shërbimit catering.

### 3.4.3. Mbrojtja shëndetësore

MPN-ja konstatoi se gjatë ardhjes në Qendër, azilkërkuesve u bëhet kontrolli nga mjeku me qëllim që të parandalohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse. Kontrolli bëhet nëpërmjet kontrollimit të lëndimeve të dukshme dhe shenjave për lëndime dhe infektive, që mund të përcaktohen nga mjeku. Personat që barten prej Qendrës së të Huajve në Gazi Babë janë të kontrolluar nga mjeku i cili është prezent në atë Qendër. Në situata të tilla bartet edhe dokumentacioni mjekësor i kërkuesit.

MPN-ja mori informata se në repartin e ambulancës, mjeku është prezent së paku 2 herë në javë, kurse infermierja është e pranishme së paku 3 herë në javë nga disa orë. Sipas nevojës mjeku është i arritshëm 24 orë për situata urgjente. Në rast të nevojës, azilkërkuesit kanë mundësi për ndërhyrje klinike mjekësore. Ambulanca është e pajisur me barna të nevojshme për ndërhyrjet kryesore. Në periudhën e fundit janë vërejtur vizitat e shtuara nga Sektori për Shëndet Publik, duke e pasur parasysh numrin e shtuar të azilkërkuesve që vendosen në Qendrën e Azilkërkuesve.

### 3.4.4. Inspektimi në evidencë

Qendra e Azilkërkuesve disponon me program softuerik për mbajtjen e evidencës së personave që qëndrojnë në Qendër. Ky program softuerik shfrytëzohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra e Pranimit të Azilkërkuesve dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Të gjithë azilkërkuesit janë të regjistruar dhe të fotografuar, të cilëve u lëshohen legjitimacione për qëndrim në Qendrën e Pranimit.

MPN-ja konstaton se lista e personave të pranishëm në Qendër përditësohet në bazë ditore me qëllim të përcaktimit të numrit të saktë të personave të vendosur në këtë Qendër.

Qendra e Azilkërkuesve ka hartuar broshurë për rendin shtëpiak të përkthyer në gjuhën angleze, frënge dhe arabe e cila është e arritshme për kërkuesit.

### 3.4.5. Veprimi sipas rekomandimeve të dhëna

MPN-ja përcaktoi se Qendra e Azilkërkuesve është rinovuar dhe ripërtërirë, me çka kushtet për qëndrim dukshëm janë përmirësuar në krahasim me gjendjen që ishte hasur gjatë vizitës së rregullt në vitin 2011, për çka u dhanë disa rekomandime, si edhe gjatë vizitës së njëpasnjëshme në vitin 2013.

Gjendja e tillë e Qendrës i përmbush standardet themelore dhe minimum kriteret për vendosjen e azilkërkuesve në këtë institucion.

MPN-ja konstatoi siguri të pamjaftueshme të personave të akomoduar, dhe për këtë shkak gjatë vizitës kërkoi nga Drejtoria të angazhohet edhe person i cili do të kryejë mbrojtje dhe mbikëqyrje plotësuese për femrat dhe fëmijët. Personi përgjegjës i Qendrës, e informoi MPN-në se Drejtoria nga organet kompetente ka kërkuar mjete për angazhimin e rojtarëve plotësues.

Në drejtim të mirëmbajtjes së vazhdueshme të higjienës ishte marrë informatë se në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale çdo të hënë do të zbatohet pasttrimi i përgjithshëm dhe dezinfektimi i ndërtesës, që të parandalohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse në mesin e azilkërkuesve që janë të vendosur në këtë Qendër.

Gjatë kësaj vizite, MPN-ja konstatoi se janë përmirësuar kushtet për vendosje, higjiena rregullisht mirëmbahet, kurse azilkërkuesit ishin të kënaqur dhe nuk kishte ankesa për tra-



jtimin, përkatësisht veprimin ndaj tyre.

Gjithashtu, MPN-ja përcaktoi se është përforcuar bashkëpunimi me sektorin civil, nëpërmjet të cilit sigurohet ndihma juridike falas, arsimi dhe aktivitetet edukuese për fëmijë.



# VIZITA TË JASHTËZAKONSHME NË VITIN 2015

## 4.1. QENDRA PËR PRANIMIN E TË HUAJVE

Gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të jashtëzakonshme në Qendrën për Pranimin e të Huajve në Gazi Babë, me qëllim që të përcaktojë nëse janë ndërmarrë masat sipas rekomandimeve të dhëna në raportet nga vizitat e realizuara në vitin 2014. Vizita e jashtëzakonshme u realizua me qëllim që të përcaktohet gjendje momentale në Qendër.

Gjatë vizitës MPN-ja përcaktoi se në Qendrën për Pranim janë strehuar 160 burra, 22 gra dhe 4 fëmijë, përkatësisht objekti është i stërmbushur. Mekanizmi Parandalues Nacional u informua se planifikohet që në të ardhmen gratë dhe fëmijët të cilët janë të strehuar në Qendrën për Pranimin e të Huajve, të zhvendosen në një objekt i cili është në afërsi të Qendrës për Azilkërkues në Vizbeg.

Vendimi i tillë është marrë duke i pasur parasysh rekomandimet e Rezolutës 2020 (2014) nga 03.10.2014 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, me të cilën është rekomanduar parandalimi i mbajtjes dhe privimit nga liria të fëmijëve - emigrant ilegal dhe gjetja e modeleve alternative të qëndrimit që do të jenë në drejtim të interesit më të mirë të fëmijës.

Gjatë vizitës së parë të Qendrës, MPN-ja konstatoi se personave të strehuar në Qendrën për Pranimin e të Huajve nuk ju sigurohet mbrojtje e përditshme shëndetësore. Nga ana tjetër në Rregulloren e Rendit shtëpiak të Qendrës për Pranim parashihet që „kontrolli mjekësor i detyrueshëm i personit gjatë pranimit të tij në qendër të realizohet në afat prej 24 orëve pas pranimit”, ndërsa standardet ndërkombëtare kërkojnë „mbrojtje mjekësore në kohë, veçanërisht për personat të cilët janë viktimë e torturës, abuzimeve seksuale, si dhe formave të tjera të keqtrajtimit psikologjik dhe psikik”.

Gjatë vizitës në vitin 2015, MPN-ja përcaktoi përmirësim të mbrojtjes shëndetësore të emigrantëve, përkatësisht u informua se çdo ditë angazhohet një mjek i cili është nga Siria dhe kryen kontrolle në periudhën nga ora 10 deri në orën 15. MPN-ja shënoi se personat e sapopranuar kontrollohen rregullisht dhe në kohë nga mjeku, por prapë se prapë një pjesë e ankesave të emigrantëve kishin të bëjnë me cilësinë e mbrojtjes shëndetësore të cilën e pranojnë, ndërsa disa prej tyre u ankuan se vetë i sigurojnë medikamentet e nevojshme. MPN-ja u informua nga ana e mjekut se ai ka në dispozicion mjaft medikamente, ndërsa nëse emigrantët kanë nevojë për kontrolle specialistike ai i dërgon në klinikën përkatëse.

Gjatë shqyrtimit të ditarit të ambulancës MPN-ja përcaktoi se mjeku e ka njoftuar drejtorin e Qendrës se një person me plagë në këmbë duhet urgjentisht të operohet, ndërsa gjithashtu nga këqyrja në dokumentim u konstatua se mungojnë dokumente nga kontrolli specialistik për një person i cili është kontrolluar në Klinikën e Urologjisë, me shpjegim se dokumentet mund të sigurohen nga Sektori i Sigurimit, pasi që personat të cilët dërgohen në kontrolle specialistike dërgohen me shoqërim të Sektorit të Sigurimit. Në praktikë, mjeku e shoqëron pacientin vetëm



nëse personi nuk e flet gjuhën angleze, përkatësisht kur kanë nevojë për përkthim.

Kontrollet shëndetësore janë të regjistruara në Librin e kontrolleve, por MPN-ja e konsideron të domosdoshëm faktin që për çdo pacient të mbahet një dosje e veçantë shëndetësore që do të përmbajë historinë shëndetësore të individëve, së bashku me mendimet specialiste, në përputhje me respektimin e besueshmërisë mjekësore.

Sipas MPN-së, është e nevojshme për të përmirësuar qasjen te mjeku, përkatësisht nevojitet që mjeku të kryejë vizitë të përditshme në kapacitetet për vendosje dhe të evidentojë personat të cilët kanë nevojë për mjekun, edhe pse u konstatua se gratë dhe fëmijët mund të kërkojnë në çdo kohë kryerje të kontrollit (për shkak të afërsisë së ambulancës me pjesën ku janë të vendosur).

Një pjesë e emigrantëve u ankuan se nuk mund të realizojnë të drejtën për azil, ndërsa nga drejtorja u theksua se qasja në procedurën për njohjen e të drejtës për azil kushtëzohet me marrjen e lejes nga prokurori kompetent publik.

Gjatë këqyrjes në Librin e ngjarjeve të ditës, MPN-ja arriti në përfundim se emigrantët gojarisht parashtrajnë kërkesë për azil, por nga bisedimi me këta persona u informua se ata presin një periudhë të gjatë për t'u zhvendosur në Qendrën për Azilkërkues në Vizbeg. Për shkak të qëndrimit të gjatë dhe kushteve të këqija 100 persona kanë filluar grevë urie, ndërsa MPN-ja menjëherë sugjeroi që mjeku çdo ditë të monitorojë gjendjen shëndetësore të grevistëve. MPN-ja konstatoi se greva si një ngjarje është e evidentuar në Librin e ngjarjeve të ditës.

Edhe pse ekipi i MPN-së nuk ka marrë asnjë ankesë nga personat e vendosur për trajtim çnjerëzor ndaj tyre, nga mjeku u tha se ai ishte në dijeni se disa njerëz janë ankuar që janë goditur nga persona zyrtarë. MPN-ja realizoi intervistë me personat të cilët ishin në grevë dhe nga ata nuk kishte ankesa për dhunë, përkatësisht maltretim nga persona zyrtarë.

Emigrantët u ankuan se liria e lëvizjes është e kufizuar dhe nuk mund të dalin jashtë për një shëtitje. Si në vizitat e mëparshme, MPN-ja arriti në përfundim se e drejta për shëtitje nuk realizohet, përkatësisht nuk zbatohet dispozita për sigurim të shëtitjes, përkatësisht nuk zbatohet dispozita për sigurim të shëtitjes jashtë në të hapur dy herë gjatë ditës nga një orë, ose gjithsej dy orë, për shkak se objekti nuk është i rrethuar në mënyrë të sigurt dhe nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të ushtruar këtë të drejtë për të gjithë personat e strehuar në Qendër. Sipas njohurive, gratë lejohet të shëtisin vetëm 10 minuta, ndërsa burrat aspak nuk lejohen të shëtisin në ajër të pastër.

Emigrantët u ankuan për kushtet e strehimit. Kushtet në pjesën e meshkujve janë të pandryshuara, përkatësisht edhe më tutje shumica e njerëzve flenë në tokë dhe në thasë gjumi.

MPN-ja konstatoi se në Qendër janë ndërmarrë masa për përmirësimin e kushteve ku gratë qëndrojnë shkurt, por sipas informatave të pranuar shpeshherë në tualetet nuk ka ujë, ndërsa dushet janë jashtë përdorimit.

MPN-ja u njoftua se nuk ekziston regjim i veçantë i të ushqyerit për personat e sëmurë nga diabeti, ndërsa kishte ankesa për cilësinë dhe sasinë e ushqimit.

#### 4.1.1. Të vepruarit sipas rekomandimeve të dhëna

Mekanizmi Parandalues Nacional dorëzoi informatë në Ministrinë e Punëve të Brendshme për vizitën e Qendrës për Pranimin e të Huajve dhe kërkoi që Ministria të ndërmerr masa që kanë për qëllim sigurimin e kushteve të përshtatshme për strehimin e emigrantëve ilegal në Qendër (kërkoi dislokimin e Qendrës për të Huajt), por edhe koordinim me organet kompetente në mënyrë që të realizohet e drejta e azilit për personat të cilët kanë parashtruar kërkesë.

Lidhur me rekomandimin për të përshpejtuar procedurat për qasje te e drejta për azil, Ministria e Punëve të Brendshme e informoi Mekanizmin Parandalues Nacional se planifikohet takim me përfaqësuesit e Prokurorisë Themelore Publike për të përshpejtuar përpunimin e kërkesave për azil të emigrantëve ilegalë.

Rekomandimi i MPN-së për të përmirësuar kushtet e qëndrimit dhe strehimit të emigrantëve u pranua dhe në këtë aspekt, Ministria u obligua të marrë masa për të gjetur objekt të ri dhe të përshtatshëm me kapacitet më të madh për strehim të emigrantëve.

Gjithashtu, Ministria e Punëve të Brendshme e informoi MPN-në se në bashkëpunim me ministrinë tjera kompetente dhe organizatat joqeveritare, janë bërë përpjekje për të gjetur zgjidhje alternative për akomodimin e grupeve në nevojë, veçanërisht të fëmijëve, siç rekomandohet nga Rezoluta 2020 (2014) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, ndërsa njëherësh janë planifikuar trajnime për stafin që merret me këta persona.

Në lidhje me rekomandimin për qasje në mbrojtjen shëndetësore, Ministria ka kërkuar që Qendra për Pranimin e të Huajve tërësisht t'i pranojë rekomandimet për përmirësimin e mbrojtjes shëndetësore, ndërsa në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor dhe Qendrën për Shëndet Publik ka kryer kontroll inspektimi dhe kontroll higjienik-sanitar. Njëkohësisht, janë kryer kontrole shëndetësore të personave të vendosur nga ana e mjekëve specialist, me ç'rast nuk është konstatuar prani e patologjisë akute dhe aktive infektuese, e as ekzistimi i sëmundjeve të lëkurës në mesin e emigrantëve.

## 4.2. Stacionet policore

### 4.2.1. Stacioni policor Kisella Vodë

Pas marrjes së informatave mbi personat e arrestuar në protestën e mbajtur në maj para Qeverisë së RM-së, si dhe pas informatave nga mediet mbi brutalitetin e policisë, ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional realizoi vizitë të jashtëzakonshme në SP Gazi Babë, SP Kisella Vodë, SP Qendër dhe SP Karposh. Gjatë vizitës konstatoi se në SP Kisella Vodë janë arrestuar 10 persona të cilët janë mbajtur me dyshimin për kryerje të veprës penale sipas nenit 384 të Kodit Penal „pjesëmarrje në turmë që do të pengojë personin zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare” dhe një person për „sulm ndaj personit zyrtar”.

Nga biseda me personat është konstatuar se nuk ka vërejtje në lidhje me nëpunësit policorë, ndërsa personat kanë deklaruar se ata janë të pajisur me ujë dhe ushqim gjatë mbajtjes së tyre. Personat e mbajtur u ankuan për sjelljen e forcave speciale të policisë gjatë arrestimit,

përkatësisht theksuan se ndaj tyre është përdorur forcë dhe mjet detyrimi. Shumica e personave të mbajtur e informuan MPN-në që nuk e dinë arsyen e mbajtjes.

Këto pohimet MPN-ja i ka kontrolluar duke shqyrtuar dokumentacionin, me ç'rast ka konstatuar se për të gjithë personat e arrestuar janë përpiluar procesverbale për mbajtje me dyshim për vepër penale „pjesëmarrje në turmë“. Procesverbalet për mbajtje ishin të nënshkruar në mënyrë të rregullt nga personat e mbajtur, ndërsa disa prej tyre kishin përdorur të drejtën për avokat.

MPN-ja konstatoi se është ofruar ndihmë përkatëse mjekësore për personat të cilët kishin nevojë për ndërhyrje, ndërsa një personi i cili ka pasur probleme psikike dhe ka qenë në gjendje të dehur i është siguruar ndihmë mjekësore në Klinikën e Toksikologjisë. Nga biseda me një person të mbajtur, MPN-ja ka marrë informatë se një personi i cili vuan nga diabeti nga ana e zyrtarëve i është mundësuar ndihmë mjekësore, përkatësisht i është siguruar terapi mjekësore dhe është kërkuar ndihmë mjekësore për aplikimin e terapisë.

MPN-ja ka kryer kontroll në lokale dhe ka konstatuar se lokalet janë të pastra dhe të rregulluara, personat posedojnë çarçafë të pastra dhe në të njëjtat kishte ajrosje përkatëse.

#### **4.2.2. Stacioni policor Gazi Babë**

Gjatë një vizite të jashtëzakonshëm në SP Gazi Babë MPN-ja ka konstatuar se ka 17 persona të arrestuar, njëri prej të cilëve gjatë bisedës u dërgua në spitalin klinik. Gjatë bisedës së realizuar me 16 persona të cilët ishin të vendosur në sallën për takime, MPN-ja pranoi ankesa se ata ishin duke u trajtuar në mënyrë çnjerëzore dhe u ankuan ndaj brutalitetit policor gjatë arrestimit të tyre. Personat e arrestuar deklaruan se nëpunësit policor në SP Gazi Babë kishin një sjellje korrekte me ta dhe u kanë lejuar që ata të ushtrorjnë të drejtën e tyre për të kontaktuar prindërit dhe avokatët. Personat e arrestuar u ankuan se gjithë mbrëmjen e kanë kaluar në sallën për sigurim, ndërsa në pyetjen e MPN-së për arsyet e këtij veprimi, kujdestari dha një shpjegim se strehimi kolektiv është kryer me qëllim që mos të shkaktohet pabarazi midis personave të arrestuar.

Disa të arrestuar në mënyrë plotësuese e informuan MPN-në se atyre nuk u është dorëzuar kopje e procesverbalit nga mbajtja, për shkak se në stacionin e policisë nuk kishte letër.

Në këtë drejtim MPN-ja tregoi se sipas procedurave standarde duhet që personit të mbajtur t'i dorëzohet ky procesverbal pasi të mbarojnë arsyet për mbajtje.

Gjatë këqyrjes në evidencë MPN-ja konstatoi se personave të cilët kanë pasur nevojë u është mundësuar thirrje e mjekut, avokatit dhe realizimi i të drejtave të tjera të parashikuara. Megjithatë, mbetet vërejtja e MPN-së për mënyrën e papërshtatshme të vendosjes, përkatësisht strehimit në grup në sallën e mbledhjeve, si dhe vërejtjet për realizimin e bisedimeve me personat e arrestuar në zyrat e inspektorëve.

## VIZITA TË QENDRAVE TË PËRKOHSHME TRANSITORE

Gjatë muajit qershor të vitit 2015 numri i emigrantëve/refugjatëve që tranzituan nëpërmjet Republikës së Maqedonisë në vendet e Evropës perëndimore, shënoi rritje në mënyrë të konsiderueshme. Fluksi i zmadhuar i emigrantëve/refugjatëve krijoi nevojë për ndërtimin e qendrave të përkohshme transitorë për pranim, në mënyrë që në kalimin kufitar të kufirit greko-maqedonas të ndërtohet Qendra e Përkohshme Transitorë „Vinojug“, ndërsa në kufirin maqedonas-serb Qendra e Përkohshme Transitorë „Tabanocë“. Pothujase, njëkohësisht u miratua Ligji për ndryshimin e Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme, me të cilin filloi regjistrimi i emigrantëve dhe të njëjtëve u dha mundësia për të shprehur synimin për kërkim të njohjes së azilit. Me Ligjin për azil dhe mbrojtje të përkohshme të huajve atyre ju dha mundësia për të qëndruar në mënyrë të ligjshme në Republikën e Maqedonisë brenda 72 orëve, me çka nëse nuk parashtrajnë kërkesë për njohjen e së drejtës së azilit detyrimisht duhet të largohen nga vendi.

Avokati i Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional gjatë vitit 2015 realizoi disa vizita, përkatësisht monitoroi kushtet për pranim dhe trajtim të emigrantëve dhe refugjatëve në Qendrën e Përkohshme Transitorë „Vinojug“ - Gjevgjeli dhe në Qendrën e Përkohshme Transitorë „Tabanocë“ në kufirin me Republikën e Serbisë. Vizitat janë bërë në përputhje me kompetencat e Ligjit për Avokatin e Popullit dhe në bazë të mandatit të Mekanizmit Parandalues Nacional (MPN), i themeluar nga Protokollin fakultativ i Konventës kundër torturës dhe trajtimeve tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese dhe llojeve tjera të trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

Qëllimi i vizitave ishte që nëpërmjet inspektimit të kushteve materiale në qendrat e përkohshme për strehim të emigrantëve/refugjatëve dhe trajtimit të kësaj kategorie të njerëzve të shihet realizimi i të drejtave të tyre të garantuara nga ligjet kombëtare dhe aktet ndërkombëtare, në veçanti Konventa e Gjenevës mbi Statusin e Refugjatëve të vitit 1951 dhe të identifikohen rreziqet me qëllim që të parandalohet tortura dhe trajtimi tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtëruese ose dënimi.

Disa nga vizitat u realizuan si vizita të përbashkëta me Ombudsmanët e vendeve të rajonit dhe mekanizmat e tyre parandalues nacional, me ç'rast u shkëmbyen përvoja për mënyrën e pranimit dhe trajtimin e emigrantëve dhe refugjatëve në vendet tjera të cilat janë në rrugën e transitit dhe njëkohësisht vizitat e tilla kontribuan në forcimin e bashkëpunimit të institucioneve të Ombudsmanëve, përkatësisht të mekanizmave parandalues nacional për çështje që kanë të bëjnë me emigrantët/refugjatët.

Ekipet e Avokatit të Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional kontrolluan kushtet materiale dhe kapacitetet strehuese, zhvilluan bisedime me personat përgjegjës të Qendrave dhe realizuan takime të drejtpërdrejta dhe bisedime me emigrantët/refugjatët të cilët u pranuan dhe u vendosën në këto Qendra gjatë kohës së vizitave.



## **5.1. QENDRA E PËRKOHSHME TRANSITORE „VINOJUG“ - GJEVGJELI**

Vizitën e parë të Qendrës së Përkohshme Transitore „Vinojug“ - Gjevgjeli Avokati i Popullit-Mekanizmi Parandalues Nacional e realizoi në muajin shtator 2015, së bashku me përfaqësuesit e UNHCR-së, me çka pasuan edhe tre vizita tjera. Është realizuar vizitë e përbashkët e Avokatit të Popullit-Mekanizmi Parandalues Nacional me Delegacionin e udhëhequr nga Ushtruesi i detyrës Ombudsman në Republikën e Greqisë (u vizitua edhe kampi i refugjatëve në Indomeni - Republika e Greqisë), pastaj është realizuar vizitë së bashku me Ombudsmanin e Austrisë dhe Shefin e Zyrës së UNHCR-së në Republikën e Maqedonisë dhe në muajin dhjetor ekipi i MPN-së realizoi vizitë me Ombudsmanin për Fëmijë të Holandës i cili njëkohësisht kryeson me Rrjetin Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë - ENOK dhe me përfaqësuesit e Fshatit të Fëmijëve SOS të Maqedonisë dhe Fshatit të Fëmijëve SOS të Holandës.

### **5.1.1. Menaxhimi dhe organizimi në Qendrën e Përkohshme Transitore „Vinojug“**

Avokati i Popullit-MPN-ja gjatë vizitave zhvilloi bisedime me përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme- Qendra Rajonale për Punë Kufitare Jug, përkatësisht me Drejtorin e Qendrës së Përkohshme Transitore dhe zëvendësin e tij, me drejtorin e Qendrës për Menaxhim me Kriza, me përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, me përfaqësuesit e UNHCR-së dhe Kryqit të Kuq të RM-së.

Për çështjet që kanë të bëjnë me procedurat për organizimin e pranimin të emigrantëve dhe me institucionet dhe organizatat përgjegjëse për organizimin e pranimin, regjistrimin dhe trajtimin e emigrantëve, Avokati i Popullit-MPN-ja është njoftuar se jo vetëm që nuk janë miratuar procedurat standarde operative sipas të cilave do të zhvillohen aktivitetet në Qendër, por nuk është e përcaktuar në mënyrë të qartë se kush menaxhon Qendrën e Pranim, përkatësisht nëse ajo është në kompetencë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të sektorit joqeveritar, apo me Qendrën menaxhon Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ose Qendra për Menaxhim me kriza.

### 5.1.2. Kushtet materiale për qëndrim në Qendrën e Përkohshme Transitore „Vinojug“

Gjatë vizitave, Avokati i Popullit-MPN-ja konstatoi se emigrantët nga kalimi kufitar ilegal me Republikën e Greqisë (kuota 59) në Qendrën e Përkohshme Transitore „Vinojug“ arrijnë në këmbë, ndërkaq ajo është e distancuar rreth një kilometër. MPN-ja vuri në dukje se rruga nga vendkalimit kufitar deri në Qendër është e pandriçuar, e parregullt dhe e vështirë për të transferuar persona në karrige për invalidë. Higjiena nuk është e siguruar, përveç dy kontejnerëve, nuk ka shporta për mbeturina, përreth është grumbulluar çfarëdo qoftë mbeturine dhe hapësira i ngjan një depoje të madhe.

Lidhur me këtë problem, MPN-ja u informua se nuk janë siguruar mjete për pastrimin e mbeturinave dhe se pushteti lokal ka kërkuar por nuk ka fituar mjete për këtë dedikim nga pushteti qendror.

MPN-ja konstatoi se emigrantët në Qendrën „Vinojug“ hyjnë në grupe prej 50 personave dhe nëse ka fluks më të madh të emigrantëve, atëherë ata mbeten në këmbë më shumë orë duke qëndruar para gardhit të Qendrës dhe ekspozohen ndaj kushteve të pavolitshme të motit. Përveç kësaj, është vendosur një tendë para hyrjes, por ajo nuk mund të pranojë të gjithë emigrantët të cilët presin jashtë gardhit. MPN-ja vuri në dukje se gjithsej tre tenda janë ngritur jashtë gardhit, por për arsye të panjohura nuk janë në funksion.

Avokati i Popullit-MPN-ja gjatë vizitës së realizuar më 17.11.2015 vuri re një grup më të madh të emigrantëve të cilët nuk u lejuan të hyjnë në Qendrën e Transitit për shkak të Vendimit të Qeverisë që të mos depërtojnë emigrantë nga vendet ku nuk ka konflikt lufte. Këta individë u kthen në territorin grek, pa i lejuar ata që të fillojnë procedurën për parashtrimin e kërkesës për azil.

MPN-ja konstatoi se organizatat joqeveritare, UNHCR-ja dhe Kryqi i Kuq në hyrje të kampit, emigrantëve u shpërndanin ushqim dhe ujë, materiale higjienike dhe sipas nevojës batanije për ngrohje, ndërsa ushqime të nxehtë nuk ishin akoma të siguruar për shkak se nuk ka pajisje adekuate. MPN-ja vuri në dukje praninë e vullnetarëve në terren nga ana e disa organizatave joqeveritare, duke përfshirë Shoqatën e Juristëve të Rinj „Legis“, „La Strada“.

Pas hyrjes në Qendër, emigrantët dhe refugjatët futen në tendë ku ju merren dokumentet të cilat u dorëzohen personave zyrtarë të MPB-së për të kryer regjistrimin e tyre. Në Qendrën e Përkohshme Transiitore „Vinojug“ janë vënë më shumë objekte montuese ku është stationi policor për kontrollin kufitar, ndërsa në katër kontejnerë bëhet regjistrimi kompjuterik i emigrantëve. Për këtë qëllim janë të angazhuar persona nga organizata joqeveritare Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, të cilët e bëjnë punën teknike të regjistrimit dhe të cilët punojnë në tri ndërrime.

MPN-ja ka konstatuar se procedura e verifikimit bëhet nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa regjistrimi është bërë në bazë të dokumenteve të lëshuara greke, përkatësisht me futjen e të dhënave në një sistem kompjuterik, pa u marrë shenjat e gishtave dhe pa u fotografuar personat.

Kontrolli i bagazheve që emigrantët i mbajnë me vete bëhet në vetë hyrjen e kampit, por sipas Avokatit të Popullit-MPN-së ky kontroll është i pamjaftueshëm, pasi vetëm disa orë në ditë është vendosur skaner. Me këtë lloj të kontrollit të bagazheve dhe të personave nuk mund të garantohej siguria.

Emigrantët pastaj vendosen në tenda për të pushuar. Në kohën e vizitave funksiononin katër tenda të mëdha në të cilat mund të vendosen një numër i madh i emigrantëve.

MPN-ja konstatoi se nga UNICEF-i janë siguruar dy tenda për fëmijët dhe nënat, ku përveç pushimit, fëmijët kanë mundësi edhe të argëtohen. Nga UNICEF-i janë siguruar rekuizite dhe lodra të ndryshme për fëmijët e moshave të ndryshme, që më lehtë dhe në mënyrë më të organizuar të kalojnë kohën derisa presin për transport.



Në Qendrën e Transitit janë vendosur edhe tualete dhe dushe montuese, kështu që janë përmbushur kushtet për higjienë bazike.

Avokati i Popullit-MPN-ja gjatë një vizite të fundit konstatoi se nga vizita e parë e realizuar e te ajo e fundit, është bërë shumë pak për të përshtatur Qendrën e Transitit për Pranimin e Personave në dimër. Respektivisht, MPN-ja përcaktoi se nuk është zgjidhur çështja për sigurimin e energjisë elektrike, nuk janë vendosur transformatorë, nuk ka ngrohje në tenda dhe në objektet tjera montuese, nuk është siguruar as ujë i nxehtë. Pajisjet për ngrohje me gaz që u furnizuan nuk ishin në gjendje që të sigurojnë ngrohje të plotë të objekteve montuese në të cilat ishin të vendosur refugjatët dhe emigrantët. I pyetur se kur do të vendosen transformatorët, nuk u ka dha një përgjigje konkrete.

### **5.1.3. Ndihma juridike**

Avokati i Popullit-MPN-ja është njoftuar nga Ministria e Punëve të Brendshme që ndihma ligjore për emigrantët/refugjatët në Qendrën e Transitit ofrohet nga organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare. Respektivisht, UNHCR-ja dhe përfaqësues të Shoqatës së Juristëve të Rinj-MILA vazhdimisht janë të pranishëm në terren dhe ofrojnë ndihmë ligjore falas për emigrantët/refugjatëve.

MPN-ja është informuar nga sektori joqeveritar që gjatë ditëve kur emigrantët ekonomikë nuk u lejuan të vazhdojnë rrugën për në kufirin me Republikën e Serbisë, këtyre personave u është shpjeguar procedura për parashtrimin e kërkesës për azil, por nuk u është dhënë mundësi për të filluar procedurën, sepse nga policia kufitare janë kthyer përsëri në territorin grek.

Numri i emigrantëve/refugjatët të cilët janë të regjistruar në Qendër është i ndryshueshëm. Muajt e parë është regjistruar hyrja e 2.000-3.000 emigrantëve në ditë, por numri vazhdimisht është rritur. Gjatë vizitës së realizuar më 17.11.2015, Avokati i Popullit MPN-ja kishte informatë se për 24 orë janë regjistruar 6.780 emigrantë, por para disa ditësh numri ka arritur deri në 10.000 emigrantë.

Sipas të dhënave statistikore nga 19 korriku, kur filloi regjistrimi i emigrantëve në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme, deri më 13.12.2015, 44% e emigrantëve/refugjatëve të regjistruar janë gra dhe fëmijë, nga të cilat 28% për qind janë fëmijë. Ka edhe të dhënë se 17.856 fëmijë të moshës 16-18 vjeç kanë udhëtuar pa prindër, që është një rrezik i mundshëm për keqpërdorimin e tyre në procesin e trafikimit me njerëz.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale më 09.12.2015 në Qendër janë regjistruar 1.835 persona, duke përfshirë 641 të mitur, 382 gra dhe 812 burra. Të njëjtën ditë, janë regjistruar 39 fëmijë të pashoqëruar, ndërsa është marrë informatë se mesatarisht në ditë janë regjistruar 200 fëmijë, për të cilët ka dyshim se janë pa shoqërimin e prindërve.

MPN-ja për trajtimin e këtyre personave është informuar se fillimisht zhvillohet bisedë me personat që paraqiten si anëtarë të familjes më të afërt, pastaj kontrollohen në evidencën e dorëzuar nga pala greke dhe zakonisht lejohen që fëmijët ta vazhdojnë rrugën. Por, nëse fëmija është vetë kontaktohet një punonjës social nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe nëse konstatohet se udhëton pa shoqëruar dërgohet në Qendrën për Azilkërkues në Vizbeg, ose në një shtëpi të sigurt në Kozle.

Sektori joqeveritar dhe UNHCR-ja kanë siguruar përkthyes të cilët sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit nuk janë në numër të mjaftueshëm.

### **5.1.4. Mbrojtja shëndetësore**

Avokati i Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se mbrojtja shëndetësore

në Qendrën e Pranimit „Vinojug“ është e organizuar nëpërmjet shëndetësisë publike dhe është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë. Në Qendër funksionon Ambulanca në të cilën ka kujdestari njëzet e katër orë të punëtorëve shëndetësore, (mjek-specialist për mjekësi të përgjithshme dhe infermiere).

MPN-ja vuri re se Ambulanca është e përbërë nga dy hapësira montuese, në njërin hapësirë kryhen ndërhyrje shëndetësore, ndërsa në tjetrën ka tre krevatë që janë të dedikuara për pushim dhe reanimim të pacientëve.

Nga biseda me personelin mjekësorë, MPN-ja konstatoi se pacientët më shpesh ankojnë nga infeksionet respiratore, diarea, temperatura e lartë, alergjitë dhe pickimi i insekteve, lodhje dhe plogështi për shkak të rrugës së gjatë dhe ndikimit të kushteve të motit. Nëse pacientëve u nevojiten tablete ata mund të furnizohen edhe nga Ambulanca edhe nga Kryqi i Kuq i RM-së, por në rastet kur nevojitet ndërhyrje më serioze, shëndetësia publike ka siguruar makinë të ndihmës së parë që i bart pacientët në shtëpitë më të afërta shëndetësore.

Gjatë vizitës më 10.12.2015, Avokati i Popullit-MPN-ja kishte informatë se në 24 orët e fundit ekipi mjekësor ka kryer 10 kontrole të pacientëve, nga të cilët 7 fëmijë, ndërsa 3 raste më serioze që janë transportuar në shtëpinë më të afërt shëndetësore.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit është përcaktuar se i njëjti mbahet rregullisht nga ana e personelit mjekësor.

### 5.1.5. Transporti i emigrantëve/refugjatëve

Transporti i emigrantëve bëhet në mënyrë të organizuar me komunikacion hekurudhor, me autobusë dhe taksi. Gjatë kësaj, MPN-ja konstatoi se nuk mund të parashihet numri i emigrantëve/refugjatëve të cilët arrijnë, pasi që numri për çdo ditë ndryshohet. Biletat për komunikacionin hekurudhor jepen para hyrjes në tren, ndërsa vlefshmëria e biletave është 24 orë, me çka MPN-ja është informuar se për fëmijët deri në moshën 10 vjet nuk paguhet biletë.

Gjatë vizitës së fundit e realizuar më 10.12.2015, Avokati i Popullit-MPN-ja hasi në gjendje jashtëzakonisht kaotike në Qendrën për Pranim. Është vërejtur se sporteli i biletave hapet para se të arrijë treni dhe se shkaktohet rrëmujë dhe turma të papara gjatë blerjes së biletave. Hapësira para hyrjes në trena nuk është e mbuluar, kështu që gjatë kushteve të këqija të motit emigrantët/refugjatët janë të ekspozuar në shi dhe borë. Njëherësh, është përcaktuar se nuk bëhet seleksionim dhe nuk u jepet përparësi fëmijëve, grave dhe personave me invaliditet, kështu që ekipi i Avokatit të Popullit-MPN-ja ishte dëshmitar i lutjeve të këtyre personave ndaj përfaqësuesve të UNHCR-së për t'u transferuar deri në tren.

Duke pasur parasysh se çmimi fiks prej 25 eurosh është disa herë më i lartë se çmimi i caktuar për qytetarët e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit-MPN-ja që më 10.09.2015 ngriti procedurë gjatë së cilës konstatoi trajtim të pabarabartë të shtetasve të huaj me ata maqedonas dhe qasje jo të barabartë në shërbime për sa i përket çmimit të biletave, si dhe mosrespektim të rregullave fiskale. Duke pasur parasysh parimin e mos-diskriminimit, Avokati i Popullit dorëzoi një Rekomandim të Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe të ndërmarrja e transportit, që çmimet e biletave për shtetasit e huaj të barazohen me ata për qytetarët e Republikës dhe kërkoi kategorizim të çmimit të biletave për fëmijët mbi 10 vjet dhe për personat me invaliditet. Qeveria në vend të marrjes së masave konkrete u përgjigj shkurtimisht se do të veprojë në përputhje me kompetencat, kështu që nuk dorëzoi përgjigje konkrete.

Avokati i Popullit-MPN-ja, gjithashtu konstatoi se emigrantët nuk mund të zgjedhin se me cilin mjet do të vazhdojnë rrugën drejt Tabanocës dhe për këtë shkak shpeshherë me orë presin të arrijë treni (pa pasur mundësi të shfrytëzojnë transport tjetër) për t'u transferuar në destinacionin e ardhshëm. Një situatë e tillë është hasur edhe gjatë vizitës së fundit të MPN-së, kur emigrantët u ankuan se disa orë e presin arrijtjen e trenit. Avokati i Popullit-MPN-ja nuk

kishte përgjigje nga përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme që përcakton se me çfarë transporti do të transportohen emigrantët dhe refugjatët.

Gjatë vizitës së realizuar në muajin dhjetor, ekipi i Avokatit të Popullit-MPN-ja vuri re se një grup më i madh i emigrantëve dhe refugjatëve ishin dërguar për të vazhduar rrugën me autobus dhe me taksì dhe gjatë kësaj ishin lënë që vetë të ecin drejt automjeteve. Gjithashtu, u dha informatë se një grup i caktuar në orët e vona është humbur dhe gjatë kohë nuk ka pasur mundësi të gjejë vendin ku ndalen autobusët dhe automjetet e taksive.

### **5.1.6. Biseda me emigrantët/refugjatët**

Gjatë vizitave të realizuara, Avokati i Popullit-MPN-ja realizoi më shumë biseda me disa nga emigrantët/refugjatët. Emigrantët/refugjatët kryesisht nuk kishin ankesa për trajtimin nga nëpunësit policor dhe shprehën mirënjohje për ndihmën që ju jepet në formë ushqimi, uji, pije, materiale higjienike, e të cilën e shpërndajnë organizatat joqeveritare. Emigrantët/refugjatët u ankuan për pritjen e gjatë të transportit drejt kalimit kufitar Tabanocë dhe u ankuan për shkak se nuk u lejohet të dalin jashtë Qendrës së Transitit. Lidhur me atë nëse atyre ju është shpjeguar procedura juridike dhe nëse u është ofruar ndihmë juridike, theksuan se këtë e sigurojnë nga organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare vetëm me kërkesë të tyre.

MPN-ja përcaktoi se qëllimi i vetëm i emigrantëve/refugjatëve është të bëjnë transit nëpërmjet Republikës së Maqedonisë drejt shteteve të Evropës perëndimore. Emigrantët ngejin në Qendrën e Transitit disa orë, varësisht nga organizimi i transportit të mëtejshëm. Gjithashtu, u ankuan se nuk u lejohet përzgjedhje se me çfarë transporti do ta vazhdojnë rrugën drejt kufirit me Republikën e Serbisë.

Gjatë vizitës së fundit, Avokati i Popullit-MPN-ja kishte ankesë nga disa emigrantë/refugjatë për sjelljen e policisë gjatë pranimit në Qendrën e Përkohshme Transitore, me ç'rast deklaruan se nga ana e nëpunësve policor janë shtyrë dhe se është përdorur forcë për t'i radhitur në grup. Më shumë ankesa kishte për ngrohjen, pasi që nuk është zgjedhur problemi me sigurimin e energjisë elektrike, përkatësisht ende nuk janë vendosur transformatorët.

## **5.2. QENDRA E PËRKOHSHME TRANSITORE „TABANOCË“**

Vizita e parë e Qendrës Transitore „Tabanocë“ nga Avokati i Popullit si mbrojtës i të drejtave të qytetarëve dhe si Mekanizëm Parandalues Nacional u realizua gjatë muajit shtator 2015, së bashku me përfaqësues të UNHCR-së, ndërsa e dyta u realizua në muajin dhjetor, së bashku me Mbrojtësin e qytetarëve të Republikës së Serbisë. Atë ditë Avokati i Popullit realizoi vizitë edhe në kampet për pranim në Republikën e Serbisë. Vizitën e tretë të Qendrës së Transitit „Tabanocë“, ekipi i Avokatit të Popullit e realizoi më 10.12.2015.

### **5.2.1. Udhëheqja dhe organizimi në Qendrën e Përkohshme Transitore „Tabanocë“**

MPN-ja përcaktoi se me Qendrën e Transitit „Tabanocë“ udhëheq Qendra për Menaxhim me Kriza. Nga disa vizita që Avokati i Popullit i realizoi në këtë Qendër, konstatoi organizim të

mirë të kampit, ndërsa gjatë çdo vizite të radhës kishte përmirësim të kushteve.

Në kalimin kufitar „Tabanocë“ në objektin montues është vendosur Stacioni Policor për kontroll kufitar, ndërsa nëpunësit policor janë të siguar nga stacioni policor në Tabanocë. Emigrantët dhe refugjatët në Qendër arrijnë me trena udhëtimi, autobusë dhe automjete taksi. MPN-ja kishte informatë se ka raste të rralla kur bëhet regjistrimi i emigrantëve të cilët paraprakisht nuk janë evidentuar në Qendrën e Përkohshme Transitore „Vinojug“ në Gjevgjeli.

Avokati i Popullit-MPN-ja përcaktoi se në kalimin kufitar vazhdimisht janë të pranishëm ekipe të UNHCR-së, Kryqit të Kuq, kohë pas kohe ka vizita edhe nga UNICEF-i. Në terren, gjithashtu janë të pranishme shumë organizata joqeveritare, në mesin e të cilëve janë NGO, Legis, Vllazërimi nga Kumanova, La Strada, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, etj.

### **5.2.2. Kushtet materiale për qëndrim në Qendrën e Përkohshme Transitore „Tabanocë“**

Gjatë vizitave MPN-ja vuri re se në Qendrën e Përkohshme Transitore „Tabanocë“, kushtet për pranimin e emigrantëve/refugjatëve janë më të mira se në Qendrën për Pranim „Vinojug“. Qëndrimi i emigrantëve/refugjatëve në kalimin kufitar Tabanocë është tejet i shkurtër duke pasur parasysh që kufiri i Republikës së Serbisë është disa qindra metra larg. Pas arritjes së refugjatëve, nga të gjithë personat e përfshirë në aksionin humanitar, u shpërndahet ushqim, ujë, pije dhe materiale higjienike.

Në Qendrën e Pranim nga UNHCR-ja janë siguar 32 lokale montuese, në të cilat mbahet ushqimi, uji dhe materialet higjienike, batanijet të cilat janë siguar nga sektori joqeveritar dhe organizatat ndërkombëtare dhe të njëjtat u shpërndahen emigrantëve/refugjatëve. Në një pjesë të objekteve janë të vendosur persona të cilët kanë nevojë të domosdoshme për pushim, për këtë shkak nga UNHCR-ja është vendosur edhe një tendë e madhe. Duke pasur parasysh se në Qendër janë ndërtuar tualete montuese dhe është lëshuar ujë, janë siguar kushte themelore për mirëmbajtje të higjienës, duke konstatuar se edhe në këtë Qendër ka mungesë të ujit të ngrohtë.

Gjatë vizitave, ekipi i Avokatit të Popullit kontrolloi hapësirat e Fshatit të Fëmijëve SOS që ka objekt montues në dy kate i dedikuar për qëndrimin e fëmijëve dhe nënave. Në këtë objekt vendosen fëmijët për një periudhë të shkurtër dhe në kushte relativisht të mira, pasi që objekti është i ngrohur dhe i pajisur me mjete të domosdoshme për higjienë dhe ushqim për fëmijët e të gjitha moshave.

Vërejtja e Avokatit të Popullit-MPN-së ka të bëjë me mungesën e ujit të ngrohtë i cili është i domosdoshëm për mbajtjen e higjienës, si dhe mungesën e specialistit-pediatër. Fshati i Fëmijëve për emigrantët dhe refugjatët ka siguar internet falas.

Avokati i Popullit-MPN-ja konstatoi se emigrantët kanë ushqim të ngrohtë (supë e ngrohtë), veshje dhe mbathje dhe gjithashtu është siguar tendë nga organizata joqeveritare „La Strada“ për strehimin e fëmijëve dhe nënave që është mjaft e ngrohtë. Kjo organizatë ofron edhe ndihmë dhe mbrojtje juridike dhe psikosociale për fëmijët dhe nënat.

Gjatë vizitës më 07.12.2015, Avokati i Popullit së bashku me Mbrojtësin e të drejtave të Republikës së Serbisë e kaluan rrugën deri në kalimin kufitar me Republikën e Serbisë. Gjatë kësaj, Avokati i Popullit konstatoi se rruga nëpër të cilën kalojnë emigrantët nuk është e rrafshët, është me baltë, pa ndriçim dhe mbrojtje të binareve hekurudhore, kështu që fëmijët, gratë dhe personat me invaliditet vështirë lëvizin nëpër të njëjtën. Por, është vërejtur se është garantuar një automjet me të cilin janë transferuar personat e paafte deri në kalimin kufitar. Duke pasur parasysh se ditën e njëjtë është vizituar edhe kampi për pranimin e refugjatëve në f.Miratocë që gjendet në Republikën e Serbisë, është konstatuar se emigrantët doemos duhet

të kalojnë dy kilometra e gjysmë rrugë, nëpër terren jo të rrafshët nga njëra deri në qendrën tjetër të pranimit, që sipas Avokatit të Popullit është çnjerëzore, veçanërisht nëse merret parasysh fakti se rrugën e njëjtë duhet ta kalojnë fëmijë të vegjël, gra shtatzëne ose persona me invaliditet.

Vetëm disa ditë më vonë, ekipi i Avokatit të Popullit dhe Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi aktivitete të përshpejtuara në qendrën e transitit „Tabanocë“. Respektivisht, rruga deri në kalimin kufitar ishte e mbuluar me guralecë, nga njëra anë ishte e rrethuar me gardh, ndërsa gjatë bisedës me drejtuesin e Qendrës për Pranim janë marrë informata se për disa ditë rruga do të ndriçohet dhe përshtatet për lëvizje më të lehtë.

Gjithashtu, me përshpejtim u punua në përshtatjen e tre tendave të mëdha të dedikuara për qëndrim të emigrantëve/refugjatëve, me shtresa të veçanta dyshemesh dhe ngrohje, por gjithashtu kishte realizim edhe të punëve tjera të ndërtimit. Përgatitej terren për ndërtimin e tendave për persona me nevoja të posaçme, tualete montuese dhe objekte administrative. Avokati i Popullit konstatoi aty për aty se në këtë Qendër çdo ditë punohet në përmirësimin e kushteve.

### 5.2.3. Mbrojtja shëndetësore

Mbrojtja shëndetësore në Qendrën „Tabanocë“ është e organizuar nga Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë. Janë siguruar kujdestari të ekipeve mjekësore për dhënie të mbrojtjes shëndetësore primare për emigrantët dhe refugjatët. Rastet më të vështira dërgohen në Shtëpinë Shëndetësore në Kumanovë, ndërsa sipas nevojës edhe në klinikën në Shkup.

Sipas të dhënave, pacientët shpeshherë ankohen për infeksione respiratore, diare, temperaturë të lartë, alergji, lodhje dhe plogështi për shkak të rrugës së gjatë dhe ndikimit të kushteve të motit. Personeli mjekësor i furnizon pacientët me analgjetikë, paracetamol, antireumatikë dhe preparate të tjera themelore.

MPN-ja konstatoi se personeli mjekësor i Kryqit të Kuq të RM-së mban evidencë të plotë për personat e trajtuar në mënyrë mjekësore. Në bazë të evidencës së tyre janë fituar të dhëna për personat e kontrolluar në periudhën nga 01.12.2015 deri në 09.12.2015

Data e vizitave	01.12.2015	02.12.2015	03.12.2015	04.12.2015
Ndërrimi i parë	Janë kontrolluar gjithsej 26 persona	Janë kontrolluar 156 persona prej të cilëve 27 ishin fëmijë deri në moshën 10 vjet	Janë kontrolluar 43 persona prej të cilëve 1 ishte shtatzëne	Janë kontrolluar 107 persona prej të cilëve 1 ishte fëmijë dhe 1 shtatzëne
Ndërrimi i dytë	Janë kontrolluar gjithsej 57 persona, prej të cilëve 16 ishin fëmijë deri në moshën 10 vjet	Janë kontrolluar gjithsej 336 persona, prej të cilëve 41 ishin fëmijë dhe 7 shtatzëne	Janë kontrolluar 29 persona, prej të cilëve 1 ishte fëmijë	Janë kontrolluar 420 persona, prej të cilëve 52 ishin fëmijë dhe 5 shtatzëne

Avokati i Popullit-MPN-ja konstatoi se për dallim nga Qendra Transitore për Pranim „Vinojug“, në këtë Qendër një numër i madh i personave kanë kërkuar mbrojtje primare shëndetësore në Ambulancën në Tabanocë, si rezultat i qëndrimit të këtyre personave në kushte jopërkatese në Qendrën në Gjevgjeli.

Data e vizitave	05.12.2015	06.12.2015	07.12.2015	08.12.2015	09.12.2015
Turni i parë	Janë kontrolluar 224 persona, prej të cilëve 35 ishin fëmijë dhe 3 shtatzëne	Janë kontrolluar 120 persona, prej të cilëve 17 ishin fëmijë dhe 1 shtatzëne	Janë kontrolluar 106 persona, prej të cilëve 8 ishin fëmijë dhe 2 shtatzëne	Janë kontrolluar 176 persona, prej të cilëve 39 ishin fëmijë dhe 3 shtatzëne	Gjatë vizitës së MPN-së u kontrolluan gjithsej 400 persona, prej të cilëve 39 ishin fëmijë.
Turni i dytë	Janë kontrolluar 100 persona, prej të cilëve 10 ishin fëmijë dhe 2 shtatzëne	Janë kontrolluar 248 persona, prej të cilëve 55 ishin fëmijë dhe 7 shtatzëne	Janë kontrolluar 79 persona, prej të cilëve 1 ishte fëmijë dhe 2 shtatzëne	Janë kontrolluar 60 persona, prej të cilëve 5 ishin fëmijë	

#### 5.2.4. Biseda me emigrantët/refugjatët

Gjatë vizitave, Avokati i Popullit-MPN-ja zhvilloi biseda me emigrantët/refugjatët, të cilët shprehën mirënjohje të veçantë për aktivitetet e organizatave joqeveritare dhe ndërkombëtare. Ata u ankuan për kohën e humbur gjatë pranimit në kalimin kufitar „Vinojug“ Gjevgjeli dhe për pritjen e transportit drejt kalimit kufitar Tabanocë.

Gjatë vizitës më 10.12.2015, ekipi i Avokatit të Popullit-Mekanizmi Parandalues Nacional hasi në grup prej 35 emigrantë të cilët kërkuan ndihmë pasi që në kalimin kufitar „Tabanocë“ kanë qëndruar disa ditë dhe nuk janë lejuar të kalojnë në Republikën e Serbisë. MPN-ja për rastin në fjalë bisedoi me policinë kufitare dhe me Drejtuesin e Qendrës, kështu që u informua se emigrantët nuk kanë asnjë dokument, ndërsa gjatë kontrolleve është konstatuar se nuk janë regjistruar në kalimin kufitar në Gjevgjeli, që sinjalizon se hyrja e tyre në territorin e Republikës së Maqedonisë është bërë në mënyrë të paligjshme dhe se bëhet fjalë për emigrantë ekonomikë.

Në pajtim me vendimin e përbashkët të vendeve nga Ballkani Perëndimor që të pranohen emigrantë vetëm nga Siria, Avganistani dhe Iraku, MPN-ja u informua se këtyre personave nuk u lejohet kalim në Republikën e Serbisë, përkatësisht prej tyre është kërkuar që të aplikojnë për azil por ata kanë refuzuar dhe se mbetet vetëm mundësia të kthehen në territorin e Republikës së Greqisë. Lidhur me pyetjen e Avokatit të Popullit-MPN-së nëse refuzimi për parashtrimin e kërkesës për azil është evidentuar, u tha se një evidencë e tillë nuk mbahet.

Për vizitat e realizuara në dy qendrat për pranim gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit-MPN-ja përpiloi Raport të veçantë me më shumë konstatime dhe rekomandime për tejkalimin e gjendjeve negative të konstatuara. Raporti i veçantë është dorëzuar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë, Qendrën për Menaxhim me Kriza dhe drejtuesit e qendrave të përkohshme të transitit.

### 5.3. Konstatime

1. Para hyrjes në Qendrën Transitore të Pranimit „Vinojug“, është siguruar vetëm një tende në të cilën një grup më i vogël i emigrantëve/refugjatëve vendoset derisa kryhet kontroll për hyrje, ndërsa të tjerët janë jashtë në

- vend të hapur dhe të ekspozuar në kushte të pavolitshme të motit;
2. Ekziston sistem i dobët i evidencës dhe regjistrimit të refugjatëve/emigrantëve që bëhet vetëm në bazë të dokumenteve të lëshuara nga Republika e Greqisë. Nuk ka kontakt të drejtpërdrejtë midis nëpunësve policor dhe refugjatëve/emigrantëve gjatë evidencës dhe regjistrimit të tyre;
  3. Gjatë hyrjes bëhet seleksionimi i refugjatëve dhe emigrantëve ekonomik sipas vendit të origjinës , kështu që personat emigrantë ekonomik edhe pse kanë hyrë në territorin e Republikës së Maqedonisë kthehen pas asnjë procedurë;
  4. Sistem sigurie i dobët dhe jo i përhershëm për kontroll të refugjatëve/emigrantëve dhe bagazhin e tyre gjatë hyrjes në Qendrën e Përkohshme Trasitore „Vinojug“, duke përdorur kohë pas kohe skenerin e Ministrisë së Punëve të Brendshme;
  5. Nuk mjafton bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve të menaxherëve të Qendrës për Pranim „Vinojug“ dhe „Tabanocë“, ndërsa nuk është i përhershëm dhe gjithëpërfshirës koordinimi i organeve kompetente në Republikën e Greqisë, Republikën e Maqedonisë dhe Republikën e Serbisë lidhur me pranimin, trajtimin dhe transitin e refugjatëve/emigrantëve;
  6. Nuk janë të pajisura tërësisht objektet për pranimin e refugjatëve dhe emigrantëve në kushte dimri, nuk është zgjidhur problemi me sigurimin e energjisë elektrike dhe nuk është siguruar ngrohje në të gjitha objektet, ndërsa ekziston edhe mungesë e ujit të ngrohtë;
  7. Mungon pranimi dhe kujdesi njerëzor, gjithëpërfshirës dhe përkatës për grupet në nevojë, gjatë qëndrimit të tyre në Qendrën e Pranimit. Fëmijët, gratë, shtatzënat, personat në moshë dhe personat me invaliditet vendosen në objekte të cilat janë më të ngrohta dhe nuk u sigurohet ndihmë përkatëse gjatë hyrje-daljes nga Republika e Maqedonisë;
  8. Transporti për refugjatët/emigrantët është keq i organizuar dhe pa nevojë presin gjatë në Qendër, paguajnë çmim të lartë për biletë, ndërsa nuk është bërë as kategorizimi i çmimit të biletave për fëmijët mbi 10 vjet dhe personat me invaliditet. Refugjatëve dhe emigrantëve nuk u jepet mundësia të zgjedhin cilin lloj të transportit do ta shfrytëzojnë deri në „Tabanocë“;
  9. Në Qendrën e Përkohshme Trasitore „Vinojug“ mënyra e ruajtjes dhe depozimit të ushqimit nuk është mënyrë përkatëse, përkatësisht në qese na-jloni që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, shpërndarja e ushqimit e dedikuar për refugjatët dhe emigrantët bëhet në mënyrë jonjerëzore. Gjithastu, në qendër nuk sigurohet ushqim i ngrohtë;
  10. Ndhimja juridike në Qendrën e Pranimit „Vinojug“ është jo e plotë, veçanërisht ka mungesë të një qasje gjithëpërfshirëse në detektimin e fëmijëve pa shoqërim dhe parandalimin e të njëjtëve që të jenë viktimë e trafikimit me njerëz. Njëkohësisht, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe organet tjera kompetente mungojnë me praninë e tyre në terren;
  11. Organizatat vendase dhe ndërkombëtare janë të pranishme në terren dhe ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për refugjatët/emigrantët. Mungon koordinim më i madh me organet kompetente për një mbrojtje më efikase.

## 5.4. Rekomandime

---

1. Të sigurohen kushte për pranim njerëzor të të gjithë personave të cilët presin për të hyrë në Qendrën e Përkohshme Transitore „Vinojug“ dhe të sigurohen më tepër objekte për këtë dedikim;
2. Të merren masa për të vendosur një mënyrë të re, më efikase dhe më gjithëpërfshirëse për evidentim dhe regjistrim, nëpërmjet sistemit biom-etrik të evidentimit dhe fotografimit të personave të këtuillë;
3. Të mundësohet qasje joselektive dhe njerëzore ndaj të gjithë personave të cilët kanë kërkuar ndihmë dhe mbrojtje ndërkombëtare dhe të mundësohet nisje e procedurës përkatëse për njohjen e të drejtës së azilit ose qëndrim të përkohshëm në Republikën e Maqedonisë, ndërsa nëse personat e refuzojnë këtë atëherë duhet të ketë provë me shkrim për refuzimin;
4. Të përmirësohen kontrollet e sigurisë nëpërmjet kontrollit të rregullt nga Ministria e Punëve të Brendshme duke përdorur vazhdimisht skenerë për të kontrolluar bagazhin dhe personat;
5. Të vendoset koordinim më i mirë dhe më intensiv i menaxherëve të Qendrave për Pranim në nivel shtetëror dhe ndërshtetëror, si dhe bashkëpunim midis shërbimeve policore të Republikës së Greqisë, Republikës së Maqedonisë dhe republikës së Serbisë për pranim dhe transit në kohë, më njerëzor dhe të plotë të refugjatëve dhe emigrantëve;
6. Urgjentisht të ndërmerren masa për të siguruar të gjitha kushtet për pranimin e refugjatëve/emigrantëve në kushte dimërore, furnizim me energjinë e nevojshme elektrike për të ngrohur objektet dhe për të siguruar ujë të ngrohtë për refugjatët dhe emigrantët;
7. Të ndërmerren masa për pranim kujdes dhe trajtim njerëzor të grupeve në nevojë në Qendrën e Pranim. Për gratë, fëmijët, shtatëzënet, personat në moshë dhe personat me nevoja të veçanta të organizohet transport nëpër kalimet legale kufitare;
8. Transporti i refugjatëve/emigrantëve të organizohet pa ngecje dhe pritje të panevojshme dhe të gjatë, duke respektuar të drejtën e zgjedhjes së llojit të mjetit transportues, si dhe të ndërmerren masa për barazimin e çmimit të biletave, në pajtim me parimin e barazisë së qytetarëve ndaj shërbimeve;
9. Të ndërmerren masa për ruajtjen dhe magazinimin e ushqimit në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe masa për sigurim të detyrueshëm të ushqimit të ngrohtë, ndërsa ushqimi të shpërndahet në mënyrë humane duke siguruar kushte përkatëse për të konsumuar të njëjtin;
10. Ndihmë e organizuar në mënyrë më të mirë në Qendrat për Pranim, prani më e madhe e organeve kompetente dhe institucioneve dhe sigurim të pranisë së përhershme të personave profesionist (punëtorë social, psikologë, pedagogë) të cilët do të japin asistencë profesionale dhe ek-



**sperte dhe do të mbrojnë fëmijët, grupet në nevojë dhe të gjithë personat të cilët do të kenë nevojë;**

- 11. Të vendoset dhe përforcohet bashkëpunim dhe koordinim me organizatat joqeveritare të vendit dhe ato ndërkombëtare të cilat punojnë për çështjen e refugjatëve/emigrantëve.**

## **5.5. Të vepruarit sipas rekomandimeve**

Me dorëzimin e Raportit të veçantë të Avokatit të Popullit-Mekanizmi Parandalues Nacional për gjendjet në qendrat e përkohshme të transitit, Qendra për Menaxhim me Kriza dorëzoi në kohë përgjigje me të cilën e informon Avokatin e Popullit-MPN-në se raporti është shqyrtuar nga Selia kryesore e Qendrës si një organ profesional i cili udhëheq me aktivitetet për parandalimin dhe të ballafaquarit me situatat e krizës.

Qendra për Menaxhim me Kriza e informoi Avokatin e Popullit-MPN-në se në ndërkohë gjendjet dhe kushtet në të dy qendrat janë përmirësuar, përkatësisht se janë siguruar më shumë hapësira të ngrohura dhe jepet ushqim i ngrohtë dhe pije. Gjithashtu është siguruar edhe ujë i ngrohtë, ndërsa në qendrat ka filluar furnizimi me energjinë përkatëse elektrike.

Lidhur me transportin, Qendra për Menaxhim me Kriza e informoi MPN-në se Selia kryesore ka konstatuar që transporti themelor për emigrantët të jetë ai hekurudhor, ndërsa në mungesë të kapaciteteve të përdoret transporti me autobus dhe taksi. Njëkohësisht, Selia kryesore ka marrë vendim që të gjithë fëmijët-refugjat dhe personat tjerë të cilët nuk kanë mjete financiare të mos paguajnë për transport.

Me rekomandimin e Avokatit të Popullit-MPN-së për të përforcuar kontrollet e sigurisë për bagazhet dhe udhëtarët, Qendra për Menaxhim me Kriza u përgjigj se në ndërkohë është vendosur skener me të cilin kryhet kontroll më i madh dhe më efikas. Gjithashtu, në drejtim të sigurisë më të madhe në zonën kufitare, përveç policëve të Republikës së Maqedonisë, marrin pjesë edhe pjesëtarë të policisë nga Republika e Serbisë, Republika e Kroacisë dhe Republika e Sllovenisë, ndërsa janë paraqitur edhe nga vende tjera në rajon.

Sa i përket ushqimit, Qendra për Menaxhim me Kriza theksoi se shpërndarja e ushqimit në qendra bëhet në mënyrë të organizuar nga organizata humanitare, në koordinim dhe në përputhje me standardet e vendosura nga Agjencia për Ushqim e Republikës së Maqedonisë. Lidhur me kujdesin për personat me nevoja të veçanta dhe grupet në nevojë është theksuar se për këtë janë të detyruar organizatat joqeveritare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Qendra për Menaxhim me Kriza e informoi Avokatin e Popullit se nuk mund t'i implementojë plotësisht rekomandimet e dhëna, për shkak se mungojnë mjete financiare. Njëkohësisht, theksoi se konstatimet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit-MPN-së do të kihen parasysh dhe të njëjtat do të kontribuojnë për zmadhimin e efikasitetit të punës së organeve dhe trupave të sistemit për menaxhim me kriza.



## REKOMANDIME NGA VIZITAT E REALIZUARA

Mekanizmi Parandalues Nacional në vitin 2015 hartoi 14 raporte të veçanta dhe dy informata të cilat i dorëzoi te organet kompetente me një analizë të hollësishme dhe masa konkrete për të përmirësuar gjendjet. Rekomandimet e përfshira në këtë raport vjetor janë të përgjithshme dhe paraqesin udhëzime të përgjithshme në përputhje me gjendjet dhe tendencat e konstatuara gjatë realizimit të vizitave të rregullta dhe të njëpasnjëshme gjatë vitit 2015, që të ketë veprim parandalues të organeve shtetërore të tanguara

